

VELI I GRISUR

Një best-seller i dëshmisë së

GULSHAN ESTER

Shtëpia Botuese  
Tenda  
Prishtinë  
2004

Titulli origjinal: The Torn Veil  
Titulli i veprës: Veli i grisur  
Autore: Gulshan Ester  
Beton: Shtëpia Botuese TENDA  
Editor: Mr. Femi Cakolli  
Redaktor: Besim Kryeziu  
Përktheu: Hilki Berisha  
Lektore & Korrektore: Sabrie Kryeziu  
Shtypi: Dinor & Multigrafiks, Prishtinë  
Dizajni: Tomor Rudi  
Realizimi: Pika!  
Botimi i parë: 2004  
Tirazhi: 1000 copë  
Copyright: © Tenda  
Formati: 17 x 10.50 cm.  
Viti i shtypit: 2004  
Printed in Kosova  
ISBN:  
Citimet e Biblës janë marrë nga Bibla, Diodati i Ri: përdorur me leje

Botuesi origjinal : Marshall Pickering  
Viti i botimit: 1984, 92, 93, 94  
Vendi i botimit: Londër  
Copyright: © Sister Gulshan Esther and Thelma Sangster  
ISBN: 0 55101153 X

Adresa:  
Shtëpia Botuese TENDA  
rr. Nazim Gafurri nr.66  
Prishtinë, Kosovë  
Tel. 044118088  
E-mail: Tenda\_al@yahoo.com

Të gjitha të drejtat e këtij botimi për gjuhën shqipe, në Kosovë, i mban Shtëpia Botuese TENDA, andaj ndalohet me ligj shumëzimi dhe fotokopjimi si dhe përdorimi i paautorizuar i këtij libri, si tërësi apo pjesë e tij, pa lejen paraprake të botuesit!

## Përmbajtja

Parathënie

1. Për në Mekë
  2. Haxhi
  3. Uji i jetës
  4. Dasma
  5. Thumbi i vdekjes
  6. Makina
  7. Fama
  8. Libri
  9. Pagëzimi
  10. Motrat
  11. E zënë në grackë
  12. Tunduesi
  13. Qiriu
  14. Dëshmia
  15. Përfundimi
- Ftesë

## Parathënie

Libri “Veli i grisur” i autores pakistaneze Gulshan Ester është një dëshmi në vetën e parë, dhe si botim i kësaj dëshmie në Amerikë para 15 vitesh ishte një bestseller. Libri deri tani është përkthyer edhe në disa gjuhë të tjera. Gulshan, sipas dëshmisë së saj ka një prejardhje të drejtpërdrejtë nga familja e Muhamedit, dhe kjo tregon se paku sesa ishte e përkushtuar në zbatimin e fesë së babait të saj për një kohë të gjatë deri sa i shfaqet Jezusi në një gjendje tejet të rënduar shëndetësore. Plot 19 vjet Gulshan ishte e paralizuar dhe për të s’kishte asnjë lloj shërimi, madje shpresat e saj pas vizitës së Mekës si haxhe u përmbysën përfundimisht, pasi ajo nuk u shërua.

“Veli i grisur” evidenton gjithë takimin e Krishtit me autoren e këtij libri. Gulshan vetëm sa kishte dëgjuar nga babai i saj për Jezusin, dhe po ashtu kishte lexuar në Kuran se Ai kishte bërë shumë mrekulli shërimi, madje edhe ringjalljen e të vdekurve, dhe një ditë vendos që ta kërkoj, që ta thërras Jezusin, dhe Ai i shfaqet, dhe pas kësaj e shëron. Menjëherë pas shërimit të saj fillojnë kundërshtimet në mesin e familjes së saj dhe më gjerë, saqë njerëzit ishin gati për ta vrarë. Gulshan, një vajzë mjaft e talentuar dhe e arsimuar, si e paralizuar s’kishte ndonjë oponencë tjetër veç mishi i saj, por kur atë e shëron Jezusi atëherë asaj i gjithë farefisi i saj bëhen kundërshtarët e saj madje edhe për vdekje.

Gjithë kjo dëshmi e krishterë ndodhur në një vend ku sundon sheriatu islam, siç është Pakistani, prandaj autorja e kësaj dëshmie s’kishte mundësi për të dëgjuar për Krishtin përmes ndonjë misionari, ose përmes leximit të Dhiatës së Re, ose dëgjimit të ndonjë programi të krishterë, por vetë Jezusi vie dhe i shfaqet asaj, dhe këtë si një akt të gjithë ne do ta dëshironim fundja e fundit edhe për vetën tonë. Kjo dëshmi paraqet edhe njëherë një mënyrë të thjeshtë dhe fundamentale se si shpëton Krishti, se askush s’mund ta ndalojë hapin, fuqinë dhe ndikimin e tij, meson se çfarë është natyra e Tij, dhe si ndryshon jeta e atyre që ecin më Të, ashtu siç i ndodh edhe vetë Gulshan Esterës.

Mr. Femi Cakolli, editor  
Maj 2004 Prishtinë

# 1. Për në Mekë

Nuk do të kisha parapëlqyer që, në rrjedhën e zakonshme të ngjarjeve të vija në Angli, atë pranverë të vitit 1966. Unë, Fatima Gulshan, vajza më e vogël e familjes myslimane Sayed, që rrjedh nga profeti Muhamed nëpërmjet vajzës së tij Fatimes, çdo herë kam bërë një jetë të qetë të vetmuar në shtëpinë time në Punxhab, në Pakistan. Jo vetëm për shkak se isha *mbuluar* që nga mosha shtatëvjeçare sipas ligjit islamik të përpiktë të shiitëve, por dhe sepse isha e gjymtë dhe e paaftë të lëshoja dhomën time pa ndihmë. Fytyra ime ishte e mbuluar nga njeriu, për ndryshim nga të tjerët në farefis, si babai im, dy vëllezërit më të vjetër dhe xhaxhai. Në kohën më të madhe, gjatë këtyre katërmbëdhjetë vjetëve të ekzistencës sime shëndetlige, me muret përreth kopshtit tonë të madh në Xhang, për rreth 250 milja larg Lahores, qe bota ime me kufijtë e saj.

Babai im ishte ai që më solli në Angli – i cili i konsideronte anglezët adhures të tre perëndive, në vend të një Perëndie. Madje ai nuk do të më lejonte as të mësoja gjuhën e të pabesëve me mësuesen time Razia, për shkak të frikës se mos kontaminohesha disi me gabime dhe të mënjanohesha nga besimi ynë. Dhe megjithatë, më solli pas një kohe të gjatë të kërkimit të pafrytshëm të shërimit në shtëpi, për të kërkuar këshillën më të mirë mjekësore. Ai e bëri këtë nga mirësia dhe brengosja për lumturinë time të ardhshme, por aq pak dihej për fatkeqësinë dhe pikëllimin që së shpejti priste familjen time nga ajo ditë që kur ateruam në aeroportin Heathrow në Londër, në një ditë të hershme të prillit. E habitshme, që unë fëmija e gjymtë, më e dobtja nga të pesë fëmijët e tij, do të bëhesha më e fortja nga të gjithë në fund, dhe një shkëmb për të dërmuar atë që ai mbante për më të dashur.

Më duhet vetëm t'i mbyllë sytë, edhe tani si e rritur, dhe figura e babait tim të paraqitet para meje; i dashuri Aba-Xhan; aq i gjatë dhe i thatë në kostumin e tij të qepur mirë; me jakat e lartë; me xhakatën e zezë të stolisur me kopsa ari, mbi pantallonat e gjërë, dhe në kokën e tij çallmën e bardhë me mëndafsh të kaltër. E shoh atë, si aq shpesh në fëmijëri, duke ardhur në dhomën time që të më mësojë fenë time.

E shoh atë duke qëndruar pranë shtratit tim, në krahun e kundërt të figurës së shtëpisë së shenjtë në Mekë, Qabes, vendit më të shenjtë në islam, e ngritur siç thuhet nga Abrahami (Ibrahimi) dhe i restauruar nga Muhamedi. Babai e merrte Kuranin e Madhëruar nga rafti më i lartë, në fakt vendi më i lartë në dhomë, sepse asgjë nuk mund të vendosej mbi apo më lartë se Kurani. Ai para se gjithash do ta puthte mbështjellësin e mëndafshhtë ngjyrë gjelbërt dhe do të recitonte *Bismil-Labir-Rabmanir- Rahim* ( Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit). Pastaj do ta zgjidhte mbështjellësin e mëndafshhtë ngjyrë të gjelbërt, duke mos harruar së pari të merrte me kujdes *Vudu* - abdesin, pastrim ritual i domosdoshëm para bartjes apo prekjes së Librit të Shenjtë. Ai e përsëriste sërish Bismilahun dhe pastaj do ta vendoste Kuranin e Madhëruar në mbështetëse, një qëndruese në formë të shkronjës X, duke e prekur librin vetëm me mollëzat e gishtërinjëve. Ai ulej në atë pozitë, që edhe unë e mbështetur në karrige të mund të shihja. Unë gjithashtu do të bëja Vudu, me ndihmën e shërbëtove të mia.

Me gishtin e tij babai gjurmonte shkrimet e shenjta në shkrimin e dekoruar arabik, dhe unë, e kujdesur për ta kënaqur, përsërisja pas tij *Fatiha*-në, fillimin, që lidhë së bashku të gjithë myslimanët kudo që janë:

“Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!

Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirbërësit!

Sunduesit në ditën e gjykimit!

Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm te ti ndihmë kërkojmë!

Udhëzoni për në rrugën e drejtë?

Jo të atyre që kundër veti tërhiqen hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!

Sot do të lexojmë nga sura Ali Imran:

“Allahu është Një, e nuk ka të adhuruar pos tij, është i përjetshëm dhe mbikqyrës.

“Ai ta zbret ty librin me argument që është vërtetues i librave të mëparshme. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhillin. Udhërrëfim për njerëz (dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtria).”

Unë bëja të njëjtën gjë, që do të bënte çdo fëmijë mysliman i rritur në një familje fetare – leximin e Kuranit të Madhërishtëm në gjuhën arabe. Ai mund të kuptohet vetëm në gjuhën arabe, në gjuhën në të

cilën është shkruar. Ne myslimanët besojmë që Kurani nuk mund të përkthehet siç do të mund të bëhej me çdo libër tjetër pa humbur gjë nga kuptimi, sepse është i shenjtë.

Kur lexohet për herë të parë, për mua rreth vitit të shtatë dhe konsiderohet si viti i urtësisë, zakonisht mbahej një festë – ne e quajmë ‘ameni i Kuranit të Madhërishtëm’ – dhe anëtarët e familjes, miqtë dhe fqinjët do të ishin të ftuar.

Në oborrin e hapur të shtëpisë sonë përdhese, ku meshkujt rrinin të ndarë nga femrat me anë të ndarëses, mullaï do të recitonte lutjet për të shënuar arrijten time në këtë etapë të re të rëndësishme të jetës sime, dhe gratë duke ndenjur në pjesën e tyre të oborrit pushonin nga thashethemet e tyre për të dëgjuar.

Me të mbërritur fundin e sures, vjen rradha ime - katekizmi im. Babai shikonte në mua me buzëqeshje në buzët e tij:

Të lumtë Beiti (bija) e vogël - ai thoshte. -Tani përgjigju në këto pyetje:

Ku është Allahu?

Turpshëm do t'i përsërisja përgjigjet që i dija shumë mirë:

‘Allahu është kudo.’

A i di Allahu të gjitha veprimet e tua këtu në botë?

‘Po, Allahu i di të gjitha veprimet që i bëj në tokë, të mirat dhe të këqijat. Ai përveç kësaj i di edhe mendimet e mia të fshehta.’

Çfarë ka bërë Allahu për ty?

Allahu më ka krijuar mua dhe mbarë botën. Ai më do dhe më gëzon mua. Ai do të më shpërblejë në qiell për të gjitha veprat e mira dhe do të më ndëshkojë për të gjitha të këqijat.’

Si mund ta përfitosh dashurinë e Perëndisë?

Mund ta fitoj dashurinë e Perëndisë me një nënshtrim të plotë ndaj vullnetit të tij dhe duke iu bindur urdhërimeve të tij.

Si mund të kuptosh vullnetin dhe urdhërimet e Allahut?

Vullnetin dhe urdhërimet e Allahut mund t'i kuptoj nga Kurani i Madhërishtëm dhe nga Traditat e profetit tonë Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin me të).’

Shumë mirë’, thoshte babai. -‘Tani ka diçka tjetër që do të mësosh.

Ke ndonjë pyetje tjetër?

Po baba, të lutem më trego përse islami është më i mirë se fetë e tjera?’ Unë e pyesja atë për këtë jo se dija diçka për fetë e tjera por

sepse doja ta dëgjoja atë duke më sqaruar fenë tonë. Përgjigjja e babait ishte e qartë dhe definitive:

‘Gulshan, dua që çdo herë ta mbash në mendje këtë. Feja jonë është më e mirë se çdo tjetër sepse Muhamedi para se gjithash, është lavdia e Perëndisë. Qenë shumë profetë të tjerë, por Muhamedi i solli njerëzimit mesazhin përfundimtar nga Perëndia, dhe nuk ka më nevojë për ndonjë profet tjetër. Së dyti, Muhamedi është miku i Perëndisë. Ai i shkatërroi të gjitha idhujt dhe i konvertoi njerëzit që adhuronin idhujt në islam. Së treti, Perëndia i dha Kuranin Muhamedit pas të gjitha librave të tjerë. Është fjala e fundit e Perëndisë dhe duhet t’i bindemi atij. Të gjitha shkrimet e tjera janë të papërfunduara.’

Unë dëgjoja. Fjalët e tij shkruheshin në pllakën e mendjes sime dhe në zemrën time po ashtu.

Nëse do kishte kohë unë do të pyesja sërish për figurën në murin tim. Si është të shkosh në qytetin e shenjtë të Mekës në haxh, magnet ky ndaj të cilit çdo mysliman kthehet pesë herë në ditë gjatë faljes? Ne ktheheshim po ashtu te qyteti ynë, përderisa dëgjohej thirrja e *ezanit* nga *myezini* nga minarja e xhamisë. Zëri përhapej përgjatë avenysë, mbi zhurmën e trafikut dhe tregut, dhe depërtonte xhamat tona me perde në agim, në drekë, kur ngrysej dhe në mbrëmje duke i ftuar besnikët në falje me deklarinimin e parë të islamit:

“Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut,  
Dhe Muhamedi është i dërguari i tij!”

Babai m’i sqaronte të gjitha këto. Ai qe dy herë në haxh – një herë vetëm dhe herën tjetër me gruan e tij. Është obligim i çdo myslimani për të shkuar së paku një herë në jetën e tij (nëse është i pasur) - më shpesh nëse ka pasuri të mjaftueshme. Të shkosh në haxh është e fundit nga pesë kushtet themelore të islamit, që bashkojnë me miliona myslimanë në vende të ndryshme të botës dhe siguron vazhdimësinë e besimit.

A do të shkoj unë në Mekë baba? -E pyesja. Ai qeshte dhe krrusej të puthte ballin tim.

Po do të shkosh, Gulshan i vogël. Kur të rritesh dhe ndoshta...

Ai nuk e përfundonte fjalinë, sepse e dija çfarë donte të thoshte...’

Kur të përgjigjen lutjet tona për ty.



Nga këto periudha udhëzimi mësova devocionin ndaj Perëndisë, një shtojcë ndaj fesë dhe traditës së saj, krenarinë e rreptë në linjën time të paraardhësve nga profeti Muhamed, përmes dhëndrrit të tij Aliut, dhe kuptova dinjitetin e babait tim, i cili jo vetëm që është udhëheqës i familjes por, si pasardhës i profetit, është *Sayed* dhe *Shah*. Ai është po ashtu një Pir- udhëheqës fetar, dhe një pronar me një pronë të madhe në vendin tonë dhe me një shtëpi të gjërë përdhese rrethuar nga kopshtet në fund të qytetit tonë. Fillova të kuptoj se përse jemi aq të respektuar si familje, edhe nga *mulla* apo *maulvi*, i cili vinte të pyeste babanë tim, pyetje fetare që ai vetë nuk mund t'u përgjigjej.

Duke shikuar prapa tani unë mund të gjej qëllimin e atyre viteve të robëruara, ku mendja dhe shpirti u çelën si gonxhet e trëndafilave në kopshtin tonë të ujitur mirë dhe të përkujdesur me aq dashuri nga kopshtarët tanë. Emri im, Gulshan, në gjuhën urdu do të thotë 'vendi i luleve, kopshti'. Unë, një bimë e sëmurë të mbaja një emër të tillë kishte animin e babait tim. Ai na deshi të gjithëve, dy bijtë e tij Safdar Shah dhe Alim Shah, dhe tri vajzat, Anis Bibi, Samina dhe unë, por edhe përkundër që unë e zhgënjeva duke lindur një vajzë, dhe pastaj kur isha gjashtë muajshe ngela e gjymtë nga tifoja, babai më donte aq shumë, mbase dhe më shumë se të tjerët. Mos vallë, i kishte kërkuar nëna ime në shtratin e vdekjes një kërkesë të shenjtë të kujdesej për mua?

Të lutem Shah, të mos martohesh edhe një herë për shkak të Gulshanit të vogël - i tha ajo në grahmën e fundit. Ajo donte të më mbronte meqë, njerka dhe fëmijët e saj do të reduktonin trashëgiminë e vajzës me gruan e parë dhe do ta trajtonin në mënyrë jo të këndshme si të sëmurë dhe të pamartuar.

Shumë vite më parë ai i kishte premtuar asaj dhe e ka mbajtur fjalën e tij, në një vend ku sipas Kuranit njeriu mund të ketë deri në katër gra, nëse do të kishte pasuri të mjaftueshme për ta trajtuar çdo njëri prej tyre njëllë dhe me drejtësi.

I tillë ishte shtegu i pashqetësuar i jetës sime, deri në këtë vizitën time në Angli kur isha 14 vjeç. Kjo ndryshoi çdo gjë në mënyrë të stërholluar, duke vënë në lëvizje një zingjir të pasojave të paqëllimta. Nuk kisha një parandjenjë të ngjarjeve të tilla deri sa po prisja në dhomën e hotelit londinez, me Salimën dhe Semën shërbëtoret e

mia, në ditën e tretë të vizitës sonë. Ne prisnim vendimin e specialistit anglez për të cilin babai kishte dëgjuar në Pakistan gjatë kërkimit për mjekim, që do të përcaktonte një herë përgjithmonë, të ardhmen time.

Nëse unë do të shërohesha nga kjo sëmundje që kishte paralizuar anën time të majtë kur unë isha foshnje, atëherë do të isha e lirë të martohesha me kushëririn tim, për të cilin isha fejuar që kur isha tre muajshe, dhe i cili po priste tani në shtëpi në Multan, Punxhab, lajmin e shërimit tim. Dhe nëse jo, fejesa ime do të duhej të prishej, dhe turpi im do të ishte edhe më i madh se ai që do të mund të ndodhte po të isha e divorcuar nga burri im.

Ne ndëgjuaam hapat që po afroreshin. Salima dhe Sema u ngritën dhe rregulluan vetën e tyre me shallin si *dupattas* disi me nervozizëm. Salima tërhoqi timën nga fytyra ime derisa unë po shtrihesha në mbulojën e shtratit tim. Unë po dridhesha, por jo nga të ftohtit. M'u desht t'i shtrëngoja dhëmbët nga kërcëllimet e tyre.

Dera u hap dhe brenda hynë babai im dhe doktori.

Mirëmëngjes! - tha një zë i ëmbël, dhe shumë i sjellshëm. Nuk mund të shikoja fytyrën e këtij dr. Davidit, por ai barte më veti dukjen e autoritetit dhe të njohurisë. Duart e sigurta ngritën mëngën time të gjatë dhe testuan krahun tim të majtë të gjymtë dhe pastaj këmbën e cinguar. Një minutë kaloi dhe pastaj specialisti u drejtua.

Nuk ka bar për këtë – vetëm lutja - i tha dr. Davidi babait tim. Nuk kishte gabim në qetësinë përfundimtare të zërit të tij.

E shtrirë në shtrat po dëgjoja emrin e Perëndisë që po e përmendte mjeku i huaj anglez. Isha e çuditur. Çfarë mund të dinte ai për Perëndinë? Unë ndjeva nga sjellja e tij e këndshme dhe mirëdashëse që ai po flakte tej shpresën tonë të shërimit, por edhe më tutje ai po theksonte udhën e lutjes.

Babai eci me të kah dera. Kur u kthye prapa tha – 'kjo qe mirë për një anglez të na mësojë ne të lutemi.'

Salima më ktheu prapa *dupatta*-në time dhe më ndihmoi të ulem.

'Baba, nuk mund të më ndihmonte gjë ai?' Nuk mund ta mbaja zërin tim më nga dridhja. Lotët u mblodhën prapa syve të mi.

Babai duke përkëdhelur duart e mia të pajetë tha shpejt:

- 'Ka vetëm një rrugë tani. Le të trokasim në dyert qiellore. Do të shkojmë në Mekë ashtu siç edhe planifikuam. Perëndia do të dëgjojë lutjet tona, dhe mbase kthehemi në shtëpi me falënderime.'

Ai buzëqeshi me mua dhe unë u përpoqa t'ia kthej prapa. Vuajtja ime ishte të themi edhe vuajtja e tij, por ai nuk ishte i dëshpëruar. Ishte një shpresë e ripërtrirë në zërin e tij. Me siguri që në shtëpinë e Zotit apo te burimi shërues i Zemzem-it do të gjenim dëshirat e zemrës sonë?

Ne qëndruam në hotel edhe për disa ditë derisa babai rregulloi fluturimin deri në Jeddah - aeroport i shfrytëzuar nga shtegtarët për në Mekë. Ai nuk e bëri këtë më herët pasi po prishte rezultatin e ndonjë shërimi që do të mund të rekomandohej. Ai e kishte planifikuar këtë vizitë për në vjeshtë mu para fillimit të muajit të haxhillëkut, ashtu që pas shërimit me kënaqësi do të shkonim në Mekë për të ofruar falënderime.

Gjatë atyre ditëve të pritjes babai shkonte për të takuar miq të komunitetit pakistanez apo ata vinin për ta takuar atë. Zakonisht gratë e atyre familjeve do të më vizitonin mua. Por unë ndihesha e turpëruar me gjendjen time dhe nuk isha mësuar që të takoja të huaj në shtëpi, ashtu që disa prej zonjave trokitën në derë. Kush do të donte të shikonte gjymtyrë të fishkura, me lëkurë të ndryshuar në të zezë, të rrudhosur dhe të vjerrur, dhe me gjithë ato gishta që ngjiteshin bashkë prej gjithë tkurrjes muskulare? Në një moshë kur vetja ime filloi të ëndërronte për ditën kur do të vishja rrobat e kuqe të dasmës, të qendisura nga ari, e mbushur plotë me xhevahirë dhe me sasi të mirë të të hollave për në shtëpinë e burrit. Unë po përjetoja një të ardhme të vetmuar, e shmangur nga të tjerët, një gjysmë person, asnjëherë të jesh e plotë, një grua e duhur prapa velit të turpësisë.

Ne ishim në katin e dytë të hotelit, në një dhomë komforte pranë asaj të babait. Kishte një hali të trashë dhe banjon e vetë. Me përjashtim të përkujdesjes për mua, Salima dhe Sema, që flinin në dhomën time në shtratën që hapej, duke qëndruar në ndërrime për të më mbrojtur dhe shikuar nevojat e mia, nuk kishin shumë për të bërë. Por koha kalonte mjaft shpejt me librat e mi, me pesë vaktet e faljes dhe me detajet e zakonshme të pastrimit, veshjes, ngrënies që zakonisht zgjasin më shumë tek personi i paaftë. Herë të tjera

dëgjoja zbavitjet thashethemëse të shërbëtove të mia. Ato frikësoheshin të dilnin jashtë për shkak të plaçitjeve të rastit dhe shumicën e kohës parapëlqenin pamjen e botës së jashtme nga dritaret, duke më raportuar se çfarë po shihnin. Reagimet e tyre ishin tipike me ato të vajzave fshatarake të Pakistanit dhe më bënin të qeshja:

- Oh, shiko qytetin e bukur - tha Salima - aq shumë njerëz ecin poshtë dhe lart dhe sa shumë makina që ka këtu

Pastaj do të ndëgjohej zëri i Semës.

Oh, shiko femrat i kanë këmbët lakuriq. Si nuk turpërohen? Meshkuj dhe vajza ecin bashkë dorë për dorë. Ata po puthen. Oh, ata do të shkojnë drejt në ferr.

Që nga fëmijëria e tutje neve na janë mësuar rregulla të rrepta rreth veshjes dhe sjelljes. Ne mbulonim vetën tonë në mënyrë modeste nga qafa në nyje me *shalvar kameeze* të Punxhabit – një tunikë të lëshuar dhe pantollona, të lidhura rreth nyjes. Përreth qafës mbështillnim një shallë të gjatë e të bukur, të gjërë apo *doppata*, që mund të mbulonte kokën tonë po të jetë nevoja apo të tërhiqej mbi faqet tona, dhe ne po ashtu kur ishte ftohtë, mbështillnim veten me shallë. Nëse do të duhej të dilnim jashtë, atëherë vishnim *burka* – një vel i gjatë i padepërtueshëm, duke na mbuluar nga koka te gishtat, me një të çarë të mbuluar me rretë në pjesën e përparme për të shikuar. E bënte të pamundur ndonjë bisedë të zakonshme në rrugë dhe do të zvogëlonte mundësinë për të shikuar dhe dëgjuar trafikun jashtë. Por për kohën që po flas, ne kur nuk dyshonim rregullat që mbizotëronin jetën tonë, dhe në fakt do të ishim të tmerruara të mos përfillnim traditën. Në të vërtetë, ne e ndjenim velin si mbrojtës. Mund të shikonim botën e jashtme, por ajo nuk mund të shikonte në ne.

Kur shikonim se si femrat në Angli vënin në dukje veten e tyre në mini-fustanet jo modeste, që përfundonin mjaft lartë gjurit, ishte e qartë për ne të triat që ky ishte qyteti më i keq në botë.

Në vendin tonë, për më tepër në qytetin tonë, të bisedosh me një njeri që nuk i përkiste familjes tënde të përfaqësohet, qoftë edhe me një shërbëtor mashkull, do të të shpiente në turpërim. I tërë qëllimi i *pardasë* ishte në të vërtetë për të mbrojtur nderin familjar. As edhe afshi më i vogël apo një njollë e dyshimit nuk mund t'i vihej vajzave

të një familje myslimane. Dënimi për një moskujdesje të tillë do të ishte i tmerrshëm.

Tri herë në ditë kamarieri sillte ushqimin në një karrocë. Shërbëtoret do ta merrnin ushqimin nga ai tek dera. Ndonjëherë si shoqëruese do të ishte edhe ndonjë shërbëtoreshë angleze, dhe unë do t'i mbyllja sytë që të mos ia shikoja këmbët.

Unë po bëhesha shumë e plogësht nga ushqimi i hotelit. Babai porosiste pulë çdo ditë për ne sepse kjo ishte *ballall*, mish i lejuar, e therrur në mënyrë të duhur. Mishi i derrit ishte *haram* – edhe ta përmendje emrin 'derr' do të ndotte gojën tënde, edhe deri në ditën e sotme kur flas për të unë e përdori fjalën punxhabe 'barla', që nënkupton 'i jashtëm', sepse e tillë ishte forca e mësimit të hershëm. Çdo lloj tjetër mishi do të mund të ishte po ashtu i dyshimtë se mos do ishte i zier në yndyrë derri. Me pulën zakonishtë vinin edhe perimet dhe orizi, si dhe akullorja për ëmbëlsirë. Ne pinim Coca Cola, dhe kishim rezervë në dhomën tonë. Më merrte malli për pilafin tonë dhe kebabet, edhe për pjeshkët dhe mangot nga lisat tanë.

Babai më ndihmonte për të ngushëlluar shpirtin tim duke më shëtitur dy apo tri herë jashtë. Një herë më dërgoi përreth hotelit, dhe disa herë të tjera më mori së bashku me shërbëtoreshën në rrethinë me taksì. Ai më sqaronte përse anglezët nuk ishin të njëjtë si ne:

Ai thoshte, 'ky është një vend i krishterë'. 'Ata besojnë në Jezus Krishtin si Bir i Perëndisë. Pa dyshim se ata e kanë gabim, sepse Zoti kurrë nuk është martuar dhe si ka mundur të ketë Bir? Por edhe më tutje ata janë ithtarë të Librit sikurse që jemi edhe ne. Myslimanët dhe të krishterët ndajnë të njëjtin Libër.'

Kjo më ngatërroi. Si mund ta ndajnë Librin tonë dhe të jenë aq të ndryshëm nga ne?

'Ata kanë lirinë për të bërë shumë gjëra çfarë ne nuk i bëjmë fare', tha ai. 'Ata e kanë lirinë për të ngrënë mishin e derrit dhe që të përdorin stimulanse. Nuk ka distancë mes mashkullit dhe femrës. Ata bashkëjetojnë pa qenë të martuar, dhe kur fëmijët rriten ata nuk respektojnë të vjetrit. Por ata janë njerëz të mirë, janë të përpiktë dhe kanë parime të mira. Ata e mbajnë premtimin kur e japin. Jo si aziatikët.'

Babai ishte një autoritet në këtë subjekt. Ai punonte me të huaj tërë kohën derisa eksportonte pambukun që ai e kultivonte në Pakistan. 'Ne mund të dallojmë në religion nga ta por ata janë popull i dashur, njerëz që do të bëjnë shumë për ty dhe janë human', përfundoi ai. I peshova kontraditat e anglezëve – njerëz të këndshëm, që jetojnë në një vend të butë, të gjelbër, me të reshura të shpeshta, Libri i të cilëve i udhëhoqi në një liri të tillë. Sidoqoftë Libri ynë lidhej me të tyrin. Cili ishte çelësi i këtij dallimi në mes nesh? Ishte shumë e thellë për një vajzë 14 vjeç – e flaka tej pyetjen time nga mendja dhe fillova të mendoj rreth shkuarjes në haxh për të cilën ne po hipnim në anije. Qe shumë vite para se ndriçimi të vinte, dhe kur erdhi nuk do isha më në gjendje të flakja aq lehtë pyetjen.

## 2. Haxhi

Një aeroplan i bukur i bardhë nga Pakistan International Airways qëndronte si një zog në vendin e nisjes. Derisa po ngritja vigun tım nga karroca ime, ndieja një sens të çlirimit që po lëshoja Anglinë. Kjo vizitë kishte arritur së paku diçka, përfundimin e pasigurisë sonë. Tani kishte ngelur vetëm një shpresë dhe ne po tërhiqeshim drejt saj me një shpejtësi të madhe. Në ëndërrat e mia kisha parë veten të lahem në dritë të pastër si diamanti dhe për mua tani ky ishte një vend i panjohur megjithatë shumë i njohur – qyteti i shenjtë i Mekës, që çdo mysliman apo myslimane dëshiron ta shoh së paku njëherë në jetë.

Në aeroplan ne kishim ulëset në ndarjen e klasës së parë, dhe sërish unë rrija në mes të dy shërbëtoreve të mia, me Semën që vepronte në mbështetje të anës sime të dobët në të majtë dhe Salimën e gatshme për të marrë dhe sjellë gjëra për mua. Babai ishte gati dy ulëse para prej nga vazhdonte edukimin duke udhëtuar:

‘Tani jemi duke fluturuar në 30.000 mijë këmbë lartësi në ajër’ tha ai, kur aeroplani mbaroi ngritjen.

Pashë jashtë dritareve dhe ngela e mahnitur. Ne ishim në një botë brilante të rrezeve të dritës dhe poshtë nesh ishte një kat i reve më të buta në formë të valëve të pambukta, sikurse materiali për shtrojet e nuses.

Salima dhe Sema po shikonin jashtë po ashtu – duke lënë nga një bërthimë të heshtur:

‘Shikoni i tërë ky hekur fluturon në hapësirë’ ata habiteshin duke përdorur një fjalor të përzier punxhabi dhe urdu, i ngarkuar me akcent të rëndë xhang. Unë mezi e përmbaja qeshjen – ato ishin vajza fshatarake të cilët po përjetonin një ngjarje të madhe.

Papritur aeroplani filloj të vërtitej poshtë dhe lart në ajër dhe unë fillova të frikësohesha. Babai sqaroi që kishim goditur një gropë ajri: ‘Mos u shqetësoni. Çdo gjë është e sigurt’, na siguroi ai.

Kishte edhe pelegrinë të tjerë në aeroplan. Unë e dija që edhe në valixhet e tyre sikurse ne kishte petka të bardha- *ibrami*, të cilin çdo pelegrin duhej ta vishte për *haxh*, Pelegrimin.

Një herë, babai më kishte dërguar që të shikoja një film rreth *haxhit*. Ishte për njerëz fetarë, që dëshironin të shkonin në Mekë gjatë

muajit të haxhillëkut, dhe i tregonte të gjitha zakonet me një ngjyrë të mrekullueshme.

Mua më kishin mësuar tërë historinë e lindjes së religjionit tonë në shkretëtirat e Arabisë. Pamja natyrore e këtyre ngjarjeve ishte aq e njohur për mua sikurse pamja e dashur e shtëpisë dhe kopshtit tonë.

Stjuardesa, e cila që e veshur në të gjelbër me një *dopatta* nën mjekërr sa për sy e faqe, solli drekën por unë vetëm sa e gricmova. Salima shikoi në ushqimin e prekur rrallë dhe tha me butësi:

- Bibi-xhi, nuk do të hash për të mbajtur forcën tënde?

Unë tunda kokën: 'Nuk jam e uritur'. Në të vërtetë unë po ndihesha më shumë e sëmurë, pjesërisht nga lëvizjet e aeroplanit dhe pjesërisht nga ekscitimi se çfarë shtrihej para. Nuk i thashë asgjë asaj prej ndjenjave të mia të vërteta. Si do të mund t'i diskutoja me një shërbëtoreshë shpresat dhe shqetësimet që fluturonin nëpër mendjen time si retë që ndiqnin njëra-tjetrën nëpër qiell?

Ne ndryshuam planet tek Abu Dhabi dhe iu bashkangjitëm peligrinëve nga shume vende të largëta. Unë me interes studioja zakonet e tyre që të zbuloja nga vinin. Mësuesja ime Razia e kishte bërë mirë punën e saj. Unë isha në gjendje të identifikoja njerëzit nga Irani, Nigeria, Kina, Indonezia, Egjipti... e gjithë bota dukej se lëvizte drejt Mekës. Kishte një kërcitje në autoparlant. Në dy gjuhëra, anglisht dhe arabisht, mikpritësi na tregonte që po i afroheshim Xheda-së dhe po bëheshim gati të ateronim.

Një shenjë ndriçuese u ndez. 'Duhet t'i lidhim rripat' - tha babai. Ne e bëmë. Salima më ndihmoi kurse babai kontrolloi nëse ishte bërë si duhej.

Jashtë dritareve të aeroplanit unë mund të shikoja shkretëtirën, kodrat ngjyrë të përhimtë që kishin marrë formë gjysmëhëne për shkak të një ere të ashpër, të ngrohtë; mund t'i shikoja malet në horizont shumë milja në largësi, dhe pastaj një qytet që shtrihej poshtë nesh, me ndërtesa të gjata dhe shumë rrugë. Mund të shikoja lisat dhe kopshte të gjelbërta.

- Shiko - tha babai - çfarë uji i bën shkretëtirës. Ka vetëm disa vite kur sollën ujësjellësin nga Vadi Fatima.

Bëra me kokë. Në mësimet e mia kisha mësuar se si pasuritë e naftës u kishin sjellur mjaft përmirësime njerëzve të cilët njëherësh ishin të varfër dhe të prapambetur, duke jetuar në shtëpi baltash nëse ishin



bujq, apo në tenda beduinësh nëse ishin nomadë, duke kaluar pa reshje me vite të tëra.

Aeroplani preku poshtë dhe atje për të na pritur qe një mik i vjetër i babait, një sheik me një veturë të madhe shevrolet. Ky sheik kishte tetë gra dhe tetëmbëdhjetë fëmijë që jetonin në villën e tij gjigante. Trembëdhjetë nga fëmijët ishin vajza dhe pesë djem të vegjël. Unë besoj që ai kishte edhe fëmijë të tjerë të martuar apo që studioin jashtë. Ai kishte pusin e tij të naftës, që u mundësonte atyre një jetë luksi. Përveç kësaj kishte tokë, bagëti si: deve, dhenë dhe dhi.

Kisha mundësinë të shikoja veprimtaritë e kësaj shtëpie të madhe gjatë pesë ditëve të ardhshme, përderisa po përjetonim mikpritjen e sheikut.

Sheiku më prezantoi, me radhë, me të gjitha gratë e tij – Fatima, Zora, Rabia, Rukia....

Nuk kam të preferuar- tha ai - Të gjitha gratë e mia janë të barabarta. E dija përse po e thoshte këtë, sepse Kurani e bën të qartë se njeriu mund të martohet me më shumë se një grua, por, që duhet t'i trajtojë të gjitha njësoj. Profeti, sigurisht, kishte disa gra, por një njeri i zakonshëm, më ishte thënë, e ka shumë të vështirë të zbatojë udhëzimet e tij rreth barazisë dhe paanshmërisë. Andaj poligamia nuk qe inkurajuar shumë në shoqërinë tonë - porse këtu duket të ketë lulëzuar dhe çdo njëri shikohet mirë me njëri-tjetrin rreth kësaj.

Vajzat e shtëpisë, më e vjetra që unë e konsideroja të ishte rreth 18 vjeç, u prezantua me mua me anë të përkthyeses, zonjës Belkize. Ato erdhën në dhomën e grave, ku unë me shërbëtoret isha vendosur, që t'më pyesnin rreth Pakistanit:

A keni ju rrugë? Qytete? Çfarë hani ju? Çfarë perime kultivoni? A i veshni këto lloj veshjesh tërë kohën?

Unë përgjigjesha aq sa mundja, dhe qesh e kënaqur kur shprehën dëshirën të vizitonin Pakistanin dhe t'i shihnin të gjitha këto. Unë, gjithashtu, i pyesja për jetesën e tyre: 'Si jetoni këtu? Çfarë bëni tërë ditën?'

Përgjigjja e tyre dukej të ishte 'shumë e shkurtër'. Sheiku i mbante gratë dhe vajzat në shtëpi. Vajzat të cilat ishin mirë të edukuara, bënin pak përveç argëtimit. Ato kalonin ditën duke përfolur, shikonin televizionin dhe lexonin pak në anglisht dhe arabisht. Sidoqoftë dukeshin mjaftë të lumtura, me çdo dëshirë të plotësuar.

Nëse do të shkonin për të blerë, Belkizja do të shkonte me to dhe do të manovronte me paratë ndërsa ato zgjidhnin çfarëdo që dëshironin.

Sa për gratë e sheikut, përveç blerjes (me ndërtime) apo vizitave në spital me Belkizen ku mbështjellnin veten me *burka* të zeza, qoftë me gjatësi të plotë apo ato turke, të ndara në mes, qëllimi kryesor i tyre dukej se ishte të kënaqnin sheikun. Ato rrinin këmbëkryq në jastëk me mbulesa ngjyrë kadifeje të qendisura në ari apo argjend. Kishte minder përreth dhomës së madhe me dysheme mermeri por ato preferonin më shumë dyshemenë. Ndonjëherë ato vishnin rroba me stil perëndimor të përpunuara dhe shumë moderne të porositura nga Anglia dhe Amerika, me xhevahirë të shtrenjtë. Ajri dukej i rëndë nga parfumet, të stërpikura nga shërbëtorët.

Në mbrëmje para gjumit, unë kisha mundësinë të takoja babanë në dhomën e qëndrimit, për të biseduar dhe krahasuar shënimet.

Sheiku, sipas babait tim, ishte 65 vjeçar, por lëkura e tij e lëmuar dhe jo e rrudhosur fshihte vitet. Ai ishte një kombinim i udhëve të vjetra dhe të reja – ai në veçanti parapëlqente jetën sociale dhe shoqërinë e të tjerëve, duke i argëtuar ata dorëhapur dhe me zemërgjerësi. Ai kënaqej duke pirë duhan me çaj të zi dhe me muzikë arabe dhe këtë e bënte në çdo dhomë, që të mund t'i ndante kënaqësitë e tij. Unë kuptova që kjo ishte tipike arabe. Çdo gjë brenda shtëpisë duhej të ndahej me të gjithë, deshe ti apo jo. Unë megjithëkëtë nuk e kuptoja muzikën arabe.

Kohët e ngrënies ishin momente shumë interesante, ku një qengj i plotë piqej dhe i shërbehej shtëpisë, i ndarë për dhomën e femrave dhe të meshkujve. Darkuesit hiqnin këpucët e tyre para se të shkelnin në halitë shumëngjyrëshe persiane. Ata hanin të mbështetur në jastekët e trashë të vendosur në formë rrethi. Një tabak i madh me oriz me erëza dhe qengji që avullonte ishte i vendosur në mes, ndërsa përreth kishte pjata me domate, oriz, sallatë, rrisqe të holla buke dhe krem vanileje apo *hahvë*. Të gjithë hanin vetëm me dorën e djathtë, duke e shtrënguar orizin në grusht për ta bërë lëmsh, që ta fusnin në gojë dhe pastaj grimconin copëzat e bukës.

Unë haja në dhomën time. Nuk mund të balancoja vetën nëpër ata jastek dhe të haja para aq shumë syve kureshtarë. Por sheiku ishte shumë i këndshëm, duke më lejuar që të bëja ashtu siç doja. Dhoma

ime ishte plot me orendi, si; një hali e bukur, disa lule të gjelbëra, një dritare e bukur, rrethore në formë ombrelle, një pasqyrë e madhe dhe një kthinë e banjës me toalet shpërlarës.

Mikpritja është një gjë që marrin me shumë seriozitet arabët. Buron nga përkujtimet e vështirësive të fiseve për të mbijetuar në shkretëtirat e egra, ku jeta e njeriut mund të varej nga të qenurit të strehuar nga beduinët. Thuhej që në kohët e vjetra, një sheik i shkretëtirës do të mikpriste një mysafir dhe do ta argëtonte për tri ditë pa e pyetur fare për emrin dhe punën e tij. Ky sheik e mirëmbajti traditën duke na mundësuar të shfrytëzojmë tërë shtëpinë e tij, përfshirë edhe veturën dhe shoferin derisa qëndruam tek ai. Kjo nënkuptonte që ne mund të shikonim diçka nga qyteti i bukur i Xhedaës.

Babai rrinte para me shoferin Qazi, të veshur në të bardha, ndërsa unë vështroja nëpër dritaret e qytetit të mbuluara me perde. Ishte një turmë e madhe e pelegrinëve, të cilët kishin zbritur nga anijet në liman apo që kishin shfrytëzuar çdo fluturim për në aeroportin e ri. Shoferi Qazi na i tregonte kontrastet në mes të së vjetrës dhe të resë – një ndërtesë zyrtare dhjetë dyqanëshe përgjatë rrugës së mbretit ‘Abd al - Aziz’ ku viheshin re gomarë të ngarkuar dhe makina të mëdha amerikane. Ne pamë *sugin*, një treg në rrugë, ku njeriu do të mund të blinte nga fasule kafeje deri në hali – edhe ujë të shenjtë të sjellur nga Meka - dhe dyqanet që shisnin mall perëndimor. Ne pamë qytetin e vjetër, me shtëpitë madhështore të tregtarëve, të vjetra me gurrëz të gjatë, me ballkone të zbukuruara, nga të cilat gratë e *haremit* vështronin poshtë në jetën rrugore, por të paparë nga ata poshtë. Në kontrast të madhë ishin shtëpitë e reja me çmim të ultë të ndërthuara në periferi të qytetit.

Kur nuk kishte naftë kishte varfëri dhe probleme të shumta- theksoi Qazi - por tani me naftë ne kemi ushqim të mirë dhe fëmijët tanë mund të mësojnë.

U ndalëm në një vend për të shikuar se si nxjerrej nafta nga toka. Nuk më pëlqente era e saj.

Ne e lamë sheikun për të udhëtuar në Mekë të ngushëlluar dhe mjaftë të përkrahur, meqë ai insistonte që ne të merrnim makinën dhe shoferin e tij. Babai e falënderoi atë me një fjalim të vogël:

Ju keni treguar një zemërgjerësi dhe miqësi të ngrohtë për ta bërë udhëtimin tonë më të lehtë.

Sheiku do ta kishte bërë këtë për çdo vizitorë të tij, por unë e dija se ai e kishte bërë në veçanti për ne këtë, sepse ishte një mik i vjetër i familjes sonë dhe partner biznesi me babanë, me interes për të blerë dele dhe dhi të rritura, për të cilën regjioni ynë ishte i famshëm.

U nisëm shumë herët në mëngjes për të udhëtuar në Mekë, menjëherë pas faljes, sepse donim që të kishim kohë edhe për të shikuar gjatë rrugës. Autostrada e re katër linjëshe ishte shumë e mirë, dhe taksitë e shpejtë, kamionët dhe autobuzët nguteshin, duke bartur grumbuj të panumërt të pelegrinëve për udhëtim e katërdhjetë e pesë mijëshe për në Mekë. Kishte edhe të tillë që ecnin në këmbë në mënyrë trimërore, të përgatitur edhe të piqeshin kur dielli do ngritej lart, dhe këtë jo sepse ishin të varfër por, po e ripërsëritnin udhëtimin e Abrahamit, ku ai shikonte për një stehim për Hagjerën dhe Ismaelin.

Nuk do e pranoja, por gati që më vinte mirë që isha e gjymtë, vetëm që të mos ecja në atë nxehtësi përvëluese nga dielli që po digjte. E dija që kjo nuk ishte në frymën e haxhillëkut, sepse kërkonte një nënshtrim të plotë dhe sakrificë, prandaj edhe nuk thashë gjë.

Qazi, shoferi ynë, i vënte në dukje kanionat e ujit përgjatë rrugës dhe llambat elektrike të lidhura në shtylla për t'i ndriçuar udhëtarët:

‘Mbreti e ka bërë këtë. Ai vetë vjen këtu me shërbëtorët e tij dhe princeshën për të hapur haxhillëkun çdo vit, dhe ai ka përmirësuar shumë objekte në vendin e shenjtë’.

Pesëmbëdhjetë milja larg qytetit një shenjë na paralajmëroi ‘Zonë e ndaluar. Vetëm myslimanët lejohen.’ Disa prej ushtarëve në pikat hyrëse kishin armë, dhe ata po kontrollonin kalimet e njerëzve. Shoferi bisedoi me ushtarët dhe atëherë na është lejuar të vazhdojmë me makinën tonë.

Ne përparonim shumë ngadalë duke i kapërcyer kodrat nëpër një rrugë të ndërprerë nga gurëzit, kaluam një turmë të adhuresve të veshur në të bardhë, të cilët po ndiqnin rrugën e Abrahamit pasi Sara e dëboi gruan shërbëtore dhe të birin e saj.

Veshët tanë ishin të mbushur me zërin e lutjeve dhe këngëve fetare, vargjeve nga Kurani i Madhërishtëm dhe nga deklarimi:

'Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Allahut.'

Pastaj u sollëm rreth bregut dhe qytetit të shenjtë që ishte i bardhë dhe ndriçonte nga rrezet e mëngjesit që kishin filluar të digjinin, dhe unë gati sa pëlcisja nga pamja poshtë nesh. Shoferi e ndaloi makinën dhe zëri i pelegrinëve shpërtheu nga buzët tona në një mënyrë të themi jovullnetare:

'Ja ku jam në shërbimin tënd, o Allah! Ja ku jam në shërbimin tënd; Ja ku jam në shërbimin tënd; Nuk ka asnjë si ty; Ja ku jam në shërbimin tënd; ty të përket lavdia, pasuria dhe zotërimi i botës. Nuk ka asnjë si ty.'

Qyteti i Muhamedit - tha babai - vetëm mendoni, profeti predikoi në këto rrugë.

Një ndjenjë e çuditshme e qetësisë erdhi në mua. Të gjitha shqetësimet për të ardhmen time u ngritën. Për një moment u ndjeva si pelegrinët e tjerë, kërkoja një fuqi që nuk mund ta shihja, të përjetshme dhe aq misterioze sa të shtatë kodrat që rrethonin qytetin.

### 3. Uji i jetës

Kampi i haxhilerëve - apo pushimi i pelegrinëve ishte disa rrugë nga xhamia Haram. Udhëheqësi ynë, Abdullahi, të cilin e kishte gjetur për ne miku ynë sheik, na mirëpriti tek hyrja. Ai dhe babai kapën duart dhe u përqaftuan.

Mirë se erdhët - *tha Abdullahi.*

Dhe për ty - tha babai, me këtë pranim shumë të lehtë të këtij arabi si një vëlla dhe të barabartë, e cila në fakt ishte një cilësi shumë karakteristike e haxhillëkut.

Ju lutem hyni. Jeni të mirëseardhur në emër të Allahut- tha Abdullahi - E kam marrë letrën e shkëlqesisë, sheikut. I kam rregulluar dhomat për ju...? Më pas vazhduan bisedimet rreth qengjave për flijim. Babai porositi dy për çdo person, edhe për shërbëtoret - gjithsej tetë. Një dridhje e vogël e gëzimit më kaploi mua. Festimi i flijimit (*Eid al Adha*) për nder të patriarkut Abraham, që ishte i gatshëm për të sakrifikuar të birin e tij Ismaelin, ishte pika më e lartë e pelegrinazhit. Babai siguronte që lutjet tona të kishin efikasitet të veçantë, me gjakun e aq shumë qengjave.

Dhomat tona ishin të gjitha në rend dhe në të njëjtin kat. Kishim dy dhoma së bashku me banjot, të furnizuara shumë thjesht dhe zakonshëm, me *charpais* për të fjetur. Po mendoja me mallë për shtrojet e mia të mbushura me pambuk mbi *palung* në shtëpi.

Shtrojet e leshta të qendisura me pe ne maje te tyre nuk ishin dhe aq të përshtatshme, në veçanti derisa kthehesha me pjesën time të majtë të paralizuar. Kjo megjithatë ishte e tëra rreth shkuarjes në haxh. Me qindra mijëra njerëz do të takoheshin rreth Mekës çdo ditë, duke u ndrydhur nëpër hotele dhe shtëpi mysafirësh, apo edhe duke fushuar nën qiellin e hapur. Atje do të kishte pak rehati për këtë dhe jo krekosje për ekspozimin e pasurisë. Babai sqaronte që e mira do të humbiste nëse do të kishte një zë ankimi, nëse do të ishin të ashpër dhe krenar, apo nëse ndonjëri do të humbiste kontrollin në të nxehtë dhe nën këto kushte stresuese.

Një freskuese elektrike në tavanin e dhomës sonë largonte të nxehtin, ajrin e dendur përreth, në përpjekje të pafrytshme për freski. Kishte perde të blerta nëpër dritare, për të mos lejuar depërtimin e diellit brenda, që ofronte një ndjenjë të lehtë i të të

qenurit në një tenk të peshqve. Veç kësaj kishte edhe roleta të holla metali nëpërmjet të cilit mund të vështroja nga larg pamjen e minareve të xhamisë së madhe, që drejtoheshin lart si gishtërinj.

Duke pushuar në *charpain* tim dëgjoja zvarritjen e pafundme të sandaleve të lëkurës të mbathur nga pelegrinët. Zëri i tyre arrinte në babelin e gjuhëve të huaja. Të gërshetuara nëpër përbërjen e zërit ishin edhe këngët fetare hipnotike të vargjeve nga Kurani dhe *Allahu Ekber* – ‘Allahu është më i madhi’. Një rrënqethje më thumboi. Të jesh këtu ishte mirë, një përjetim i mjaftueshëm gjatë tërë jetës. Shërbëtoret e mia e ndjen këtë po ashtu:

‘Sa fatlume jemi për të qenë shërbëtoret e tua dhe për të qenë në Haxh’ - tha Salima, përderisa ajo dhe Selma më ndihmuan ta bëja dushin e dytë për t’u freskuar gjatë ditës. Për ta ishte me të vërtetë moment i veçantë sepse shumë njerëz të devotshëm përgjatë tërë botës në këto momente kishin mall për të qenë këtu, por që për shkak të kohës apo shpenzimeve nuk ia arrijnë. Haxhillëku do të merrte deri në një muaj, nëse ata do të vizitonin të gjitha vendet e shenjta.

Babai kishte gjetur ca prej shokëve të tij tregtarë nga Lahora, Ravalpindi, Peshavari dhe Karaçi, por për të gjithë nuk kishte më biseda për çmimet rreth pambukut dhe grurit. Oh jo, këtu çështjet e botës biejnë poshtë dhe po ashtu të gjitha dallimet e lindjes, origjinës nacionale, arritjes, punës apo statusit. Në sallën e madhe të ngrënies në kampin e haxhilerëve shërbëtorët uleshin për të ngrënë me zotëritë e tyre dhe të gjitha diferencat mbulohehin me *Ibrahim* – veshja e pelegrinëve. Meshkujt veshnin një çarçaf pambuku të pa qepur të mbështjellur përreth gjysmës së poshtme të trupit, dhe me një tjetër përreth krahëve. Të gjitha femrat kishin të veshur rroba të bardha të gjata dhe të thjeshta, me koka të mbuluara dhe çorape të bardha, por që ecnin të pambuluara. Duke ecur në hapat e profetit, njerëzit kanë të njëjtën vlerë nën dritën e Perëndisë. Babai më kishte thënë njëherë me një shprehje të seriozitetit më të thellë:

‘Një herë që të veshësh Ihramin, ti ke lënë jetën tënde të mëparshme dhe ke hyrë në jetën e re. Në një mënyrë është mbulesa jote. Nëse vdes në këtë veshje, do të shkosh drejt në qiell, pa u ndalur.’

Në rrugë, derisa babai shkonte për t’u falur në xhami kishte takuar një shok të vjetër shkolle:

‘Attaullahu është këtu. Ai është një mysliman i vërtetë - jep lëmoshë të varfërve në Pakistan. Dhe ai është shumë njeri fetar. Kjo është vizita e tij e tretë.’

Dhënia e një pjese nga të hyrat e njeriut për ndihmë të varfërve, e njohur si *zeqat*, është shtylla e tretë e islamit. Shtylla e katërt është disiplina e agjërit nga agu deri në perëndim të diellit përgjatë muajit të nëntë kalendarik lunar – muajit ramadan. Është pas këtij muaji kur taksat për të varfërit ose zeqati jepet.

‘Ti je shumë fetar po ashtu baba’ mendova. ‘sepse ti jep lëmoshë dhe kjo është vizita e tretë po ashtu, dhe kush veç teje më ka mësuar mua t’i them lutjet.’ Shikova në ballin e tij. Aty ishte qart e shënjuar ulja, e quajtur *mihrab*, pas përkuljes së shenjtë në këndin që drejton kah Meka në çdo xhami. Kjo vjen përmes prekjes së përsëritur të ballit në tokë përgjatë ritualeve të faljes. Dikujt i duhet vetëm që të shikojë këtë për të kuptuar njeriun e lutjes – dhe lutja është shtylla e dytë e islamit.

Ditën e parë nuk dola fare jashtë por qëndrova duke u lutur dhe lexuar Kurandin e Madhërishtë dhe përgatisja vetën për ditët e ardhshme të vizitës në Qabe, që mund të jenë shumë të lodhshme në të ngrohtë, duke u shtyrë nga shumë njerëz. Salima dhe Sema sollën ushqim në dhomën time dhe qëndruan me mua.

Ka aq shumë njerëz dhe më tutje është shumë qetë- tha Salima gjatë mbrëmjes. Rrugët qenë të mbushura me pelegrinë, porse edhe më tutje kishte aromë të një qetësie shpirtërore. Nuk kishte përshpejtime tërbuese. Të ishe në këtë vend ishte njëjtë si parajsja – plotësimi i dëshirave.

Kur myezini thirrte në mëngjes nga minaret e xhamive, të gjithë në Mekë ndaleshin aty ku ishin duke u kthyer kah Qabja, simboli më i lartë i unitetit për miliona myslimanë në të katër anët e botës. Ata rrinin drejt, duart e hapur në çdo anë të faqeve duke u lutur ‘Zoti është më i madhi’. Krahët e zbritur poshtë dhe dora e djathtë e vendosur mbi krahun e majtë, mbi mesin e trupit për femrat kurse më poshtë për meshkujt: ‘E tërë madhështia të përket ty o Zot! Dhe lavdia të takon ty; i bekuar dhe i lartësuar është emri i yt Madhëria juaj; dhe adhurimi ynë nuk i takon askujt tjetër përveç teje.’ Pastaj vijuan disa prej lutjeve të tjera, Fatiha, disa vargje nga Kurani, pastaj Allahu Akbar. Në këtë moment besimtarët përkuleshin nga ijet,



duart në gjunjë: 'Sa madhështor është Zoti im, më i Madhil!' Ata pastaj rrinin drejt, duart anash: 'Zoti e ndëgjon atë që e lavdëron atë; Zoti ynë lavdia të takon vetëm ty.' Pastaj duke thënë Allahu Akbar ata binin në tokë: ' Madhështia i takon Zotit tim, më të Lartit' (tre herë). Atëherë do ngriteshin dhe do rrinin në pozitë të ulur; 'o Zoti, më fal mua dhe ke mëshirë ndaj meje.' Ata binin në tokë sërish. Kjo ishte një rekat i plotë e cila do të duhej të përcillej nga disa përsëritje të lëvizjeve dhe lutjeve.

Si një person i sëmurë, unë i kryeja ritualet e shenjta me ndihmën e shërbëtove të mia, uljen, përkuljen, apo mihrabin në shtrojen e lutjes sime duke u drejtuar drejt Qabes.

Po zgjohesha nga gjumi nga një ëndërr mistike në dhomën time në shtëpi apo isha me të vërtetë duke i thënë lutjet këtu në qendër të botës? Një rrëqethje e thellë kaloi nëpër mua, një përjetim hutues. 'Të jesh këtu o Zot mjafton edhe nëse nuk mund të eci.' Të shikosh vërtet me sytë e tu Shtëpinë e Perëndisë, të ndërtuar nga Abrahami, ishte një dhuratë që dikush do të mund të jetonte për të tërë jetën e tij.

'Është e vërtetë ti ke jetuar 14 vjet si një person i gjymtë' i thashë vetës time'. 'Por këtu ku besimi është më i forti, ku shumë lutje janë në fokus, Perëndia do t'i dëgjon lutjet familjare dhe Muhamedi do t'i kërkojë atij për të të shëruar.'

Kur unë mendoja për Perëndinë asnjë figurë nuk më vinte në mendje, sepse kush mund të imagjinonte një qenie të përjetshme? Ai, i thirrur me më shumë se nëntëdhjetë e nëntë emra në Kuran, ishte edhe më tutje i panjohur. Nuk kishte asgjë humane me të cilën ai mund të krahasohej, kështu isha e mësuar. Por buzët e mia lëviznin drejt fjalëve të Fatihasë së mbajtur gjatë në zemër:

'Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm te ti kërkojmë ndihmë,

Udhëzoni për në rrugën e drejtë?

Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira ...'

Për një jetë myslimane ekziston një rrugë dhe çdo individ është diku në atë rrugë në mes të lindjes dhe vdekjes, krijimit dhe gjykimit. Unë

poshtu kisha hyrë në pelegrinazh në të cilën, edhe pse nuk mund të parashikoja fundin, do të zgjaste deri në fund të ditëve të mia.

Të nesërmen në mëngjes të gjithë ishim të zgjuar para agimit, dhe pas faljes dhe ngrënies së mëngjesit të hershëm filluam të ecim për në Qabe. Babai kishte ndërmarrë çdo gjë të bartesha me karrocë përderisa shërbëtorët e mia ecnin përgjatë saj, kurse ai me hapa të mëdhenj ecte para. Shumë të sëmurë dhe të vjetër barteshin në këtë mënyrë. Unë rrija e mbështetur duke përjetuar skenën, e cila ishte një prej kënaqësive më të mëdha, derisa mijëra burra dhe gra të të gjitha moshave dhe nacionaliteteve ecnin drejt shtëpisë së Perëndisë. Unë asnjëherë në jetën time nuk kisha parë aq shumë njerëz në një vend, aq të fokusuar në një objekt – as edhe në Lahore apo Ravalpindi, kur babai më merrte në makinën e tij, as edhe në Londër. Fluksi i njerëzve lëviste përpara, me një qëllim, me një përfundim, duke u lutur derisa ecnin, apo duke recituar vargje ritmike.

Muret e jashtme masive përshkonin portat e shumta, që rrethonin xhaminë e vjetër Haram. Para se të hynim në duhej t'i nënshtrroheshim një kontrole trupore nga meshkuj dhe femra të stacionuara tek portat. Babai më kishte paralajmëruar për këtë:

Është thënë që të pabesët kanë tentuar më shumë se një herë të depërtojnë në vendet tona të shenjta për të bërë djallëzi, dhe për t'i ndotur ato.

Çfarë u ndodhi atyre baba? - pyeta me frikë.

Oh më merr mendja se janë pushkatuar'- tha ai. U drodha nga dënimi, por ndjeva që kishin merituar, për shkak të fyerjes.

Hymë në arenën e madhe, të dominuar nga minaret e larta. Në qendër të kësaj qëndronte xhamia, e filluar në shekullin e VIII dhe tani e zgjeruar sa për të pranuar me mijëra adhurues. Grupi ynë kapërceu qilimet me këpucët në duar që i lamë në shkëmbim me biletat e numëruara. Pastaj kaluam nëpër një portë për tek sheshi i brendshëm. E gjetëm vetën në një hapësirë të hapur gjigante, në qendër të së cilës qëndronte graniti i madh në formë kubi me pëllhurë mëndafshi të zezë të zbukuruar me ari nga emrat e Perëndisë.

I tërë vendi i hapur ishte në të bardhë nga mijëra e mijëra njerëz, të gjithë të kthyer me fytyra drejt Qabes. Përreth Qabes njerëzit ecnin apo vraponin në drejtim të kundërt me akrepat e orës.

Shtigje të shumta të mermerta rrezatonin nga qendra. Ne ecëm në njerën prej tyre dhe arritëm në një pjesë rrethore ku më transferuan në *palkin-in* e drurit apo vigun e bartur nga katër burra të fuqishëm, derisa u përfshim në turmën që sillej rreth figurës. Rreth Qabes kaluam tri herë duke vrapuar, katër herë duke ecur, kurse unë ulur në *palkin-in* tim si një pjesë e shkumës në një majë të malit. Çdo herë që kalonim gurin e zi, të vendosur aty nga Muhamedi me duart e tij, në skajin veri-lindor ne ngrinim duart dhe bërtisnim Allahu Ekber – ‘Zoti është më i madhi’. Ishte pak e papërshtatshme për mua dhe unë shikoja te babai me shqetësim, por ai dukej se ishte i pavëmendshëm nga të nxehtit, nga shtypja e turmës dhe jokomoditeti. Të ishte këtu, qe e gjitha, qe ai dëshironte.

Në rrethin tonë të fundit ne gjetëm vetën tek guri i zi. Mbaj mend që më ishte thënë se ky qe një gur, i cili i ishte hedhur Adamit nga Perëndia. Ishte një simbol i fuqishëm i besimit tonë, i prekur nga Perëndia, Adami dhe Muhamedi. Bartësit e mi na shtyen para dhe e ulën *palkin-in* tim. Më ndihmuan të përkulem para për të puthur gurin e zi. Ishte i rregulluar me argjend dhe i parfumosur. Unë i mbylla sytë duke rënë në kontakt me profetin. Guri nuk dukej aspak si një gur. Ishte i ngrohtë në buzët e mia dhe rreth meje kishte një ndjenjë paqeje. Thashë ‘të lutem më shëro dhe të tjerët po ashtu.’

Por asgjë nuk ndodhi. Salima dhe Sema më tërhoqën drejt dhe ne kaluam. Unë e mbaja kokën ulur, për të mënjeluar vështrimin brengosës të babait. Pastaj lëvizëm tek vendi i lutjes së Abrahamit dhe ofruam një lutje për dëshirën tonë më të përzemërt. ‘Të lutem më shëro thashë.’

Rituali i ardhshëm ishte për të vrapuar në mes të Safas dhe Marvas, dy kodra të vogla brenda xhamisë së madhe, rreth gjysmë milje larg. Thuhet që Hagjerja dhe Ismaeli janë të varrosur nën këto bregore.

‘Qenka një lojë e mirë’ mendova, por e mbajta për veten time. Qeshja nuk do të funksiononte këtu sepse gjithë të tjerët do e merrnin shumë seriozisht. Kalova prapa tek karroca për të përparuar përgjatë shtigjeve të mermerta në mes Safas dhe Marvas shtatë herë, duke gjurmuar lëvizjet e Hagjerës derisa kërkonte ujë për të birin e

saj Ismaelin pasi ishin përjashtuar. Sipas traditës thuhet që Perëndia hapi një burim të ujit aty afër, abb-a Zamzam (uji i jetës). Njerëzit e blenin ujin dhe pinin nga gotat e metalta. Babai pa që po pinim dhe bleu një termos uji të ndahej në kampin e haxhilerëve. Pak nga uji do të kthehej prapa në Pakistan, kurse pjesa tjetër ishte për mua që të laheshja me të.

Këto rituale morrën pjesën më të madhe të ditës, pa ushqim dhe pushim dhe pastaj u kthyem në kampin e haxhilerëve për të pritur ngjarjen e ardhshme. Kjo ishte një ecje për në Arafat, një vend rreth shtatë milja larg Mekës ku myslimanët thonë se Perëndia kishte sprovuar Abrahamin për të flijuar të birin e parëlindur Ismaelin. Kur Perëndia pa bindjen e Abrahamit ndali flijimin dhe në vend të tij siguroi dashin e zënë në shkurre si zëvendësim. Mendoj që vizituam dhe Minën dhe në rrugë për atje dhe prapa, hodhëm gurë në të tri shtyllat, që përfaqësojnë djallin i cili tundoi Abrahamin, që të refuzojë flijimin e të birit të tij. Çdo kush qeshte tek shtyllat e shëmtuara derisa hidhnin gurë apo këpucë. Të hedhësh këpucët ishte një fyerje e madhe.

Pastaj ne shkuam tek vendi i flijimit, menjëherë jashtë qytetit, dhe qëndronim në rresht derisa arritëm kasapin, që dinte për qengjat tanë. Ai mbante thikën me një dorë dhe qengjin në tjetrin dhe unë vendosa dorën time tek thika, kurse kasapi bëri therrjen. Gjaku rrjedhte nga qafa e qengjit nëpër koritë duke u përpëlitur dhe dridhur sikur të donte të largohej nga aty. Nuk ndjeva asgjë për qengjin – vdekja e tij po përmbushte urdhërin e flijimit. Pastaj një kasap tjetër erdhi dhe morri qengjin mënjane dhe hoqi lëkurën e tij. Ne nuk mund të rrinim që të shikonim therrjen e të gjithë qengjave nga rreshtat që ishin shumë të gjatë, por e tëra ishte shumë mirë e rregulluar. Qengjat tanë do të kontrolloheshin dhe do të ofroheshin më vonë. Ne shikonim derisa njerëzit e tjerë vinin në vendin tonë për të ofruar qengjat, dhinë apo devetë e tyre. Babai tha se deri në gjashtë veta mund të ndanin flijimin e devës. Unë isha e kënaqur që nuk qëndruam më gjatë për të parë therrjen e devës.

E dija çfarë do t'i ndodhte mishit. Babai më kishte treguar:

‘Një pjesë e saj shkon për të varfërit – ata hanë mirë gjatë haxhillëkut. Një pjesë do ta hanim ne në kampin e haxhilerëve.

Shumë prej saj do të digjej. Nuk mund të mbahej dot në këtë të nxehtë.

Pelegrinët qëndruan në Mina edhe për tri ditë, dhe në ditën e dytë rifilloi veshja e zakonshme, duke i bërë rrugët e ngrohta e të pluhurosura të lulëzojnë nga ngjyra brilante e kostumeve të nacionaliteteve. Meshkujt i rruanin kokat e tyre apo prenin flokët shumë shkurtë, dhe gratë i kishin po ashtu të prera së paku për një inç. Çdo kush i uronte njëri-tjetrit 'Urime haxhillëkun'. Këto ishin ditë të festimit me miqtë e vjetër e të rinjë. Qe po ashtu një kohë e bisedimeve rreth ndryshimeve dhe pajtimeve me të tjerët.

'Bota do të ishte një vend më i lumtur po të mbanim frymën e haxhillëkut për pjesën tjetër të jetës tonë' - tha babai im.

Ne megjithatë, nuk qëndruam në Mina për shkak të paaftësisë sime, por u kthym në kampin e haxhilerëve. Menjëherë pas kthimit, u ula në vaskë në banjën e thellë, e ndihmuar nga Sema, duke i recituar lutjet derisa Salima derdhte ujin nga Zemzemi mbi mua nga një kovë plastike.

Unë me të vërtetë prisja në atë moment të shërohesha, që kjo paralizë që kisha të hiqej. Por në fakt asgjë nuk ndodhi. Trupi im edhe më tutje ishte i rëndë si plumbi. Zemra ime ishte edhe më e rëndë ndërsa shërbëtoret e mia më ngritën dhe më veshën.

Për një kohë të shkurtur, babai im, që po priste në dhomën tjetër, duke më paramenduar të eci nëpër derë me dy këmbët e mia, erdhi për të më takuar.

'Sot nuk ishte vullneti i Allahut. Por ne nuk do të humbasim shpresën. Perëndia është më i madhi' - tha ai, dhe pastaj u largua në mënyrë të qetë.

Pas këtyre ritualeve shumë prej haxhilerëve do të ktheheshin në shtëpi, për të qenë të respektuar në vendet e tyre. Disa njerëz në të vërtetë edhe do të vendosnin para emrit të tyre titullin haxhi apo të vendosin në dyqanet e tyre shenjën për të treguar se janë të ndershëm.

'Unë do të doja të besoja për disa prej tyre' - tha babai, duke aluduar thjesht me një buzëqeshje.

Shumë si ne, vazhdonin për Medinë, qyteti i dytë për nga rëndësia për myslimanët, 250 milja larg, ku jetoi Muhamedi për 10 vjet pasi që larguar nga Meka dhe ku themeloi islamin më 622, duke filluar erën

muslimane. Ai jetoi këtu pjesën e fundit të jetës së tij, dhe ne donim të shihnim përmendorën e tij. Shumë tregime që më rrëqethnin si fëmijë sillëshin rreth këtij qyteti.

Xhamia në Madni qe madhështore. Ne ecnim në qilimin e trashë dhe të bukur dhe paguam nderimet tona në varrin e Muhamedit. Ishte i mbuluar, i mbështjellur me qilim dhe i rrethuar me qelq. Njerëzit ecnin përreth dhe puthnin varrin nxitimthi nëpërmjet qelqit. Ata po ashtu hidhnin aty para dhe kurora me lule. Kujdestarët i merrnin ato dhe dekoronin varrin me to.

Njerëzit uleshin përreth oborrit dhe këndonin këngë fetare. Meqë babai ishte *Pir* ai pyeti nëse ishte e lejuar t'i afrohesha varrit të Muhamedit. Kujdestarët e hapën derën për mua dhe unë u ula pranë derës në karrocë për dy apo tre minuta duke u lutur. Ishte një përvojë e mahnitshme. Ne vizituam edhe varret tjera në afërsi, pastaj mbaruam duke parë kopshtin e hurmave të Fatimes. Muhamedi e kishte bërë për vajzën e tij. Ne blemë një shportë me 15 kilogramë hurma (shumë të shtrenjta) për të ndarë me familjen në shtëpi.

Në Medinë u përshëndetëm me Qazin dhe babai i dha atij pak *bakshish* si dhuratë në një zarfë. Ai ishte i këndshëm dhe shumë ndihmues, dhe duke i përcjellur përshendetjet tona, ne u ndjehëm keq se ai do të duhej të kthehej prapa me makinë për në shtëpinë e sheikut.

Nga Medina ne fluturuam në Bethel Mukodus (Jerusalem), të cilin e gjetëm plot me pelegrinë të tre besimeve; myslimanë, hebrej dhe të krishterë. Pelegrinazhi ynë, që ndryshon kohën çdo vit, nga dhjetë ditë sipas hënës, këtë vit përputhej me Pashkën hebreje dhe ato krishtere. Xhamia në Jerusalem quhej Al-Masxhid al-Aga, xhamia më e largët, drejt së cilës Muhamedi lutej para se Meka të bëhej qendra e tij.

Kubja e Shkëmbit menjëherë pranë saj, është e lidhur me Abrahamin. Davidi e bleu kurse Solomoni e ndërtoi tempullin e tij këtu, të cilin Titu e shkatërroi, dhe këtu profeti Jezus ecte dhe bisedonte. Sot hebrejtë vajtojnë pranë murit të mbetur për lavdinë e humbur.

Ne qëndruam vetëm për një natë në një vend afër Kubes së Shkëmbit, por unë nuk e vizitova, sepse ndihesha shumë e shqetësuar për shkak të mos shërimit tim.

Ditën e nesërme vazhduam për Karbala, në Irak, për të shikuar ku nipi i Muhamedit, Hyseini, familja e tij dhe shërbëtorët, që përbëheshin prej 72 njerëzve, qenë të varrosur. Kjo qe një ngjarje e një beteje të tmerrshme, ku Hyseini dhe 72 shërbëtorët trima shkuan kundër Kalifit Yazid i Sirisë, dhe u martirizuan. Që atëherë myslimanët shiitë e kanë përkujtuar çdo herë përvjetorin e vdekjes së tij, me parakalime vajtuese nëpër rrugë ku burra dhe djem do të shkonin duke fshikulluar veten e tyre. Në muajin Muharrem njerëzit do visheshin në të zi dhe asnjë, si në qytetin Xhang, nuk do të paramendonte për ndonjë ceremoni familjare.

U lutëm për shërim në Qerbela, por asgjë nuk u dha. Ne ishim në pelegrinazh për një muaj dhe tani po vinte koha të ktheheshim prapa. Dhe derisa po prisnim aeroplanin për Karaçi, babai shikoi në mua:

Zoti është duke të sprovuar ty dhe mua. Mos u bëj e pashpresë. Mbase në një periudhë të jetës sate do të shërohesh.

Babai i mirë, i dashur, aq i durueshëm dhe besnik, po provonte të më inkurajonte, dhe këtë ia arriti. Besimi im i venitur u përtëri.

I thashë: - 'mirë, nuk do jem e pashpresë; do t'i jem besnik profetit dhe Zotit' - dhe pastaj qesha për të treguar që nuk ishte problem shkuarja ashtu siç edhe erdha.

Ai u ndal dhe më puthi.

Unë e prisja këtë nga ti - tha ai.

Edhe shërbëtorët po ashtu pëshpëritën: Bibi, vetëm prit ndaj Zotit.

Kështu ne fluturoam prapa në Lahore, përmes Karaçit, duke ndjerë që një bekim i veçantë kompenzues do të më vinte për shkak të pelegrinimit, por e vetëdijshme që duhej të prisnim kohën e Zotit për t'u zbuluar. U takuam me familjen tonë në aeroport, dhe me shërbëtorët tanë. Ata sollën kurora të luleve të portokallit me erë të këndshme dhe lule të verdha marigoldi për të vënë rreth qafës. Të gjithë ata na prekën dhe thërritën Allahu Ekber, sepse ishte bekim për të prekur një haxhi. Ata shikuan në mua, ende e gjymtë, por nuk bënë koment.

Babai u tha vëllezërve dhe motrave të mia:

Perëndia nuk është një Perëndi i padrejtë. Duhet të kemi durim për të pritur kohën e Perëndisë.

Ashtu është. Motra jonë duhet të ketë durim për të pritur.

Ne kaluam natën në Lahore në një shtëpi përdhese të familjes sonë dhe udhëtuam prapa të nesërmen në një konvoj makinash, duke u përshëndetur nga pjesa tjetër e familjes me një mikëpritje të ngrohtë.



## 4. Dasma

Të kthehesh nga haxhillëku ishte aq emocionuese sa dhe të shkosh atje. Më lerë të të preki - tha Samina, duke dashur të dëgjoj sërish dhe sërish, të gjitha që ne kemi parë dhe bërë. Çdo herë ishte kështu sa herë që pelegrinët ktheheshin nga Meka. Turmat e njerëzve do të vraponin për tek stacioni duke bërë titull 'Ja Muhamed' dhe 'Ja resul Arbi' dhe do provonin për t'i prekur haxhillerët, derisa ata po zbrisnin nga treni nga Karaçi. Për këtë arsye ata do të marrin pak nga bekimet falas që të tjerët i kishin fituar me një çmim aq të lartë.

Kënaqësia zgjati një muaj, gjatë së cilës të afërmit do të udhëtonin nga larg dhe afër, dhe njerëzit e qytetit vinin po ashtu, me dhurata të vogla – dhe kjo ishte në fakt një traditë pas ardhjes në shtëpi. Të afërmit dhe miqtë e veçantë merrnin shishe tona me ujë të jetës nga burimi Zemzem. Një shishe i takoi *maulvisë*, i cili vinte për të diskutuar Kuranin dhe Hadithin me babanë për shumë orë çdo javë. Sa për mua, çdo kush thoshte: 'Zoti të bekoftë', por me një kuptim të ri tani meqë isha bërë haxhe. Në fakt, ajo që të gjithë donim, ishte shërimi im, por kjo nuk u realizua. Nëse do kishte emocione kritikizmi rreth kësaj, asnjë nuk afrohej. Ata të familjes thjesht psherëtinin dhe më puthnin duke thënë:

- Zoti do të të shëroj në të ardhmen, Bibi-xhi. Ne duhet t'i përkulemi vullnetit të tij. Andaj edhe pse kishte një pikëllim të vërtetë në zemrën time, për shkak të dështimit të qartë të qëllimit tonë, në një mënyrë tjetër kishte një rritje. Kam parë më shumë se disa në qytetin tonë, ku njerëzit do të kursenin tërë jetën e tyre dhe më tutje të mos kishin para të mjaftueshme për të shkuar në pelegrinazh. Ky intensitet i ndjenjave që kisha përfituar në Qabe ngeli me mua, duke më bërë turbullsisht të vetëdijshme që për disa kjo ishte një udhëtim – sikurse 'udhëtimi i zemrës' i sufive – për të cilët shkuarja në haxhillëk ishte një simbol i jashtëm. Caku i këtyre udhëtarëve ishte domosdoshmëria për t'u nënshtruar plotësisht ndaj vullnetit hyjnor – islam do të thotë 'nënshtrim'. Unë nuk do të isha futur mjeshhtërisht - kisha 14 vjeç, megjithatë më kujtohet sesa fuqishëm rritej siguria në mua që të rrija larg çdo gjëje që do të më ndotte për të përkushtuar vetën më shumë e më shumë ndaj lutjes.

Kur ezani ndëgjohej, përkulja ime ishte me një qëllim të qartë, kur lutesha mbi qilimin dhe të kthyer kah Qabja e Salima duke më ndihmuar. Nuk qe vetëm sepse isha e mësuar, por që ndieja nevojën. Në kohë të ndryshme gjatë ditës, duke mos ditur për një mënyrë tjetër të ofrimit të lutjeve të zemrës sime për një prekje shëruese, unë lëvizja me gishtat e mi kokërrzat e tespive të sjellura nga Medina, duke përsëritur fjalën Bismillah (emrin e Zotit) me çdo kokërr. Por duke mos kuptuar në asnjë mënyrë vullnetin e Perëndisë në esencë, dhe duke mos patur ndonjë përmirësim në këtë aspekt, unë vazhdoja të lutesha me lutjet e mia mekanike, dhe dukej se do të vazhdoja ta bëja edhe gjatë pjesës tjetër të ditëve të mia.

Pas gjithë kënaqësisë së atij muaji pas kthimit tonë, korriku ishte më i qetë. Mendoj që babai qe i dëshpëruar për shkakun tim. Papritmas ai tha 'Le ta bëjmë një dasmë.'

'Oh babi', do të kisha kërcyer me gëzim. Unë i doja dasmat. Një prej kujtimeve më të hershme, në mos më e hershmja, qe dasma e motrës sime të madhe ndaj një kusheririt tim kur isha katër vjeç. Anis Bibi qe 14 vjeç në atë kohë.

Mbaj mend veshjen e kuqe që kishte përgatitur ajo për mua, me të njëjtin material dhe ngjyrë si të saj. E saja ishte mjaft e stolisur me ari, dhe mbante xhevahirë të pastër në flokët e saj, me një kurorë të mbuluar me perla. Në dorën e djathtë kishte pesë unaza të lidhura me *punxhangla* për bylyzyktë përreth nyjës së saj, dhe mbi të gjitha një *duppata*, e bërë nga pëlhura më e mirë e mëndafshhtë. Unë rrija në gjurin e saj gati tërë kohën, ndërsa ajo më mbante shtrëngueshëm dhe më mbronte, më përqafoje sikurse unë ndonjëherë që përqafoja kukullën time. Kur *maulvi* hyri brenda për t'i thënë fjalët e martesës mbi të, unë e ndieja atë të dridhej dhe ia përkëdhela faqen nën velin e saj për të shikuar nëse ishte lagur nga lotët.

Të gjithë mysafirët meshkuj ishin me dhëndrin në derën tjetër, dhe të gjithë femrat me ne. Dhëndrri sipas traditës sonë, nuk kishte parë asnjëherë fytyrën e nuses së tij, vetëm kur ishin të rinj dhe të panjohur, por kjo nuk prishte punë. Ai do ta donte atë. Çdo kush e donte Anis Bibin, që aq shumë ngjasonte me nënën tonë të vdekur.

Ishte një dasmë e madhe. Disa prej njerëzve të lartë erdhën. Kishte shumë dhurata. Paja që ne çuam ishte e pasur dhe duhet ta ketë varfëruar babanë. Njëzet e një përqind e çdo gjëje shkoi në

shtëpinë e re të Anis Bibit së bashku me paratë, arin, dhuratat për të afërmit e dhëndrit...një fat. Çdo kush thoshte që ishte dasma më e mirë që kishte parë qyteti.

Kur Anisa erdhi për t'u përshëndetur me mua, unë iu ngjita dhe fillova të qaj me dënësë. Ajo ishte nëna që unë njihja.

- Do të vijë për të të vizituar shpesh - tha ajo. Në fakt ajo do të kthehej të nesërmen siç ishte zakoni ynë, për të qëndruar në shtëpinë e prindërve edhe për disa ditë para se të vendosej me ata të burrit. Do të kishte vizita shkuarje-ardhje për ca kohë, derisa të rinjtë do të konsideroheshin mjaft të pjekur për të rregulluar jetën nën udhëheqjen e tyre.

Dasma e Shafdar Shahut u bë në shtëpinë e nuses, dhe ishte e kundërta me atë të Anisit. Gratë tona nuk morën pjesë. Ne pritëm derisa ata sollën nusen Zenibe prapa tek ne të nesërmen, me dhuratën e tyre madhështore. Ajo qëndroi dy ditë dhe pastaj u kthye tek shtëpia e prindërve të saj për një javë. Çifti ishte i fejuar që nga fëmijëria por që nuk kishin parë asnjëherë njëri-tjetrin, siç ishte zakoni, ndonëse gjërat tjera ishin të ndryshuara. Nusja që më e vjetër, 18 vjeç në atë kohë. Ajo qëndroi me ne derisa Safdar Shahu përfundoi studimet e biznesit në kolegjin amerikan, para se të shkonte në biznes në fabrikën e bagazhit në Lahore. Pastaj ata shkuan për të jetuar në Samanabad dhe kishin një shtëpi të mirë të tyre.

Mua më pëlqente ta shihja atë të rrinte me ne. Ajo kalonte kohë me mua në dhomën time, apo rrinte me mua në ulësen lëkundëse në kopsht në pjesën e femrave. Atje unë luhatesha çdo ditë kur koha ishte e përshtatshme, rrija në mes të trëndafilave dhe bizeleve me erë të këndshme, pemëve të portokallit dhe mangos, dhe të qetësoshesha nga spërkatjet e shatërvaneve të vegjël.

Derisa ne ishim atje kopshtarët qëndronin mjaft larg, dhe një linjë e padukshme na ndante me ta.

Pas kësaj, me një rrjedhë të shpejtë, Samina që martuar dhe kaloi për të jetuar në qytetin satelitor, Ravalpindi, me familjen e burrit të saj. Pastaj që radha e Alim Shahut. Ai sapo kishte diplomuar në juridikë dhe shkoi për të jetuar në Samanabad me nusën e tij të re duke u bërë dhe zyrtar i bordit të karburantëve.

Martesa ime natyrisht qe e pamundur. Ne e liruam kusheririn tonë nga fejesa dhe ai u martua me një vajzë shumë të mirë kusherire nga ana tjetër e familjes.

Në këtë mënyrë unë dhe babai ngelëm në shtëpi dhe aty filloi një periudhë e çmuar e jetës sime, ku kisha shoqërinë e tij në një mënyrë shumë më të afërt se më parë. Të gjithë fëmijët e tij ishin shpërngulur, dhe ai ishte shumë më i qetë në mendjen e tij. Kur do të vinte koha për të dhënë llogaritë e tij para Perëndisë, ai nuk do mbahej në kishte dështuar në detyrën e tij. Në mes nesh ekzistonte një lidhje shumë e thellë, e përbërë nga dashuria familjare dhe besimi fetar. Frymëzimi dhe shembulli ynë vinte nga babai.

Ka edhe dy anëtarë tjerë të familjes sonë që nuk i kam përmendur. Xhaxhai dhe tezza. Ata kishin arritur pas ndarjes në vitin 1950, një vit para se unë të lindesha. Shumë njerëz kishin ngelur pa shtëpi nga të dy anët dhe babai, siç ishte detyra e tij lajmëronte në të gjitha gazetat për çdo familje Sajedi në atë pozitë të vinin përpara.

Në kohën e duhur, ky çift mbërriti nga Karaçi dhe u bë pjesë e familjes sonë. 'Xhaxhai' u bë 'vëlla' i respektuar dhe qe i ndihmuar nga babai im për të filluar një biznes të vogël tregtie me shumicë. 'Tezza' ndihmonte në mirëmbajtjen e shtëpisë, pasi nëna ime kishte vdekur, dhe në përkujdesjen për mua.

Mua më pëlqenin ata – ishin të mirë dhe të sjellshëm – dhe qesh shmangur nga zbrazëtia e shtëpisë nga dy fëmijët e tyre, djali 12 vjeç, dhe një vajzë që ishte tetë vjeç.

Tezza ishte një grua zemërmirë, shumë mirënjohëse për çatinë mbi kokën e saj, por e munduar nga vuajtjet që familja e saj kishte përjetuar në lindjen e kombit pakistanez.

'Ishte e tmerrshme, e tmerrshme. Kam parë vëllanë tim të vritej para syve të mi...oh, ju nuk mund të paramendoni se si kemi vuajtur. Ata dogjën shtëpinë tonë...' dhe këtu ajo ndërpriste, e mbizotëruar nga dhimbja.

Gradualisht kjo përvojë e hidhur mori rëndësi të dorës së dytë ndaj të ardhmes së shkelqyer që hapej për fëmijët e saj. Vajza e saj edukohej, sikurse djali i tyre. 'Ajo do bëhet doktoresh', thoshte tezza me krenari. 'Abazi do të shkon në ushtri.'

Këto ishin profesione të respektuara. Drejtimit moderne në edukim prodhonin probleme, në veçanti për vajzat. Çfarë mund të bënin

ato? Ishin vetëm disa profesione të hapura për femra, disa prej të cilave, veçanërisht nëse do jetonin në qytete të mëdha, do të fitonin ide që do të binin ndesh me traditën, e që ishte me interes t'i shihje vajzat e martuara dhe në shtëpitë e tyre sa më shpejtë të ishte e mundur.

A mendon edhe ti ashtu - tha tezza.

Tërhoqa vetën prapa nga meditari im. Mbase ashtu - thashë unë.

Oh në të vërtetë po - tha tezza - vajza ime duhet të përfundojë studimet e saja, dhe të kualifikohet si doktoresh. Mendo sa e dobishme do të ishte kur të martohet dhe fëmijët e saj të jenë të sëmurë.

Nuk ia zija për të madhe që s'ndalej së foluri në këtë mënyrë, ndoshta për një orë e shtrirë. Qe me të vërtetë e nevojshme për të bërë vetëm një koment dhe për të mbajtur vazhdimin e rrjedhës. Ishte një argëtim i padëmshëm për të ndonëse mua më mundësoi të mendoja për diç tjetër.

Xhaxhai dhe tezza më kursyen shumë nga shqetësimet dhe vajtimet që i bëja me shërbëtoret, sepse në çdo shtëpi ne kishim një numër të tyre dhe për të cilët duhej të kujdeseshim, edhe për mirëqenien e tyre ne ishim përgjegjës.

Salima ishte me mua që kur isha shtatë vjeç. Ajo ishte një vajzë e turpshme fshatare në moshën 14 vjeçe kur filloi të kujdesej për mua. Derisa rritesha, asaj iu ofrua edhe një ndihmëse, Sema, e cila vinte nga e njëjta familje.

Ne kishim dhe shërbëtorë të tjerë të organizuar për ne nga *munshi* apo nëpunësi, nga zyra e tij, afër hyrjes së parme të shtëpisë. Ai merrte urdhërat çdo mëngjes nga babai. Ai shikonte që blerjet të jenë bërë, që menytë të jenë rregulluar t'i përshtaten rastit, që gjërat të jenë porositur, që letrat të shkonin në postë, që vizitorët të jenë të pranuar në mënyrë të duhur, që llogaritë të kishin vëmendjen dhe që një llogari e duhur e kujdestarisë së tij të ishte kryer çdo javë.

Duke e zvogëluar zingjirin e urdhëresës, por me një karakter të dukshëm ishte *çokedari*, rojtari. Kur vizitorët i binin ziles tek porta ishte përgjegjësi e rojtarit për të kuptuar çfarë punë kishin ata me ne, dhe nëse i gjykonte të ndershëm i çonte ata tek nëpunësi, i cili do t'i përcillte pastaj deri tek anëtari i duhur i shtëpisë.

Ishin dhe katër kopshtarë – Dita që kryesori, ai mbikëqyrte blerjet e bimëve, hapjen e vrimave për t'i mbjellur ato dhe rregullimin e vazove me lule – në kopshtin me diell gjatë dimrit dhe ne strehet me hije në verë. Pastaj vinte kopshtari i dytë, që kujdesej për urdhërimet e Ditës që të zbatoheshin, i treti shiqonte për tubat e ujit për të kontrolluar nëse kishte ujë të mjaftueshëm për kopshtin dhe shatërvanet e vegjël që spërkisnin në kopsht. Biri i Ditës priste barin dhe mbante çdo gjë bukur.

Ne kishim një kuzhinier dhe ndihmësin e tij. Unë kurrë nuk kisha hyrë tek kuzhinat – linja e padukshme më parandalonte. Rahmet Bibi ishte shërbëtorja e qumështit – ajo bënte gjalpin e freskët çdo mëngjes nga qumështi i buallicës. Lahraki sillte ushqimin në tavolinë ndërsa Sati ndihmonte. Ata po ashtu bënin punët e shtëpisë.

Për këtë arsye fuqia dhe përgjegjësia filtroheshin nëpërmjet shumë kanaleve, dhe interesi i tyre dhe yni përputhej. Pagat nuk ishin shumë të larta, sepse shumë nga shërbëtorët jetonin në kompleksin tonë dhe kishin ushqimin dhe veshjen. Ata nuk punonin si njerëzit e tjerë jashtë – apo ashtu mendoja unë të paktën atëherë.

Unë nuk do të bërtisja kurrë në shërbëtorët, dhe isha e lumtur të shihja tezën, që për të gjitha qortimet, nuk bërtiste po ashtu. Njëherë mbaj mend të kisha dëgjuar një grindje me *Dhobi-n*, shërbëtorin që kujdesej për larjen e rrobave, i cili njëherë kishte humbur disa ndërresa të çmuara. Çdo herë më mahniste se si këto rroba të ndyera do të shndërroheshin në të bardha si bora, do të bëheshin të lëmuara me hekur të thëngjillit dhe të silleshin prapa me asnjë rrudhë – dhe e tëra kjo nga një shtëpi me baltë me vetëm një pompë dore për të tërhequr ujin apo për t'i larë në kanalën e ujitjes.

*Dhobi* kur nuk do të bëhej i pasur, porse në shumë mënyra jetonte mirë. Ai nuk paguhej me të holla por me gjëra – grurë, një thes me oriz. Ato që nuk i shfrytëzonte i shkëmbente në fshat për gjërat që kishte nevojë.

Nuk është një jetë e keqe. Shpresoj që të mund të jetoj po ashtu mirë edhe sikur t'i humbisja të gjitha këto- thoshte babai duke bërë me dorë përreth për të aluduar në shtëpinë e tij komode dhe tokën.

Babai kishte teori të ndryshme rreth punës në një kulturë si kjo. Natyrisht kemi shumë shërbëtorë që kujdesen për disa njerëz, por ata nuk kushtojnë shtrenjtë për t'i ushqyer dhe veshmbathur. Ata

kanë nevojë për ne aq sa ne kemi nevojë për ta. E sfidoj çdo shtet të zhvilluar që të gjejë sistem më të mirë për të ushqyer dhe punësuar klasën më të varfër.

Unë kisha një mësuese, Razinë, e cila vinte për të më drejtuar në njohuritë e ndërlikuara të fesë islame, gjuhës urde, historisë së Indisë dhe Pakistanit, matematikës, gjuhës persiane, shkencës themelore. Në vend të anglishtës merrja urdun e avansuar.

Razia ishte një grua e këndshme, plot me mendime, e gjatë dhe e bukur. Ajo vinte në dhomën time si puhiza e ajrit, dhe duke iu falënderuar asaj kam fituar një interes për botën përreth meje, duke dëgjuar lajmet në radio, programet fetare, dhe duke shikuar televizionin të cilin babai e kishte sjellur pas vizitës sonë në Mekë, për të zbutur zhgënjimin e ardhjes time në shtëpi.

Një ditë Razia më tha: 'Tani je gati për provimet. Së shpejti nuk do të kem më mundësi për të ardhur më tej të të mësoj.' Isha aq e emocionuar në perspektivën e provimeve sa që s'kisha kuptuar plotësisht se sa do të më mungonin mësimet tona.

I kalova provimet dhe pastaj tërë ditën rrija duke mos bërë asgjë. Razia kishte nxënë të tjerë dhe nuk mund të më vizitonte shpesh.

Babai, megjithatë, vazhdoi të vinte çdo natë, të ulej, të lexonte gazetën dhe të më tregonte lajmet e ditës lidhur me biznesin, dhe lajmet për ngjarjet në qytet. Herë pas here edhe udhëtonim. Një herë pata menduar për rrethin tonë si qendrën e Punxhabit – që, natyrisht ishte qendra e Pakistanit. Pavarësisht nga sasia e shumimit të kafshëve dhe rritjes së jetës industriale, ajo qe edhe një qendër e njohur për leverdi romantike. Ekzistonte një varr i një çifti të ri që ishin të ndarë me jetë por të bashkuar në vdekje.

Së pari e kisha dëgjuar tregimin nga Samina, me gjithë detajet e koklavitura dhe më vonë babai na çoi të veshtrajmë varrin e bardhë prej mermeri që na përkujtonte yjet e sëmura të dashurisë.

Ka të bëjë me Hirën, emri i së cilës nënkupton 'e bukur' dhe Ranxhës, biri i bujkut që donte të martohej me të. Çështja e kastës ishte e përfshirë, edhe pse të dy qenë të pasur. Prindërit e Hirës e mashtruan atë në një martesë me burrin që ata kishin zgjedhur, por ajo edhe më tutje donte Ranxhën, me të cilën qe edhe e fejuar. Më në fund mbreti rastisi të dëgjojë për këtë, dhe prishi martesën e saj.

Por *doli* i saj, makina e dasmës, duke e çuar tek Ranxha, rezultoi të jetë makina e vdekjes. Xhaxhai i saj i kishte dhënë një pije helmuese në momentin kur ajo po lëshonte shtëpinë. Në traditën e vërtetë të Romeos dhe Xhulietës, Ranxha bëri vetëvrasje.

Tregime të tilla ushqenin pasionin tonë për romancë. Deri tani vonë nuk e kisha krahasuar me ndjenjat e babait tim për mamin tim. Kjo nuk ishte një pasion romantik në fjalë por një dashuri me tërë zemër që e bëri atë të sakrifikojë vetën e tij për së gjalli për të.



## 5. Thumbi i vdekjes

Nuk më pëlqen të përkujtoj çfarë erdhi më pas, ndonëse thumbimi i kujtesës sjell me vete ngushëllimin. Babai ynë, çdo herë aq i fuqishëm, qe sëmurë.

Ishte dhjetor, 1968, një vjeshtë me të reshura të mëdha dhe me mot të ftohtë. Babai qëndroi jashtë në pronën e tij për një kohë të gjatë dhe u kthye në shtëpi i lagur dhe i mërdhirë. Atë natë shkoi në shtrat me temperaturë.

Të nesërmen në mëngjes ai përpëlitej në zyrën e tij, fytyrën e kish ngjyrë hiri dhe të djersitur. E braktisi punën e tij dhe erdhi në shtëpi sërish. Atë mbrëmje ishte më keq, me një ashpërsi të çuditshme në frymëmarrjen e tij.

Mjeku erdhi dhe i përshkroi barëra. Mulla erdhi po ashtu dhe bëri ca lutje. Temperatura iu hoq ndërsa Mexhidi e mori atë në punë përsëri, e pastaj e solli në shtëpi sërish në një gjendje kollapsi dhe duke luftuar me frymëmarrjen.

Familja e ngushtë u mblodhë së bashku dhe ne lamë mënjanë dëshirat tona për t'i ndihmuar atij të luftonte sëmundjen, e cila tashmë qe diagnostifikuar si pneumoni. Babai do të duhej të ishte në spital tani, por ai insistonte të rrinte në shtëpi, dhe tentonte të punonte nga dhoma e fjetjes së tij. Për dy apo tri ditë vuante. Dhe pastaj ndryshimi për të cilën ne të gjithë frikësoheshim ndodhi. Ai po humbiste betejën dhe ne ishim të pafuqishëm që ta shpëtonim atë. Ai filloi të na jepte mesazhe dhe informacione rreth ndarjes së pronës së tij, dhe ia dorëzoi detyrat Safdar Shahut, i cili mbante fuqinë e tij ligjore.

Babai mendoi për mua edhe në momentin më ekstrem. Shikoi në mua dhe më përqafoi me përpjekje të madhe: 'Të kam lënë shumë pronë. Edhe nëse i mban 100 shërbëtorë nuk do të bëhesh barrë e askujt. Kujdesu për xhaxhanë dhe tezën dhe jepju atyre çdo gjë që kanë nevojë.'

Ne shikuam në sy njëri-tjetrin të tmerruar. 'Kjo nuk është duke ndodhur' i bërtitëm njëri-tjetrit. Ai po na rrëshqiste nga përqaftimi ynë, sikurse pikat e ujit në tokë, jo për t'u kthyer prapa veç se nga dielli.

Unë isha në karrocën time në anën e tij dhe u mbështeta në të, e trazuar thellë.

'Baba mos na lerë. Ne kemi nevojë për ty. Nëse ti shkon unë do të vij pas teje,' - qaja duke mos ditur çfarë po thoja.

Ai hapi sytë e tij dhe shtriu me dobësi dorën e tij mbi kokën time:

Kjo është një barrë për ty, por nuk guxon të bësh vetëvrasje. Është mëkat. Mos harro asnjëherë, që ti i takon familjes Sajed, familjes së Muhamedit. Ti ke për të shkuar në parajsë, prandaj mos bë vetëvrasje se do të mbarosh në ferr. Mos dëgjo rrëfimet e grave të vjetra. Jeto një jetë me drejtësi dhe të gjithë do të jemi së bashku me nënën tënde.'

Këtu ai ngriti veten e tij lehtas dhe i trazuar kapi dorën time, sytë e tij shkëlqenin me një dritë të çuditshme të fiksuar, sikurse të shikonin një vegim. Ai mori frymë thellë, 'Një ditë Perëndia ka për të të shëruar Gulshanin. Lutju atij, - pastaj u shtri prapa në jastëk duke marrë frymë rëndë dhe ngadalë. Sytë e tij u mbyllën.

Unë ngela aty duke qarë e hidhëruar. 'Si mund të kem besim, nëse ti nuk je me mua, baba?' dhe qaja me zë.

Safdar Shahu pastaj filloi të qajë:

'Mos na lerë. Ne akoma kemi nevojë për ty. Ti je nëna dhe babai ynë.'

Shikova tek vëllai im, punëtorin e madh. Nuk e kisha kuptuar që ai kishte ndjenja aq të thella për këtë njeri që na kishte sjellur deri këtu dhe ishte kujdesur për ne në fëmijëri dhe rini.

Sytë e babait u hapën. Ai po bënte përpjekjet e fundit për të qëndruar me ne.

'Kujdesuni për motrën tuaj' - i tha ai çdo njerit prej fëmijëve të tij, dhe ata

bënë një pretim solemn. Pastaj piu pak ujë, tha ca vargje nga sura Ja Sin me të cilin u bashkuam edhe ne – dhe mbylli sytë e tij përherë. Ai ngeli i tillë me frymëmarrje të rëndë dhe të ngadalshme për disa orë, ndonëse ne e shikonim atë, dhe në orën 8 të mëngjesit me 28 dhjetor 1968 vdiq, ndërsa miku i tij *maulvi* ishte duke e recituar surën Ja Sin:

Dhe i fryhet "Surit", kur qe, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre. E thonë: "Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?" E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe

vërtetuan të dërguarit. Ajo nuk është gjë tjetër, përveç një zë i fuqishëm dhe ata të gjithë të paraqitur para nesh.

‘Sot pra, askujt nuk i bëhet e padrejtë diçka dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat.

‘Ata të xhennetit tash janë të angazhuar me kënaqësi. Ata dhe shoqet e tyre janë nën hije të mbështetur në kolltukë. Aty ata kanë pemë dhe çka të duan...’

Ne e lexuam këtë pasazh tradicional me lotë në sy, duke besuar që do të lehtësonte mundimin fizik të vdekjes së babait tonë. Samina e puthi fytyrën e pa jetë të tij, dhe ne të gjithë ndoqëm shembullin e saj.

Pas disa orëve ai u takoi meshkujve të familjes dhe miqve të njohur me përvojë në ritualet e vdekjes. Ata dhe shërbëtorët e lanë trupin dhe e veshën babanë me një mbështjellës të bardhë të veçantë, të cilin e kishte sjellur nga haxhillëku, dhe tani që i gatshëm për t’u nisur në udhëtimin përfundimtar. Ajo përbëhej prej një këmishë të gjatë dhe dy çarçafëve për të mbështjellur mesin dhe përreth supeve. Ata vendosën çallmën në kokën e tij, dhe e mbështollën në formë zarfi me një çarçaf të bardhë, pastaj e vendosën në një sënduk që kishte lutjet dhe vargjet nga Kurani të shkruara përreth. Kjo ishte e hapur për gjashtë orë për gratë e familjes që të vinin dhe të tregonin nderimet e tyre. Më vonë sënduku që vendosur jashtë në kopsht, ndërsa vajtesit ecnin në një rresht të pafund; çdonjëri duke u përkulur, duke puthur sëndukun, duke recituar një lutje, apo duke dhënë nxitimthi një puthje për nderim.

Babai ishte një njëri i rëndësishëm dhe mjaft mirë i njohur, një mësues fetar, një Pir me e ndjekësit tij, sikurse dhe një pronar i mirënjohur dhe biznesmen.

Funerali i tij atë natë përveç familjes ishte edhe një brengë e madhe edhe e fqinjëve. Njëmijë njerëz ishin të pranishëm duke përfshirë familjen, anëtarët e komunitetit biznesor, përfaqësues fetarë dhe një numër i madh i *murrixëve*. Qe një funeral i paharrueshëm.

Si pjestarë të familjes Sajed kishim një pjesë të veçantë në varrezat e qytetit, dhe këtu babai ishte prehur, në një përmendore të vogël ku edhe gruaja e tij që varrosur. Vetëm meshkujt shkuan në funeral. Maulvi udhëhoqi lutjet dhe të gjithë u përkulën dhe u lutën. Pastaj

sënduku qe zbritur në tokë dhe vajtuesit spërkitnin pluhurin në të. *Chadori* apo tufa e luleve të shumta ishin shpërndarë mbi të.

Sa më përket mua, unë isha ngrirë nga vajtimi, e shtang. Salima dhe Sema lëviznin shpejt brenda dhe jashtë, të mbikëqyrur nga teza, që të më lajnë, ndërrojnë, të më sjellin qumësht të ngrohtë dhe t'i bëjnë masazh kokës sime që t'ma lehtësojnë dhimbjen. Unë isha shumë pak e vetëdijshme për rojet e caktuar jashtë derës. 'Jo, ajo nuk do ta shohë askë. Më mirë është ta lini vetëm në këto momente.' Dhe anëtarët e familjes ktheheshin prapa nga dera ime.

Me siguri kisha fjetur sepse kur më pas qeshë e vetëdijshme, ishte ora 3 e natës sipas orës sime, dhe ashtu e shtrirë edhe për disa momente dëgjoja zëra të ulët që më njoftonin që shërbëtoret e shtëpisë ishin lart, duke u përgatitur për ditën. Ne kishim përjetuar gjënë më të keqe në jetët tona, dhe më tutje rutina duhet të vazhdojë.

Është gabim që unë duhet të jetoj, një e gjymtë e pavlerë si unë, ndërsa ai është i vdekur - mendoja- Zot nuk mund të jetoj në këtë mënyrë për ndoshta 30 vjetë të ardhshme. Të lutem më dërgo tek babai.

Pse Perëndia ndodhej kaq larg, dhe aq i qetë? Mbase stërgjyshërit e mi kishin mëkatuar tmerrësisht. Mbase Perëndia donte të shihte më shumë durim në mua...po, por unë kisha patur durim, dhe edhe më tutje isha e sëmurë. Nëse ai nuk do më ndihmonte atëherë do të duhesha të gjeja ndonjë mënyrë për ta çliruar vetën time nga ky trup i lodhur. Por si? Të varrë vetën? Me një dorë kjo do ishte e pamundur. Helm? Ku do ta merrja? Nëse do të mund të gjeja thikë apo gërshërë... ato ishin të mbyllura. Ndonëse një mendim ndëgjohej, një tjetër zuri vendin e tij: 'Kur nuk do të jesh me babanë tënd dhe nënën në parajsë nëse e merr jetën tënde.' Si Sajed unë kisha të drejtë automatike të hyrjes, edhe nëse do të dështoja t'i përmbushja të pesë shtyllat e islamit, por vrasja do ta përjashtonte këtë të drejtë.

Mbase atëherë kurrë s'do të shërohesh! Zemra ime ndjehej sikur të ishte shtrydhur dhe lotët rridhnin pa ndërprerë. Atëherë fillova, nga pamundësia e plotë, të flas me Perëndinë, të flas me të vërtetë me të, jo siç bënë një mysliman duke përdorur lutje të paracaktuara, por duke iu afruar atij nga një humnerë e madhe.

E shtyrë nga një zbrazëti e pafund brenda meje, u luta, sikur të bisedoja me dikë që i dinte rrethanat dhe nevojat e mia.

- Dua të vdes - thashë - nuk dua të jetoj më dhe kjo është fundi i kësaj. Nuk mund ta sqaroj por e di që po dëgjohesha. Ishte sikur të hiqej veli në mes meje dhe një burim paqëje. Duke e tërhequr më afër shaminë përreth meje kundër të ftohtit unë flisja më trimërisht në lutje.

Çfarë mëkati të tmerrshëm kam bërë, që më ke bërë të jetoj në këtë mënyrë – unë dënesja - menjëherë posa u linda nëna ime ishte rrëmbyer, e pastaj më bëre mua të gjymtë, dhe tani e more edhe babanë tim. Më trego përse më ke dënuar kaq fuqishëm?

Qetësia që aq e fuqishme dhe më tutje mund të dëgjoja të rrahurat e zemrës sime.

Nuk do të të lë të vdesësh. Unë do të mbaj të gjallë.

Qe një zë i ultë, i butë, sikurse fladi i një ere të kalonte mbi mua. Unë e dija që ishte një zë, dhe që më kishte folur në gjuhën time dhe me këtë erdhi një liri e re për t'iu afruara Perëndisë si qenie supreme, i cili deri atëherë nuk më kishte dhënë asnjë shenjë që madje dinte për ekzistencën time.

‘Çfarë është qëllimi që më mban të gjallë?’ pyeta me dyshim. ‘Unë jam një e gjymtë. Derisa babai im ishte ende gjallë mund të ndaja çdo gjë me të. Tani çdo minutë i jetës sime është si 100 vjet. E ke marrë babanë tim dhe më le pa asnjë shpresë, nuk kam për çfarë të jetoj më.’

Zëri erdhi përsëri, i kumbueshëm por i ultë.

‘Kush u dha sy të verbërve, kush i bëri të sëmurët të shëndoshë, kush i shëroi leprozët dhe kush i ngriti të vdekurit? Unë jam Jezusi, biri i Marisë. Lexo për mua në Kuran, në suren Merjem.’

Nuk e di sa zgjati ky ndryshim – pesë minuta? Një gjysmë ore? Befas thirrja e lutjes së mëngjesit u dëgjua nga xhamia dhe unë i hapa sytë. Çdo gjë dukej normale në dhomë. Përse nuk kishte ardhur askush me ujin tim që të pastroheshja? Si duket më ishte dhënë një hapësirë e paqes dhe intimitetit për këtë takim të çuditshëm.

Të nesërmen gjatë ditës gati sa e binda veten se kam qenë duke ëndërruar, derisa me motrat e mia dhe anëtarët tjerë të familjes sime vizitoja varrezat. Gjithçka atje ishte e heshtur dhe e qetë dhe lulet e freskëta ishin vendosur në grumbullin e tokës ngjyrë kafeje. Por unë

shikoja në të me tmerr. Ai i cili derisa ishte gjallë kurrë nuk do të lejonte që një pikë e vogël e pluhurit ta prekte, tani ishte i varrosur nën këtë dhe. Ishte shumë e tmerrshme të mendoja për këtë.

Kur u kthyem nga kjo vizitë melankolike, duhej që të mbanim këtë periudhë zie prej 40 ditëve. Gjatë kësaj kohe Safdar Shahu dhe Alim Shahu e mospërfillnin punën e tyre deri sa një numër i vazhdueshëm i njerëzve nga larg dhe afër, të rëndësishëm dhe të përlulur, na vizitonin dhe tregonin respektin e tyre në përkujtimin e babait tonë. Gjatë kësaj kohe ushqimi do të vinte nga miqtë tanë. Asnjë zjarr për gatim nuk do të ndizej në shtëpinë tonë. Ne duhej të kalonim tërë kohën tonë në përkujtimin e të vdekurit dhe duke biseduar lidhur me të gjithë ata që do të vinin. Vizitorët tanë do të rrinin në dysheme në shenjë respekti dhe do të bisedonin për gjërat e mira që i vdekuri kishte bërë, duke nderuar figurën e tij, në këtë mënyrë edhe ngushëllonin familjen. Ky qe një gjest i hirshëm, duke i lejuar vajtimin manifestim të duhur, dhe duke i sjellë familjes e cila ka humbur një të dashur ndihmë dhe përkrahje.

Pas kthyerjes sonë nga varrezat, në një gjendje të thellë depresioni, një gjë e çuditshme ndodhi. Njëra nga shërbëtoret befaz bërtiti duke shikuar në drejtim të karrigës.

E pashë atë të qëndronte këtu - tha ajo. Askush nga ne nuk u befasua. Përshtypja e pranisë së personit të vdekur që nuk e lë menjëherë shtëpinë, dhe në rastin e babait tim ku ne ende s'mund të besonim që ai kishte shkuar. Dukej se pothuaj tani do të shfaqej për t'iu dhënë disa urdhëresa kopshtarëve dhe të hynte përbrenda. Unë shikoja shërbëtoren dhe po pyesja vetën se pse ka qenë ajo, që e kishte parë.

Tezja erdhi në dhomën time të fjetjes dhe qëndroi me mua për një kohë, duke m'i bërë masazh kokës sime që të çlirojë dhembjen e madhe që vinte si rezultat i rrjedhjes së gjithë atyre lotëve. 'Daja yt dhe unë do të kujdesemi për ty sikurse babai dhe nëna jote. Të lutem na konsidero si të tillë dhe përpigu të shikosh në këtë humbje si diçka sipas vullnetit të Zotit. Ai e ka dërguar babanë tënd në parajsë.

Kur ajo shkoi, për shkak të nevojës për të bërë diçka, që të humbja mendjen nga ngjarjet e mëngjesit, unë e kërkova Kuranin tim në gjuhën arabe dhe fillova të lexoj nga sura Merjem. Porse ishte shumë vështirë të kuptoja plotësisht në gjuhën arabe, ndonëse vargjet

ritmike në formë të këndimit e bënin të mësuarin me zemër më të lehtë. Këtu një ide guximtare më pushtoi mua. Përse duhet të mos e lexoj në gjuhën time?

I shkrova një shënim Salimës, dhe ia dhashë atëherë kur erdhi për t'i ndërruar rrobat e mia.

'Të lutem jepja portierit përkthimin më të mirë të mundshëm të Kuranit në urdu' - thoshte shënimi im.

Merre këtë në librari dhe kërko për një version urdu të Kuranit, të botuar nga kompania *Taxb* - i thashë - merri paratë nga tezja.

Salima bëri me kokë në shenjë respekti dhe doli menjëherë jashtë. Dy orë më vonë u rishfaq, me librin e mbështjellur në një gazetë.

Mirë - thashë - tani nëse mund ta mbulosh librin!

Atë natë, kur shtëpia që pa zhurmë dhe në qetësi unë e çlirova mbështjellësin e mëndafshtë ngjyrë gjelbërt dhe nxora Kuranin në urdu. E mbajta librin në dorë për një moment. Doja aq shumë ta degjoja sërish atë zë, me po atë siguri që lutjet e mia po ndëgjoheshin dhe që ekzistonte mënyra e shërimit dhe shpresës. Mënyra për ta dëgjuar edhe njëherë, e dija instinktivisht, ishte t'i bindesha udhëzimeve të tij për ta lexuar. Dhe në këtë mënyrë, plotë me kureshtje dhe pikëllim, dhe as me idenë më të vogël se çfarë akti me rëndësi do ishte, thashë *Bismilai*, hapa librin dhe fillova të lexoj:

Engjëjt i thanë: 'Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me Fjalën e vet, emri i të cilit është Mesih, Isa, biri i Merjemës, i famshëm në dynja e ahiret dhe nga të afërmit e Zotit. E duke qenë në djep u flet njerëzve, e edhe si i rritur është nga të përsosurit...'

Në ditën e tretë pas vdekjes së babait tonë, Safdar Shahu vendosi vetë të bëhej kreu i familjes. Një nga çallmat e babait u vendos në kokën e tij në formë ceremonie nga dy dajat e mi – dhe që nga ajo kohë ai ishte *Pir* në familjen tonë dhe sheh. Ai do të duhej t'i dinte përgjigjet ndaj pyetjeve religjioze tani. Disa që e kishin këtë titull ishin të pa arsimuar dhe me besëtytni.

Për 40 ditë të zisë shtëpia që plot me fqinjë, vizitorë dhe murrizë me gratë e tyre. Këta kishin ardhur për të qenë në shërbimin tonë, dhe këtë e bënin mirë, pastronin shtëpinë dhe shërbenin vizitorët tjerë me ushqim. Ata po ashtu sillnin rroba për familjen, të cilat ishim të detyruar t'i vishnim nga mirësjellja.

Këto rroba janë rroba të vdekjes, e jo të jetës. Çdo herë do jenë përkujtim për mua - thoshte Anis Bibi, duke tërhequr shaminë *kamizj* jo të përshtatshëm.

Periudha e zisë përfundoi me dy aktivitete. Varri ishte çimentuar dhe guri ishte ngritur. Çdo njeri ishte i ftuar në përfundimin tradicional të ceremonisë së zisë, *çalisvan*.

Një tendë e madhe ishte ngritur dhe pajisjet ishin dorëzuar në një lokal dyqani. Ata ndezën stufat për zierje dhe mbushën 150 enë të mëdha me oriz. Pulë me pilaf dhe bizele ishin servuar si dhe oriz të ëmbël, dhe të gjithë ulur mbi shtroje mbi tokë hanin në pjatat e çeliktat me gishtat e tyre.

Unë nuk shkova sepse urreja të shihesha me keqardhje për gjymtimin tim, por dëgjoja për çdo gjë.

Safdar Shahu tani duhej të kthehej për Lahore, por para se të nisej ai erdhi të më shikojë dhe u ul në karrigën që babai im shpesh e zinte, dhe dukej jo i qetë. Ai mbante në dorë dokumentat lidhur me pronën time, atë që babai më kishte lënë. E dija çfarë do të thoshte dhe në vete e kisha përgjigjen e gatshme.

Motra ime e dashur - filloi ai - do të të kërkoja të vije për të jetuar me ne, për faktin se te zja dhe daja janë këtu për t'u kujdesur për ty. Siç e di ti, babai të ka lënë pjesën më të madhe të pronës. Unë natyrisht nuk jam kundër kësaj në asnjë mënyrë, sepse babai kujdesej për ty aq shumë dhe ai mendonte në veçanti për ngushëllimin dhe mirëqenien tënde. Por me që tani je udhëheqëse e pronës, mund të jetosh ku të duash, duke përfshirë edhe Lahoren.

E ndërpreva.

Falemnderit vëllai im, por unë nuk do të doja të lija këtë shtëpi ku jam rritur. Nuk dua të shkoj në Lahor.

Vëllai im më shikoi me një shikim depërtues.

A është mjaft mirë për ty të qëndrosh këtu të maturohesh?

Unë do të mund të maturohesha edhe në Lahore, gjithashtu. Këtu jam mësuar me çdo gjë - i thashë. Unë nuk përmenda arsyen tjetër – që vetëm këtu, në qetësi dhe vetmi do të mund të gjurmoja hulumtimin tim në Kuranin lidhur me profetin dhe shëruesin Jezus (Isa).



Shumë mirë, nëse kështu ndjehesh, atëherë le të bëhet - tha Safdar Shahu. Mendoj që dukej i çliruar. Atëherë, në këtë rast mendoj që duhet vënë në zbatim të gjitha dëshirat e babait tonë lidhur me përgjegjësinë e financave.

Ishte marr vesh që Safdar Shahu t'i vendoste paratë në bankë në Lahore për mua që t'i tërhiqja. Unë, si kreu i shtëpisë do të firmosja çeqet çdo muaj ndaj Bankës Komerciale Muslimane për shpenzimet. Unë do t'ia jepja paratë dajës për mirëmbajtjen e shtëpisë. Vëllai im Safdar Shahu do të na vizitonte dy herë në muaj për të kaluar mbi llogaritë.

E di që çdo gjë do të jetë në rregull - tha Safdar Shahu - babai im kishte vendosur besim të madh në mençurinë tënde derisa ishte gjallë.

Çdo gjë ishte marr vesh sipas dëshirës së tij dhe ai shkoi. Të gjithë ikën, një nga një, duke më lënë në një ekzistencë të zymtë, me asnjë shoqërues të afërt ose mik, për të ndarë vetminë time, ndonëse nuk isha pa shoqëri.

Tezja erdhi në dhomën time pasi ai iku:

Je shumë me fat që ke kaq shumë besim në dorën tënde - tha ajo - kur kam qenë në moshën tënde që menduar e pa arritshme për një grua që të di aq shumë lidhur me biznesin... por babai yt (ndjesë pastë) të ka trajtuar si një nga djemtë e tij.

Ajo iku përsëri jashtë, dhe derisa qetësia më mbështolli përreth, unë e hapa Kuranin tim urdu dhe lexova përsëri pasazhin nga Sura 'Ali Imran, e cila tashmë ishte aq e fokusuar në vëmendjen time:

'Me lejen e Allahut unë i shëroj të verbërit, të sëmurit në lëkurë, dhe i ngjalli të vdekurit.'

Kjo kishte një kuptim më të thellë sa që unë nuk kisha kuptuar. Shumë dijetarë të arsimuar kanë tentuar të ofrojnë interpretimet e tyre lidhur me profetin Jezus, i cili, sipas kësaj sureje ishte një qenie e krijuar, i bërë nga pluhuri si Adami, por që kishte mundësi, me fuqinë e Allahut, t'i bënte të gjitha këto mrekulli. Se ishte i rëndësishëm, nuk mund të dyshoja fare, por, se kush ishte ky profet që i dinte nevojat e mia dhe që mund të më fliste mua nga qielli sikurse të ishte gjallë?!

Unë e kisha humbur shoqëruesin tim më të dashur dhe një jetë e zbrazët shtrihej para meje. Megjithatë një farë e së vërtetës dhe e

shpresës që mbjellur në zemrën time. Një ditë, disa ditë, ndihesha e sigurt se do të gjej sekretin e profetit misterioz i mbuluar në faqet e Kuranit.

## 6. Makina

Mercedesi me ngjyrë të kaltër rrinte i heshtur në garazhë pas vdekjes së babait, i mbuluar në çarçafe të zeza, një përkujtim për njeriun i cili kishte mbushur jetët tona me gëzim, tani i ikur si dielli shkëlqyes nga qiejtë tanë duke na lënë nën ethe dhe të ftohtë.

Kjo qe makina e një njeriu me vlerë. Nisja e babait në punën e tij çdo mëngjes ishte pjesë e ritualeve tona të përditshme. Makina në vetvete ishte plot shkëlqim, por babai i shtonte madhështinë e tij duke qëndruar pranë me shoferin e tij Majed, çallma e të cilit dhe mbajtja drejt e shpinës do t'i tregonte botës sesa krenar ndjehej ai kur ngiste një zotëri të tillë.

Ne fëmijët ndjeheshim krenar po ashtu, kur merreshim nga babai në ndonjë vend me makinë. Djemtë shkonin në shkollën e tyre në xhami, ndërsa unë do të shkoja me babanë për të kërkuar trajtim mjekësor për gjendjen time. Shumë herë kishte edhe udhëtime të atilla me pamje të bukura kur me merrte nga dhoma ime e qetë në rrugë për Lahore për t'i vizituar të afërmit.

Ndërsa tani makina e tij ishte e palëvizhme. Askush nuk donte ta ngiste, as edhe vëllai im, Safdar Shahu. Mexhidi rregullisht hiqte mbulesat për ta lustruar sipërfaqen e makinës ngjyrë të kaltër të mbylltë dhe me shkëlqim argjendi derisa gjithçka të shkëlqente si një pasqyrë. Ai e fërkonte panelin e aparaturave të makinës ngjyrë mogani dhe i pastronte shtrojet e lëkurës derisa u vinte një aromë e këndshme. Ai e pastronte edhe motorin në të njëjtën mënyrë dhe vajoste çdo pjesë punuese të saj dhe e ngrinte makinën lart që të mos peshonte në rrotat e saja. Ai fliste butë derisa punonte, sikur t'i fliste makinës. Shërbëtoret m'i raportnin të gjitha këto, me një qeshje ironike:

Ai Mexhidi, duhet ta dëgjosh atë. Ka shkalluar. Po i flet veturës: ti nuk je e vdekur.

Heshtni - i qortova ato - nuk duhet të bëni shaka me gjëra të tilla.

Unë ndihesha, jo e qetë, se babai do të dëgjonte, e do të shfaqej brenda nga rrethina e errët përreth shtëpisë sikurse muzgu që vjen shpejt, dhe të kërkonte makinën të ishte gati, e të ngiste sikur të mos kishte ndodhur asgjë. E si për të theksuar këtë, njëra nga shërbëtoret

erdhi me vrap tek unë me tregimin që kishte parë babanë të ecte në shtëpi.

Të ka folur ai - e pyeta.

Ajo mohoi, 'Jo Bibi-xhi. Ai nuk më shikoi mua, vetëm ecte drejt nëpër atë derë. Kur unë shikova atje nuk pashë askënd. Dhoma që e zbrazët!

Nuk e qortova për imagjinatën e saj tepër aktive, vetëm se pyesja vetën pse nuk isha unë ajo, që të shihja fytyrën e tij të dashur.

Dhe kjo makinë ishte simbol i gjendjes sime të padobishme. A duhej që makina të rrinte në garazhë përgjithnjë – një jehon e ditëve të shkuara? A më duhej të rrija këtu e pandihmë, duke jetuar në kujtime gjatë tërë jetës sime?

Vëllezërit dhe motrat e mia kishin jetët e tyre për t'i jetuar, ndonëse ata përbushën besnikërisht udhëzimet e babait lidhur me mua, unë nuk doja të ndihesha një barrë dhe brengë për ta. Melankolia ime u përçua vetë te motrat e mia. Samina më pyeti rreth kësaj një ditë:

Motra ime e vogël, ç'është duke e munduar mendjen tënde dhe të bën që të dukesh kaq e pikëlluar?

Kur i tregova asaj ajo më tha:

- Ti kurrë nuk do bëhesh barrë për ne. Ne të duam aq shumë.

Dhe kështu kur një nga ndienjat e zeza të dëshpërimit erdhi, unë u përpoqa ta inkurajoja vetën nga kjo gjendje aq sa mundesha.

Shiko Gulshan, ti ke qenë shumë me fat duke patur një familje të tillë. Ke mundur të ishe lindur e varfër si një nga shërbëtoret e tua. Ke mundur të kesh pasur një baba që nuk do të kishte dashur, dhe vëllezër dhe motra që nuk do të kujdeseshin për ty. Ti je mjaft e edukuar. Ke çati mbi kokën tënde dhe babai ka parë në këtë si diçka që do të dëshiroje si asgjë tjetër. Tani bëje më të mirën nga situata jote. Mendo për ato ditët në Mekë, kur ishe aq afër Perëndisë dhe profetit të tij. Përkujtoji fjalët e babait kur thoshte që Perëndia ka për të të shëruar, dhe nëse kjo nuk është mjaft për ty, përkujtoje zërin që e ke dëgjuar në këtë dhomë dhe që të fliste për Jezusin, Shëruesin .

Kur i shoshita të gjitha këto gjëra, ato do të duheshin të ishin të mjaftueshme për të me hequr nga kjo situatë dëshpërimi.

Çdo ditë i rikujtoja bekimet e mia, duke i hequr barrët një nga një derisa shpirti im të ngritej. Megjithatë rrëshqitja gjunjazi ishte një frikë e vazhdueshme – mbase nuk do të shërohesha kurrë.

Iu ktheva lutjes edhe me më shumë këmbëngulje sesa më parë. Ditët e mia kalonin sipas një plani të rregullt të diktuar nga pesë vaktet e caktuara të namazit. Zgjohesha çdo mëngjes në orën tre për të përgatitur veten për namazin *fajr*, lutja e agimit. Pastaj e lexoja Kuranin në arabisht deri në mëngjes, të cilin e kryeja në dhomën time.

Pas mëngjesit Salima dhe Sema do t'i ndërronin rrobat e mia, e pastaj do ta kaloja kohën duke lexuar libra fetarë apo revista, duke dëgjuar radion apo duke shkruar ndonjë letër për vëllanë ose motrën time, më pastaj haja shujtën e drekës. Pas një intervali të shkurtër pushimi vinte koha e namazit të drekës, *zabar* namazi. Kur fëmijët e tezës sime ktheheshin nga shkolla do t'më ndihmonin me karrocën time të dal në kopsht që të shikoj si po luanin. Dy orë para muzgut ishte *asar* namazi, dhe rreth dy orë pas muzgut *maghrab* namazi, lutja e mbrëmjes. E fundit prej të gjithave vinte lutja e natës, e cila ka shumë lëvdata, *Isba* namazi.

Gratë nuk ishin të nevojshme të shkonin në xhami. Në vend të kësaj, ne i bënim lutjet tona kryesisht në shtëpi. Unë shpesh do të harroja dhe ushqimin tim për shkak të lutjeve, ndonëse këto bëheshin vetëm përmendsh. Ato ishin një lidhje me babanë, një shenjë që po mbaja besimin. Ai më kishte mësuar këtë që nëse do të isha besnike, do ta takoja në parajsë, menjëherë pas vdekjes, atëherë kur do të kem një trup të ri. Të gjitha gratë në parajsë do të jenë të reja dhe të bukura, kështu qemë të mësuar në Kuranin.

Por brenda kësaj në thellësi ishte një frikë e errët, të cilën unë vështirë që mund të përballoja, dhe që nuk ia kisha përmendur askujt. Perëndia duhej të ishte i zemëruar me mua, dhe kjo që arsyeja pse e kishte marrë babanë tim. Unë isha duke u rritur me frikë ndaj Perëndisë që e adhuronim. Ai ishte i fshehur nga unë prapa një veli të errësirës dhe të panjohurës.

Asgjë nga këto nuk shfaqej në jetën sipërfaqësore. Në shumë mënyra shtëpia ime dukej parajsë në atë kohë. E vendosur në një tokë të gjelbër, pjellore, e ujitur nga pesë lumenj; Xhelumi, Ravi, Indusi, Çenabi, me pendën e re të saj, dhe Satlagji, shtëpia jonë konsiderohej e izoluar nga njerëzit tjerë në Lahore. Për mua kjo që një strehë nga bota e gjërë plot me sy kureshtarë dhe pyetje torturuese lidhur me paaftësinë time. Që po ashtu një qiell nga një botë plot me mjerim,

vrasje, sulme, në të cilën unë nuk duhesha të marthohesha apo të fitoja për jetesë. Duke dëgjuar në urdisht programet informative të BBC-së në Londër, nga gazetatat dhe nga televizioni, unë dëgjoja për trazirat anembanë botës, dhe për mallohesha për babanë tim që të bisedoja me të për të gjitha që shihja dhe dëgjoja. Kishte shumë gjëra që nuk i kuptoja plotësisht, dhe unë kisha humbur dikë që më ndihmonte t'i formoja opinionet e mia.

Natyrisht që kishte shumë biseda që zhvilloheshin në shtëpi. Bisedoja me xhaxhanë tim rreth udhëheqjes së shtëpisë dhe biznesit. Bisedoja me tezën time lidhur me fëmijët e saj, për shërbëtorët, për kohën, për lulet në kopsht, për dasmat dhe funeralet në rrethin e familjes dhe miqve. Bisedoja me motrat e mia për fëmijët e tyre dhe të gjitha thashethemet intime të jetës familjare, dhe me vëllezërit e mi për çështjet familjare dhe ndonjëherë edhe për botën në përgjithësi.

‘Ka shumë mjerim në mbarë botën. Këtu në Pakistan ne kemi paqe. Këtu është “vendi i shenjtë”’. Kjo ishte pikëpamja e tyre.

Pas këtyre vazhdonin bisedat me shërbëtorët – me Munshiuin, ndërsa vinte te dera ime, pjesërisht e hapur, në lidhje me llogaritë që i mbante aq kujdesshëm. Kjo zakonisht bëhej me insistimin e xhaxhait. Paraja ishte lëndë e rrëshqitshme, dhe në shtëpinë tonë kishte shumë vrima ku ato mund të humbeshin. Ai nuk donte të mbahej përgjegjës për to.

Bisedoja veçanërisht me dy shërbëtorët e mia, të cilat kanë qenë me mua mjaft gjatë dhe më donin aq shumë sa edhe unë ato. Por edhe ato nuk ishin në dijeni për ndryshimin më sekret që ndodhte në mua gjatë këtyre tre viteve pas vdekjes së babait, në kohën kur fillova t'i sprovtoj idetë që deri atëherë i kisha pranuar pa dyshim fare.

Një natë, pasi që fëmijët kishin shkuar në shtrat dhe teza me xhaxhanë qenë vendosur në dhomën e tyre, atëherë kur kishte qetësi në shtëpi pas thirrjes së fundit për lutje, ishte koha e përshtatshme për të lexuar Kuranin në urdu. Vargjet që i shikoja kishin të gjitha të bënin me profetin Jezus. Por unë gjendesha në hutë. Nëse ai do ishte një shërues aq i fuqishëm përse do të kishte kaq pak për të në Kuran?

Teze - i thashë një ditë - di ndonjë gjë për Jezusin?

Tezja mori skajin e lirë të shallit dhe e vendosi rreth kraharorit të saj. Ajo tha e vendosur, sikur t'i recitonte fjalët nga një mësim i mësuar më herët:

Ai është i vetmi profet në Kuranin që u jep dritë të verbërve dhe që i ngjallë të vdekurit dhe i cili do të vijë sërish. Por që nuk e di në cilën sure përmendet.'

Momentin që tentova t'i tregoj në Kuranin tim në urdu hasa në rezistencë:

Ti je e arsimuar. Ti mund ta lexosh atë. Por ne akoma qëndrojmë në idetë tona, sikurse Muhamedi na ofroi? - tha ajo. Nga kjo kuptova që në të vërtetë ajo nuk donte të diskutonte në lidhje me këtë, dhe që ia kishte transmetuar këtë informacion pjesës tjetër të familjes, sepse në mënyrë shumë diskrete qesh pyetur nga Safdar Shahu një ditë.

Ai vinte dy herë në muaj dhe rrinte zakonisht një ditë apo dy, për të kontrolluar çështjet shtëpiake dhe natyrisht për të parë si isha unë. Motra ime Anisa vinte një herë në muaj, ndërsa Samina sa më shpesh që mundte nga Ravalpindi, ku dhe do të rrinte për disa ditë. Nuk e di në kishte një motër kaq shumë në përkujdesje, dhe megjithkëtë aq të vetmuar.

Safdar Shahu mori Kuranin në urdu:

Më vjen mirë të të shoh edhe më tutje besnike ndaj fesë sate Gulshan. A mos ke hequr dorë nga leximi në arabisht, ashtu siç të ka mësuar babai?

Jo vëlla, i lexoj që të dy me rend. E lexoj atë arabisht në mëngjes ndërsa urdun në mbrëmje. Dua që ta kuptoj më në thellësi.

Ai qe i gëzuar me këtë. 'Mirë, është shumë mirë për ty t'i lexosh në dy gjuhë, por mos e lësho leximin në arabisht.' Dhe shkoi me përshtypjen që unë po depërtoja edhe më thellë në islam.

'Me lejen e Allahut unë i shëroj të verbërit, të sëmurit në lëkurë, dhe i ngjalli të vdekurit.'

Me vite të tëra kam qenë duke e lexuar devotshmërisht Kuranin dhe lutesha rregullisht, por që kisha humbur gradualisht tërë shpresën se do të ndryshonte gjendja ime. Tani, prapseprap, fillova të besoj që ajo që ishte shkruar për Jezusin ishte e vërtetë – se ai kishte bërë mrekulli, qe i gjallë – dhe që mund të më shëronte.

‘Oh Jezus, biri i Marisë është e shkruar në Kuranin që ke ngjallur të vdekurit, ke shëruar leprozët dhe ke bërë mrekulli. Andaj më shëro mua gjithashtu’. Derisa lutesha me këtë lutje shpresat e mia u rritën fuqishëm. Ishte e çuditshme, sepse në vitet e lutjes myslimane kurrë nuk qesh ndierë kaq sigurt se do të shërohesha. I mora tespitë e mia, që i kisha sjellë nga Meka dhe e thoja *bismilahun* pas çdo lutjeje, dhe pas çdo lutjeje pastaj e shtoja edhe këtë: Oh Jezus, biri i Merjemës, më shëro.

Gradualisht edhe lutjet e mia ndryshonin derisa po lutesha sërish dhe sërish në mes kohëve të namazit, në çdo kokërr të tespisë, ‘Oh Jezus, biri i Merjemës, më shëro’. Sa më shumë që lutesha aq më tepër tërhiqesha ndaj kësaj figure të hijëzuar dhe sekondare në Kuranin, që kishte fuqi të cilën Muhamedi për vetvetën nuk e dëshmoi asnjëherë. Ku qe e shkruar që Muhamedi ka shëruar të sëmurët dhe që ka ngjallur të vdekurit?

‘Nëse vetëm mund të bisedoja me dikë’ hamendesha, por aty nuk kishte asnjëri. Kështu që vazhdova t’i lutesha këtij profeti Jezus, duke menduar që do të ndriqohesha edhe më shumë.

U zgjova në orën tre si zakonisht, dhe po rrija në shtratin tim duke i lexuar vargjet që tashmë i dija nga zemra. Edhe derisa i thoja fjalët, zemra ime e këndonte liturgjinë e saj, ‘Oh Jezus, biri i Merjemës, më shëro’. Pastaj befas u ndala dhe me zë të lartë thashë mendimin që më ishte ngulitur në trurin tim:

‘Unë jam duke e bërë këtë për kaq gjatë dhe akoma jam e gjymtë.’

Mund të dëgjoja lëvizjet e ngadalshme të dikujt që çohet për të përgatitur ujin për larje, para lutjes së mëngjesit. Pas një kohë të shkurtë tezja do të vinte brenda për të më shikuar. Edhe pse isha duke regjistruar këtë, vëmendja ime po drejtohej në mënyrë urgjente te problemi im. Përse nuk qesh shëruar, edhe pse kam qenë duke u lutur për tre vjet?

‘Shiko ti je i gjallë në qiell, dhe thuhet në Kuran që ke shëruar njerëz.

Ti mund të më shërosh, por unë ende jam e gjymtë.’

Përse nuk kishte përgjigje, veç kësaj qetësie të ngurtë në dhomë, që përqeshte lutjet e mia?

E përmenda emrin e tij sërish, dhe e shtrova kërkesën time, e dëshpëruar. Ende nuk kishte përgjigje. Pastaj bërtita si në ethet e



dhembjes: nëse ti mundesh, më shëro – përndryshe më trego - nuk mund të vazhdoj më tej në këtë rrugë.

Ajo çfarë ndodhi më pastaj ishte diçka që e kam të vështirë ta vë në fjalë. E di që e tërë dhoma u mbush me dritë. Fillimisht mendova se ishte nga lampa ime e leximit përballë shtratit. Pastaj pashë që drita e saj dukej e errët. Ndoshta ishte agimi? Por ishte shumë herët për këtë. Drita zmadhohej, zmadhohej në të ndriçuar, derisa ia kaloi ditës. E mbështolla vetën me shaminë time. Isha shumë e frikësuar. Pastaj një mendim ndërhyri në mua se mos ishte kopshtari, i cili kishte lënë dritat jashtë për të ndriçuar pemët. Ai e bënte këtë ndonjëherë për të parandaluar hajdutët kur mangot piqeshin, apo për të parë ujitjen në një nga netët e freskëta.

Hoqa shaminë për një moment të shihja. Por dyert dhe dritaret shpejt u mbyllën, ndërsa perdet dhe roletat u lëshuan menjëherë. Pastaj pashë disa figura në rroba të gjata, që qëndronin në mes të dritës, disa hapa nga shtrati im. Aty ishin 12 figura në rresht dhe ajo në mes, e trembëdhjeta, ishte më e madhe dhe më e ndriçuar se të tjerat.

Oh Perëndi - unë bërtita dhe djersët dilnin nga balli im. E përkula kokën dhe fillova të lutem.

Oh Perëndi, kush janë këta njerëz, dhe si arritën këta këtu kur të gjithë dritaret dhe dyert janë të mbyllur?

Befas një zë u dëgjua “ngrihu”. Kjo është rruga që ti ke qenë duke e kërkuar. Unë jam Jezusi, biri i Marisë, të cilit i je lutur, dhe ja tani po qëndroj para teje. Ngrihu dhe eja tek unë.

Fillova të qaj: oh Jezus, unë jam e gjymtë. Nuk mund të ngrihem.

Ai tha: çohu dhe eja tek unë! Unë jam Jezusi! Meqë unë hezitova Ai tha edhe herën e dytë. Pastaj derisa ende dyshoja Ai tha për të tretën herë - Çohu!

Dhe unë, Gulshan Esteri, e cila kam qenë e gjymtë në shtratin tim për nëntëmbëdhjetë vjet, ndjeva një forcë të re të kalonte në gjymtyrët e paralizuar. E vendosa këmbën time në dysHEME dhe u ngrita. Bëra ca hapa dhe rashë tek këmbët e vegimit. Qesh duke u larë në dritën më të pastër dhe e cila digjte si shkëlqimi i diellit dhe hënës së bashku.

Drita shndërriti në zemrën dhe mendjen time dhe shumë gjëra u qartësuan atë moment në mua.

Jezusi e vendosi dorën e tij në maje të kokës sime dhe unë pashë një vrimë në dorën e tij përmes së cilës një rreze e dritës ra në rrobat e mia, sa që rrobat e gjelbëra dukeshin të bardha.

Ai tha: 'Unë jam Jezusi. Unë jam Emanueli. Unë jam Rruga, e Vërteta dhe Jeta. Unë jam i gjallë, dhe do të vijë së shpejti. Kujto, që sot do të jesh dëshmitarja ime. Atë që ke parë tani me sytë e tu duhesh ta përcjellësh tek njerëzit e mi. Njerëzit e mi janë njerëzit e tu, dhe ti duhet të qëndrosh besnike ta çosh këtë tek njerëzit e mi'.

Ai më tej tha: 'Tani duhet t'i mbash këto rroba dhe trupin tënd të pandotur. Kudo që të shkosh do të jem me ty, dhe nga sot duhet të lutesh në këtë mënyrë:

'Ati ynë që je në qiell, u shenjtëroftë emri yt. Ardhhtë mbretëria jote, u bëftë vullneti yt, si në qiell ashtu në tokë. Bukën tonë të përditshme na e jep sot dhe na i fal fajet tona si ne i falim fajtorët tanë, dhe mos lejo të biem në tundim por na çliro nga i ligu, sepse e jotja është mbretëria dhe fuqia dhe madhështia në jetë të jetëve. Amen'

Ai më bëri ta përsëris lutjen edhe një herë derisa u ngulit thellë në zemrën dhe mendjen time. Kjo që në bukurinë e thjeshtësisë, por edhe në thellësinë e saj, aq e ndryshme nga lutjet që kisha mësuar nga fëmijëria ime deri tani. E thërriste Perëndinë 'Atë' – ky ishte një emër që u vulos në zemrën time, që e mbushi zbrazëtinë e saj.

Unë doja të rrija aty pranë këmbëve të Jezusit, duke u lutur me këtë emër të ri të Perëndisë – 'Ati ynë'... por vegimi i Jezusit kishte ende për të më thënë:

'Lexo në Kuran, unë jam gjallë dhe do të vijë së shpejti'. Këtë e kisha mësuar më parë por tani më dha besim në këtë që po dëgjoja.

Jezusi vazhdoi edhe më tutje. Unë isha aq e mbushur me gëzim. Kjo nuk mund të përshkruhet.

E shikova krahun dhe këmbën time. Kishte mish në to. Dora ime nuk që e përsosur, porse ishte e fuqizuar dhe jo më e fishkur dhe e ligur.

'Përse nuk e shëron tërësisht?' - e pyeta.

Përgjigja erdhi në mënyrë të dashur:

'Dua që të jesh dëshmitare për mua'.

Figurat filluan të largoheshin dhe të zhdukeshin nga vështrimi im. Unë doja që Jezusi të rrinte edhe më shumë dhe bërtita e pikëlluar. Pastaj drita u largua dhe e pashë vetën të vetmuar, duke qëndruar mu në mes të dhomës, e veshur me petkun e bardhë dhe me sytë e rënduar nga drita verbëruese. Tani edhe llampa përballë shtratit tim i lëndonte sytë e mi derisa qepallat ranë shpejt mbi to. Fillova të afrohesha me pasiguri kah arka e cila qëndronte përball murit. Aty i gjeta syzet e verës, që i mbaja në kopsht. Pasi i vura në sy atëherë isha në gjendje t'i hapja sytë më lehtë që sërish të shikoja.

Me kujdes e mbylla arkën, pastaj u ktheva dhe shikova rreth dhomës sime. Qe njëloj mu sikur para se të zgjohesha. Ora edhe me tutje bënte tik-tak në tavolinë pranë shtratit tim, duke treguar që ishte gati 4 në mëngjes. Dera qe mirë e mbyllur dhe dritarja po ashtu, me perdet e tërhequra afër njëra-tjetrës, për shkak të ftohtit. Nuk mund ta paramendoja ngjarjen, megjithkëtë, kisha dëshmitë në trupin tim. I bëra ca hapa, pastaj edhe ca të tjerë. Ecja nga muri në mur, lart dhe poshtë, poshtë dhe lart. Gjymtyrët e mia ishin të shëndosha pa gabim në anën që ishte e paralizuar.

Oh, gëzimin që ndieja. Thërrisja 'Atë'.

Ati ynë që je në qiell'. Ishte një lutje e re dhe e mrekullueshme.

Befas, ja një trokitje në derën time. Ishte tezja.

Gulshan - tha ajo shpejt!

Kush është duke ecur në dhomën tënde?

Jam unë, teze'.

Një moment qetësie e pastaj zëri i tezës u dëgjua sërish: 'Oh, kjo është e pamundur. Ti s'mund të shërohesh. Si mund të ecësh? Je duke gënjyer'.

'Atëherë, hyrë dhe më shih'.

Dera u hap ngadalë dhe ja tezja po hynte e emocionuar në dhomë. Ajo ngeli e shtangur përballë murit e frikësuar dhe duke mosbesuar, me sytë e zmadhuar dhe të ngulitura në fytyrën time të shkëlqyer.

Do të rrëzohesh - tha ajo.

Nuk do rrëzohem - qesha, duke ndjerë fuqinë dhe forcën e një jeteje të re që po rridhte në venat e mia.

Dalë ngadalë tezja po vinte tek unë, me duar të hapura, si një person i verbër duke e ndierë rrugën e saj. Ajo tërhoqi lart mëngën e këmishës sime dhe shikonte krahun tim, troç dhe e shëndoshë, posa

e bërë. Pastaj më kërkoi të ulesha në shtrat ndërsa ajo shikonte këmbën time, e cila tashmë ishte e shëndoshë si ajo tjetra.

Habitem duke të shikuar në këmbë. Më duhet të mësohem me këtë - tha ajo.

Më pyeti se si ndodhi e tërë kjo. Dhe unë i tregova që nga fillimi, së pari për paralajmërimin e babait, pastaj për zërin që dëgjova në dhomën time natën pasi vdiç. Pastaj i tregova asaj për tre vitet që kisha lexuar për Jezusin në Kuran, duke e përfunduar me shfaqjen e tij ndaj meje dhe me shërimin tim.

Sapo erdha tek pjesa për Jezusin që thoshte se duhej të isha dëshmitarja e tij, tezja ndërhyri, 'Nuk ka të krishterë në Pakistan që ti t'u dëshmosh atyre dhe nuk ka nevojë për ty të shkosh në Amerikë apo Angli. Dëshmimi yt duhej të ishte që t'u japësh të varfërve lëmoshë. Kur këta njerëz vijnë tek ti për ushqim dhe para, kjo do të jetë dëshmimi yt'.

Deri atëherë unë nuk e kisha lidhur urdhëresën e dhënë nga Jezusi me shkuarjen në Angli apo Amerikë. Edhe më tutje fjalët e tij ishin ende reale dhe prezente:

'Atë që ke parë me sytë e tu duhet ta përcjellësh tek njerëzit e mi. Njerëzit e mi janë njerëzit e tu.'

Tani një lutje filloi të lindte në mendjen time: 'Jezus, ku janë njerëzit e tu?'

## 7. Fama

Kur u linda, prindërit e mi u konsultuan me një najumi, i cili e hapi grushtin tim të vogël që të gjurmojë linjat e fatit.

Vajza e juaj do jetë e famshme një ditë - tha njeriu pasi studioi shuplakën time me entuziazëm për një minutë a dy. Babai dhe nëna ime ishin të kënaqur dhe të befasuar, dhe pa dyshim e shpërblyen atë bujarisht për informacionin. Është për ta përmendur këtë se pas një kohë të shkurtër babai im e mallkoi këtë najumi si një hajn dhe gënjeshtar, atëherë kur tifoja më goditi si foshnje gjashtë muajshe, dhe dukej që do të ngelja e gjymtë tërë jetën time.

Por posa mora hapat e parë të jetës sime në agimin e atij mëngjesi të janarit, unë fitova famë të menjëhershme si një mrekulli që ecën. Atëherë nuk e kisha idenë që po ecja drejt një fame të tillë që asnjë tjetër në familje nuk do të mund ta paramendonte.

Shërbëtorët erdhën me vrap. Femrat u grumbulluan pranë derës me pasiguri, e nëpër gojë të tyre dilnin o-o-oh-ët e habisë:

Oh Bibi-xhi, a je ti? A të ka shëruar Perëndia pas të gjithave?

Jesus Emanueli më është shfaqur në këtë dhomë dhe më ka shëruar u thashë. Larg pranisë sime shërbëtorët meshkuj dëgjonin, të shokuar nga habia.

Tezja ime i mënjanoi të gjithë nga rruga, dhe pasi i pozicionoi shërbëtorët e mia nga të dy anët, shikonte me brengë në hapat e mi derisa ecja jashtë dhomës sime, nëpër shtëpi dhe në strehë. Ajo shikonte nga frika se mos do të shkelja në ndonjë cep të panjohur të qilimit, në pllakat e panjohura apo në dyshemenë e vrazhdë nga betoni. Porse mendja ime mori kontroll mbi trupin tim dhe filloi lehtas të diktojë sinjale për të ardhur te kuptimi i dimensioneve dhe planeve të botës fizike. Ka aq shumë dallim në botë në mes të të qenurit një cung druri, i vendosur në një vend, duke pritur të digjet dhe një lisi të gjallë, që aktivisht krijon jetë për të tjerët. Unë fillova të gjej dallimet menjëherë, derisa rrija në ballkon, e bombarduar me ndjenjën e re të të qenurit e gjallë, duke biseduar me xhaxhanë tim.

E shikoja atë nga pjesa e prapme e *dopattës* sime. Unë isha kreu i shtëpisë, porse ai qe kujdesur për të gjitha këto për mua. Si do ta konsideronte këtë ndryshim të situatës?

Nuk kisha nevojë të brengosesha. Ai ishte i kënaqur.

Për ne ti sot je lindur- tha ai.

Nëse babai yt do ishte i gjallë tani do të kërcente nga gëzimi. Ne e kemi të njëjtën gëzim për ty. Ai i thoshte këto gjëra me lot në sy.

Unë i thashë me mirënjohje të thellë nga zemra - oh të falënderit, xhaxha. Përkrahja jote do të thotë shumë për mua.

Së shpejti e dëgjova të fliste në telefon me vëllezërit dhe motrat e mia. Një erë e qetë dhe e freskët e mëngjesit pak a shumë fëshfërinte me kënaqësi, ndërsa çdonjëri kuptoi ç'kishte ndodhur.

Në dukje të jashtme përpiqesha të qëndroja e qetë ndërsa shkova dhe u ula për herë të parë me familjen për shujtën e mëngjes dhe hëngra pa qenë e ndihmuar fare. Isha në dijeni për sytë kureshtar përreth tavolinës dhe kuzhinës derisa e shtrija dorën time të majtë për sheqer apo qumësht apo duke u dhënë gjësendet fëmijëve. Ata ishin të fascinuar, dhe vetëm shikimi i mprehtë dhe paralajmërues i nënës së tyre i frenonte nga pyetjet e shumta që kishin.

Ti mund të ecësh tani dhe të shikosh shtëpinë tënde - tha xhaxhai ndërsa po shkonte në punën e tij duke i çuar fëmijët në shkollë në të njëjtën kohë. Dhe për herë të parë në jetën time unë mahnitesha për shtëpinë time, duke shikuar nëpër çdo dhomë dhe çdo pëllëmb të pronës dhe duke u takuar me buzëqeshjet fatmirëse në të gjitha anët. Ndiehesha sikurse të isha zgjuar nga gjumi pas nëntëmbëdhjetë vjetësh.

Mbaj mend që kisha marrë çelësin e dhomës së babait tim për të kaluar ca çaste atje në vetmi. E bëra për të kujtuar babanë, duke paramenduar se ç'do të kishte menduar ai – aty ishte një dhomë e ndarë dysh, veshur me *çarpai* thjesht dhe mirë, një qilim bezhi, dy karrige, mure të gjelbër të çelët dhe perde. Një fotografi e madhe ishte e vendosur në mur, e bërë në rini, së bashku me disa foto të Mekës dhe Medinës, aty ishte po ashtu pushka e tij e gjuetisë, të cilën e përdorte kur shkonte nëpër fusha.

Lotët më rridhnin. E ndjeva prezencën e tij aq afër – si të ishte çuar nga shtrati dhe po e lëshonte dhomën për momentin dhe do të kthehej sërish. 'Shikon Aba-xhan, lutjet e tua janë realizuar' pëshpërta, duke shikuar lart në foton e tij solemne dhe pastaj nga ai në fotot e Mekës dhe Medinës. Ai e kishte bërë më të mirën për mua – me tepër se shumë baballarë të tjerë do ta kishin ndier të nevojshme. Porse një fuqi më e madhe se ai në këtë botë ishte në

veprim, dhe unë bija e tij e gjymtë qeshë në një mënyrë e bekuar, e prekur dhe e shëruar nga kjo.

Sidoqoftë në këtë dhomë nuk po mundja të gjeja mamanë time, që ata dikur e ndanin bashkë. Hyra në dhomën tjetër më të vogël afër kësaj, që ajo e përdorte për t'i lënë gjërat. Kjo qe një dhomë e sigurt, ku paratë, xhevahirët dhe stolitë ruheshin. Unë kurrë nuk e kam njohur atë, dhe nuk kishte ndonjë fotografi që do t'më tregonte se si dukej meqë asnjë nuk do të mendonte për të bërë ndonjë fotografi të femrave në atë kohë, sidoqoftë, në këtë moment unë e ndieja atë pranë meje dhe qaja me ngashërim për te:

'Oh Ma-xhi, sikur të ishe tani. Pse je larguar edhe ti nga unë në një moshë aq të vogël? Tani nuk të kam as ty e as babanë që të gëzohemi.'

Megjithatë vëllezërit dhe motrat erdhën për të ndarë gëzimin tim. Çdonjëri kishte për të dëgjuar në tërësi, se si natën pasi vdiç babai një zë më tha të lexojë për Jezusin në Kuran. Se si e kisha bërë këtë për tre vjet rradhazi duke iu lutur Jezusit çdo herë e më tepër e dëshpëruar derisa ai u shfaq në dhomën time, më preku dhe më shëroi. Për herë të parë në shtëpinë time pasi vdiç babai kishte një lumturi të vërtetë.

Duhet ta festojmë këtë dhe t'i ftojme miqtë dhe shokët tanë nga qyteti - tha Anisa.

Pse jo - tha Safdar Shahu, kur propozimi iu drejtua atij.

Duhet ta falënderojmë Perëndinë për përgjigjen ndaj lutjeve tona. Në fakt ne mendonim që udhëtimi yt në Mekë ishte kot, por si duket gjatë tërë kësaj kohë ka qenë vullneti i Perëndisë që të shërojë.

Mu kjo ditë e parë për mua qe një kohë mësimi, ku truri im luante lojë të çuditshme. Unë harroja që mund të ecja tani, dhe do të kërkoja nga tezja nëse do të mund të më jepte ndonjë gjë – të themi shallin në fund të minderit. Ajo do të çohet menjëherë, pavarësisht se mua do t'më kujtohej befaz që nuk isha më e gjymtë dhe do ta merrja vetvetiu.

Kah fundi i ditës ndiehesha shumë e lodhur. Fizikisht, vitet e të sëmurit në shtrat ishin zhdukur, porse unë ende e kisha mendjen e invalidit. Do t'më duhej kohë për t'u përshtatur me të gjitha kontaktet që tani duhet të bëja jashtë mureve strehuese të dhomës sime. Tash nuk e kisha problem që njerëzit më shikonin. Krahu dhe

kërmba ime ishin mirë, jo krejtësisht normale, meqë kam patur një numër provash 'eksperimentuese' dhe operacioneve gjatë këtyre viteve, që kishin për qëllim të ndryshonin shkallën e rritjes së disa gishtave të duarve dhe këmbëve. Dallimi ishte se tani kisha mundësinë t'i përdorja gjymtyrët e mi.

Gjatë disa ditëve të ardhshme kishte një numër të madh të vizitorëve, duke përfshirë edhe xhaxhallarët dhe hallat nga larg sikurse dhe motra ime nga Ravalpindi. Në fund të javës ne bëmë gostinë tonë, ku maksimumi i njerëzve të mund të grumbullohej. U tregova të gjithëve se si Jezusi më kishte shëruar.

Këmbëngulja ime për të rrëfyer shkaktoi vërejtjen e parë të vrazhdë në tërë këtë ngjarje, meqë i shqetësoi vëllezërit e mi. Pasi më dëgjuan për të gjashtë herë në lidhje me këtë temë, Safdar Shahu, i cili e ndiente pozitën e tij si udhëheqës fetar i familjes, iu desh të fliste:

Ne do të respektonim më shumë nëse do të thoje që Muhamedi të ka shëruar, Ky Jezusi nuk është aq i rëndësishëm për ne.

Por s'mund të them se Muhamedi më ka shëruar. Ishte Jezusi dhe ai më tha të them kështu.

Jezusi i ka njerëzit e tij në Angli, Amerikë dhe Kanada. Këto shtete janë të krishterë. Ti nuk do të shkosh t'u tregosh atyre atje si të ka shëruar Jezusi, dhe do të ishte gjë e mençur të mos e shpallje një gjë të tillë këtu.

Safdar Shahu e tha këtë si një qëndrim faktik. Ai mbase nuk e kishte menduar të dukej si një kërcënim, por unë kuptova brenda tërë kësaj armiqësinë dhe urrejtjen që ne si familje kishim mësuar për ithtarët e librit nga babai ynë.

Libri i vënë në dyshim ishte Tora (Dhiata e Vjetër) dhe Inxhilli (Dhiata e Re) – librat e hebrenjve dhe të krishterëve, që gjendeshin në Bibël. Myslimanët konsideronin që islami ishte në rrezik nga ata, dhe tentonin të dëshmonin se Kurani, edhe pse kishte zbritur më vonë, ishte përfundimisht më superior, dhe më korrekt, duke i përmbushur librat tjerë. Unë e kisha pranuar këtë, por tani fillova të pyesja vetën.

Nëse Jezusi nuk qe i rëndësishëm, atëherë përse do të ishte Ai që mundi të më shërojë? Përse Kurani, që shpallte të jetë udhërrëfyesi përfundimtar ndaj çdo detaji të jetës sonë, flet kaq pak për të? A nuk qe kjo fuqia për të shëruar, sigurisht, fuqia për të cilën flitej në



Kuran?! Me siguri që vinte nga Perëndia?! Dhe kështu hap pas hapi po tërhiqesha nga uria për të vërtetën. Unë doja t'i lexoja ungjijtë për vetën time, për të mësuar më tepër për Jezusin.

Derisa unë zbuloja fuqinë për të ndryshuar nga familja ime, ata zbulonin gjëra të reja për mua, në veçanti marrëdhënien e tyre të re me mua. Si një motër, e pandihmë dhe e sëmurë, unë kam qenë një krijesë pa vizion për ta. Ata dinin ku të më gjenin, dhe si të më trajtonin. Ata e dinin që çdo herë do të isha e dëgjueshme ndaj sygjerimeve të tyre. Nuk e kisha fuqinë time – isha plotësisht e varur në ta. Tani, sidoqoftë, isha një agjent i lirë, dhe, madje, tani në mënyrë të shumëfishtë isha bija e babait, me një mendje të mprehtë nga edukimi të cilën me siguri nuk do të kisha marrë po të kisha qenë e shëndoshë. Madje, ndonjëherë edhe do të fitoja ndonjë debat me Safdar Shahun. Ai po mësonte që mund të jetë shumë vështirë të argumentonte me mrekullinë e gjallë – kjo në fakt e përmban forcën morale në vetvete.

Që nga fillimi te zja ime këmbëngulte se vegimi i Jezusit nënkuptonte që unë duhesha t'u jepja lëmoshë të varfërve dhe ata pastaj do të shkonin t'u tregonin të tjerëve për të. Si mund të mendoja ndonjë gjë tjetër? Në përvojën e saj të gjërë nuk kishte thjesht asnjë mënyrë në të cilën një grua myslimane do të lëshonte shtëpinë e saj, familjen e saj të sigurt dhe të shkojë t'u predikojë të tjerëve.

Ia bëra Jezusit pyetjen se kush ishin njerëzit e tij dhe ku ishin ata, dhe si do të mund të shkoja tek ata megjithë ndalesën e familjes sime.

Thellë në zemrën time e dija përgjigjen. Më foli si një zë.

Nëse je e frikësuar për shkak të familjes sate, nuk do të jem me ty. Duhet të qëndrosh besnike ndaj meje për të shkuar tek njerëzit e mi. Kjo ishte ajo që mësova derisa po lutesha e përkulur në qilimin e lutjes gjatë një natë të errët, pasi u rivendos qetësia në familje.

Njerëzit e mi, janë njerëzit e tu. Duhet ta përcjellësh mesazhin te ata - më tha zëri.

Nuk i tregova familjes për zërin, porse ata, duke e ndjerë ndryshimin në qëndrimin tim, më vështronin vazhdimisht, dhe më tronditnin me pyetje.

Nuk do ta lëshosh shtëpinë apo jo? Nuk do të shkosh në Angli apo Kanada? E mban mend çfarë the kur u ktheve nga Anglia herën e fundit?

Përse nuk e jep zeqatin ndaj të varfërve, në vend se të shkosh në Angli? E pastaj ata do t'i tregojnë çdo kujt për Jezusin tënd?

Unë tashmë e kisha dhënë zeqatin vjetor prej 50000 rupash lypësve te dera. Tani, brenda dy apo tre javëve, dhashë një zeqat shtesë prej 10000 rupash.

Xhaxhai erdhi tek unë pas kësaj.

Tani do jesh e gëzuar. E ke bërë atë që Perëndia e kërkon nga ne, për të dhënë lëmoshë. E bërë me zemërgjerësi.

Porse nuk isha e kënaqur. Me një zë të ulët thashë:

Por unë nuk e dhashë vetën time dhe kjo është ajo ç'kërkon a'.

Mendova që nuk kishte dëgjuar por e ndjeva frymëmarrjen e thellë e të mprehtë të tij.

Dëgjo Gulshan. Besoj që po të flas tani si të isha babai yt (i pushoftë shpirti në parajsë). Ç'do gjë që Jezusi të kërkon, jepja atij – tokë apo para, por mos e lësho vendin tënd, fenë tënde dhe mos e jep vetën tënde.

Ditë pas dite fillova të jem më shumë në dijeni për sulmet e reja të jetës që buronin brenda saj. Kur muezini e këndoi thirrjen për lutje nga kulla e xhamisë unë shkova në dhomën time si zakonisht, me falënderim që mundja të mbyllja derën para syve të mprehtë të tezës, dhe që nuk kisha nevojë për ndihmën e shërbëtorëve. Unë ndahesha, jo për ta bërë ritualin e vjetër, porse lutja tani kishte marrë thellësinë dhe fuqinë kur i lutesha Perëndisë me gjithë zemër.

Brenda dy orëve të dëgjimit të lutjes 'Ati ynë' unë i shkruajta fjalët. Çdo fjalë plotësonte një nevojë. Ishte sikur të qe shkruajtur në mënyrë të veçantë për mua, dhe s'e kisha idenë se kjo qe një lutje e mirënjohur në familjen krishtere.

Herë të tjera gjatë ditës e thoja lutjen në mënyrën muslimane, duke i marrë trespitë e mi dhe duke i tërhequr një nga një nëpër gishtërinj, klik-klik-klik, dhe me çdo klik duke e thënë tërë lutjen. Në këtë mënyrë qe e mundur të lutesha kudo dhe kur doja unë, meqë për një vëzhgues, dukej sikur të bëja namazin, lutjet muslimane.

Me siguri që e kisha thënë lutjen mijëra herë gjatë disa ditëve të ardhshme, dhe çdo herë bëhej më e lehtë. Tani e kisha një fjalor të ri

për të folur me Perëndinë. ‘Ati ynë’ – oh, këto qenë fjalë që më bënë të shoh Perëndinë në një dritë tjetër. Ai ishte një qenie supreme, patjetër, por Ai që po ashtu edhe babai që kisha humbur.

Sa mirë që ti je babai im’ qaja një natë, duke e ndier një ngushëllim të pashprehur të dashurisë që rridhte poshtë tek unë. Frika ime e vjetër e zezë në mos Perëndia që i zemëruar me mua, nuk kishte vend më.

‘U shenjtëroftë emri yt’ e kuptova këtë, meqë si një myslimane kisha mësuar t’i respektoj emrat e Allahut në Kuran. Myslimanët i përdorin emrat e Allahut me respekt të madh, duke i shtuar disa shtesa të vogla verbale, si ‘u lartësoftë emri i tij’. Emrat e Allahut kanë madje fuqi vizuale mbi imagjinatën e myslimanit, duke qenë një nga format e vetme të dekorimit të lejuara në xhami. Dallimi ishte se kisha parë diçka nga kjo shenjtëri që digjte brenda vetës time.

‘Ardhtë mbretëria jote, u bëftë vullnesa jote, si në qiell ashtu edhe në tokë’. Tani e vura re që Jezusi nuk që vetëm një profet i varfër, sekondar, ishte mbret i përjetshëm, dhe do të vinte sërish për të vendosur mbretërinë e Perëndisë në tokë, si në qiell.

‘Na e jep sot bukën tonë të përditshme...’ kurrë më parë s’kisha menduar për t’i kërkuar Perëndisë për bukë, meqë të gjitha kërkesat e mia kanë qenë shumë më tepër se nevoja, por kjo dëshmonte që Perëndia kujdesej për të gjitha nevojat materiale të adhuruesve dhe donte që ne të vareshim nga Ai, si një baba për ta.

‘Dhe na i falë shkeljet tona, sikurse ne i falim fajtorët tanë!’ Falja? Lutjet e myslimanëve përfundojnë me shqetësim përse i përket faljes. Idetë e tij apo të saj rreth Perëndisë janë të tilla që ai i dënon me meritë ndjekësit e tij sikurse keqbërësit, apo jobesimtarët. Madje unë kisha filluar të jem e sigurt që kisha bërë disa mëkate të mjerueshme, për të qenë e dënuar me sëmundje dhe humbjen e prindërve të mi. E vetmja pikë e shpresës ishte t’i përmbushësh me saktësi dhe në minuta detajet thelbësore të lutjes gjatë ditës, dhe për ta bërë Haxhin për shpërblim të caktuar, së bashku me pesë shtyllat e tjerë të islamit. Madje këtu nuk përmendej rituali i pastrimit, vetëm kishte siguri që për t’u falur mëkatet do të duhej të pranoheshin para Perëndisë, dhe që ai i cili kërkonte falje duhej t’i falte të tjerët. Unë, me gjithë përvojën time religjioze të panjollë, nuk kisha njohur siguri të tillë më parë.

‘Mos lejo të biem në tundim dhe na shpëto nga i ligu’... e thoja këtë sepse më jepte forcë t’i qëndroja besnik vegimit të Jezusit. Vetëm Ai mund të më shpëtonte nga tërheqja e fortë prapa në islam, e cila po vinte nga familja ime.

‘Sepse e jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, përjetë, Amen!’ Fjalët magjike qenë të thjeshta por të fuqishme. Unë e pashë lavdinë, dhe qesh ndryshuar përjetë.

Myslimanët nuk kanë ndërmjetësues me Perëndinë – ndonëse e paramendojnë Muhamedin në këtë pozitë – kjo një arsye përse marrin pozita aq përulëse gjatë lutjes. Ndërsa mua më duket që më ishte dhënë një ndërmjetësues i cili, më kishte ofruar një mënyrë tjetër të afrimit ndaj Perëndisë. Si myslimane, unë isha përgjegjëse për veprimet e mia, të mira dhe të këqija, dhe duhesha t’i merrja pasojat. Perëndia në mënyrë të arsyeshme mund të më dërgonte në ferr për sjellje të këqija. Por këtu që një pikëpamje tjetër rreth Perëndisë. Ta thërrisje atë ‘Atë’ ishte ta bëje atë përgjegjës për jetën dhe gëzimin tim, njëlloj si babai im tokësor. Mendova dhe pastaj u luta, e gëzuar si një fëmijë kur është gjetur nga babai i saj kur ishte e humbur në një treg me turmë të madhe. Doja të dija më shumë, mbase të gjeja një kopje të librit të krishterëve.

Nëse do të kisha shikuar nga ky shteg që po ndiqja, hap pas hapi, do të mund t’i kisha parë retë e rënda që grumbulloheshin mbi kokën time. Vetëm dhjetë ditë pas shërimit tim spektakular ndërsa po pushoja në dhomën time, shpërtheu ‘bubullima’. Familja u kthye në fuqi, dhe u mblodhën në dhomën e burrave me derë të mbyllur për të më gjykuar – së paku kështu më dukej mua.

Natyrisht ata e merrnin ndryshe. Safdar Shahu e mbajti një bisedë të vogël hyrëse:

‘Jemi mbledhur udhëheqësit e familjes që të mbushim mendjen të heqësh dorë nga këto ide ekstreme që i ke fituar së voni. Ne e pranojmë që Jezusi të ka shëruar. Por kur kjo del jashtë nuk do të duket mirë për ne. Ne jemi familje myslimane udhëheqëse, dhe ti do ta shkatërrosh namin tonë.’

Duke i përkrahur vëllezërit dhe motrat e mia së bashku me bashkëshortët e tyre, ishin dajët dhe xhaxhallarët e mi, së bashku me xhaxhanë dhe tezën time, të cilët, siç e kuptova unë, qenë të fajësuar pse e tërë kjo kishte ndodhur.

Nuk fola asgjë për një kohë të gjatë, duke i lënë ata të flisnin. Pastaj thashë:

A nuk jeni të kënaqur që jam shëruar?

Oh po - thanë ata - 'Ne qemë shumë të shqetësuar për shërimin tënd, dhe meqë tani ka ndodhur kjo mos vazhdo të shkosh përreth dhe të thuash që Jezusi të shëroi?'

Pas një qetësie të vogël, Safdar Shahu vazhdoi: "Për shkak të islamit ne mund të të vrasim. Kështu thuhet në Kuranin e Madhërishëm".

Unë shikova përreth tyre në dhomën tonë publike. Motrave të mia u rridhnin lotët. Xhaxhai dhe tezja dukeshin të zbehur nga tmerrri dhe frika. Mjekrrat e hirta të kushërirëve të mi lëkundeshin poshtë dhe lart ndërsa i lëviznin kokat e tyre energjikisht, sytë e vëllait tim qenë të drejtuar në mua si skifteri që shpejton për te gjahu. E ndieja distancën në mes meje dhe tyre duke u rritur në çdo sekondë. Si mundte feja të ushqente një urrejtje të tillë sa që më me dëshirë do të më shikonin të vdekur, sesa të tregoja të vërtetën me të cilën ata nuk pajtoheshin?

'Na i fal shkeljet tona ashtu siç ne i falim fajtorët tanë'. Këtu ishte një e vërtetë që kishte më tepër fuqi se çdo ligj i islamit. Unë për vete nuk ndieja urrejtje për ta në këto momente, veç dashurisë e cila do të mund t'i thyente këto pengesa.

Vëllai im i madh tha, pas një qetësie të vogël:

Nëse do të vazhdosh kështu, do të përjashtohesh nga familja dhe gjithë orenditë që ke këtu. Nëse shkon te njerëzit e krishterë ne do t'i lëndojmë madje edhe ata. Natyrisht, nuk ka të tillë këtu'. Në atë kohë edhe unë besoja ashtu.

Unë çdo herë kam qenë e qetë, modeste, e bindur ndaj më të vjetërve dhe tani ata po më kërcënonin. Gulshanja e vjetër do të ishte dorëzuar, e paaftë për të mbrotjur vetën. Por Gulshanja e re ndiente një fuqi nga brendia që më trimëronte. Nuk kisha frikë aspak nga ta. Fjalët të cilat s'i kisha kërkuar vinin në buzët e mia.

'Unë ju dëgjova deri tani, dhe natyrisht që e kuptoj shqetësimin tuaj' - thashë. 'Nuk mund të përgjigjem në të gjitha pyetjet tuaja sepse jam në pritje të përgjigjeve nga Jezusi. Ai do t'më tregojë ç'do të bëj më pas. Kur e dëgjoj urdhërin, unë do t'i bindem atij madje edhe nëse ju më vritni unë do ta bëj.'

Ca pëshpëritje dëgjoeshin përreth dhomës në ato momente. ‘Ç’qëndrim’ thoshin xhaxhallarët njëri me tjetrin, duke shikuar si të mos u besonin syve të tyre se ç’dëgjonin. Unë u befasova me vetën time, e trimëruar t’i bëja ballë fuqisë së familjes në këtë mënyrë. Tani ç’do bënin ata? Qe një moment i rrezikshëm.

Thashë shpejt: ‘Premtoj që nuk do ta ç’nderoj familjen me çfarëdo që të bëj, porse më duhet të pres derisa Jezusi më flet se si të dëshmoj. Nuk kam takuar asnjë të krishterë deri tani në fakt. Nuk e di ku mund t’i gjej ata.’

Meshkujt vunë dorën mbi dorë. Motrat dhe tezja ime e mënjanuan shikimin në mua. Ata nuk thanë gjë, sepse gratë nuk pritej të përzheshin aty ku burrat merrnin vendime të rëndësishme.

Mendoja nëse familja ime planifikonte të më vriste atëherë dhe aty, në fakt ata do të kishin të drejtë për ta bërë këtë. Askush nuk do ta dyshonte këtë...veç se unë isha e njohur dhe e dashur nga shumë njerëz përreth nesh. Vdekja ime e befasishme do të kërkonte një mbulesë të planifikuar.

Safdar shahu përfundoi:

Mirë. Do të presim për të shikuar se ç’do të bësh. Dhe ne do lutemi për ty. Mbase pas të gjithave ke luajtur mendsh’.

Ishte fundi për momentin, por e dija që nuk do të pushonin derisa të qetësohesha rreth çështjes së shërimit. Porse t’u bindesha atyre nënkuptonte të mohoja atë që isha e bindur se Ati im më kishte shfaqur mua.

Ç’do nga unë të bëj? - iu luta atij e hutuar. Përgjigja më erdhi dy net më vonë. Me një ndjenjë të vërtetë urgjence, e pashë vetën duke u lutur në fjalë të thjeshta – ‘Më shfaq udhën tënde, oh më shfaq udhën tënde.’

Shikova lart dhe pashë një shtyllë të mjegulltë, nga dyshemeja në tavan. Jezusi qe brenda mjegullës, kjo dritë aq e ndritshme që kisha parë më parë e zbuluar brenda mjegullës. Nuk isha duke fjetur, apo ëndërruar.

Ai e zgjati jashtë dorën e tij dhe aty kishte një lloj veshje mbi të. E shtriva edhe unë dorën time. E ndjeva vetën të ngritur lart si të isha në ajër. I mbylla sytë, më pas më lëshoi poshtë ngadal mbi diçka të butë dhe kur shikova veten po qëndroja në një fushë të hapur, e cila shtrihej në një distancë të madhe dhe e cila qe e gjelbër, e freskët, ku

kishte figura njerëzish, disa pranë e disa më larg. Të gjithë kishin kurora në kokat e tyre, dhe qenë të veshur me shkëlqim që i lëndoi sytë e mi.

Dëgjoja fjalët sikurse dhe një melodi të mirë. Njerëzit këndonin 'I shenjtë' dhe 'Haleluja'. Këto qenë fjalë të reja për mua të cilët myslimanët nuk i përdorin. Ata vazhdonin më tutje 'Ai është qengji i flijuar. Ai është i gjallë' dhe e kuptova që të gjithë shikonin nga Jezusi.

Jezusi tha: 'Këta janë njerëzit e mi. Këta janë njerëzit që e flasin të vërtetën. Këta janë njerëzit që dijnë si të luten. Këta janë njerëzit që i besojnë Birit të Perëndisë.'

Një fytyrë u dallua në mes të turmës. Shikova me kujdes në këtë njeri, i cili ulej poshtë. Jezusi tha: 'Shko dhjetë milja lart në veri dhe ky njeri do të ta jap Biblën.'

Ndërsa shikoja në këtë njeri, i cili, si të gjithë njerëzit që i vështroja, nuk dukej të ishte në dijeni për mua, më pas figurat u zbehen dhe unë u ktheva prapa tek vetvetja, e gjuhëzuar në dhomën time në mes të gjitha posedimeve familjare. Mendova sërisht rreth asaj që kisha parë dhe dëgjuar dhe një ndjenjë e madhe e kënaqësisë vërshoi në mua. Unë i kisha kërkuar ç'të bëj më tutje dhe ja tani këtu që përgjigja – të shkoj t'i dëshmoj këtij njeriu për vegimin tim dhe t'i kërkoj një Bibël. Por ku do ta gjeja unë atë?

Pastaj m'u kujtua diç. Razia jetonte në Xhang Sadar, dhe kjo ishte një distancë e vogël në veri të asaj ku jetonim ne. Gjatë festës kisha planifikuar ta vizitoja një ditë së shpejti.

Kjo ishte e tëra. Diku afër shtëpisë sonë jetonte një njeri i gatshëm për të ma dhënë Biblën. Unë do të duhesha të shkoja vetvetiu. Nëse familja ime do të kuptonte, me siguri do të përpiqeshin të më ndalonin. Vendimi u bë, planet i hartova me kujdes, madje plotësisht në dijeni se ç'hap i pakthyeshën do të ishte ky, dhe që do t'ma ndryshonte jetën time.

## 8. Libri

Tri javë pas shërimit tim gjeta kurajon të ekzekutoj planin për gjetjen e Biblës. I thashë tezës që po shkoja për vizitë te Razia.

- Do ta marrësh Selimën?- tha tezja, jo tërësisht e mësuar me mënyrën e re të udhëheqjes së jetës sime.

- Jo teze - i thashë me buzëqeshje. 'Besoj që jam mjaft e rritur tani për të shkuar vetëm pa patur askë të mendojë më të keqen për mua. Të lutem kërkoi Munshiut ta përgatisë makinën për mua'.

Tezja e hapi gojën për të argumentuar por e mbylli sërish, duke rezistuar. Gulshanja e re qenka më pak e prirur se ajo e vjetra për t'u shqetësuar për mendimet e kota të njerëzve.

Mexhidi e solli mercedesin e shkëlqyer të zi dhe e hapi derën e prapme me një lëvizje me stil. Perdet qenë vendosur brenda si mbrojtje ndaj syve përgjues. Çdo centimetër të lëvizjes sonë, derisa dolëm nga dera kryesore, dëshmonte për kënaqësinë e tij me këtë renditje të ngjarjeve. Rojtari me një buzëqeshje i mbylli dyert prapa nesh dhe ne u nisëm.

Razia qe e përgatitur për vizitën time. Ç'nuk dinte ajo ishte kjo qe duhesha të bëja një thirrje. E ktheva Mexhidin prapa, me instruksione të kthehej për mua pas drekës. Pastaj u ndala për ta takuar mësuesen time, e cila qe e stërkënaqur të më shihte në një gjendje kaq të shëndoshë, dhe natyrisht që kishte shumë pyetje të bënte. Qe e zhgënjyer kur i thashë që duhesha ta takoja urgjenisht dikë në anën tjetër të qytetit.

- Jo nuk kam nevojë për shoqëri - i thashë - ka të bëjë vetëm me çështje biznesi që duhet kryer.

E lash atë duke qëndruar në huti te ballkoni i saj, duke shikuar poshtë ndërsa unë shpejtoja për të dalur te dera kryesore. Nuk ndihesha hiç mirë. Asnjëherë në jetën time nuk kisha tentuar ta mashtroja dikë, por kjo qe e vetmja mënyrë për të marrë ndonjëherë Biblën. Nuk ndodhi derisa isha jashtë për të parë që kisha lënë *burkën* time prapa – dukej e tëra simbolike për lirinë që po rritej në brendësi.

Një qerre me kali vinte përballë meje ndërsa unë ia ngrita dorën njeriut mbi të.



Jam duke kërkuar një njeri të krishterë që jeton në rrugën Kaqari.  
Keni dëgjuar për një të tillë?

Ai shikoi drejt përpara, në mes të veshëve të kalit të tij, si të mos kishte dëgjuar fare, dhe unë vazhdova shpejt: 'Kam një lloj pune për të bërë me të.'

Ai bëri me shenjë ka veriu. 'Atje është vendi. Një vend shumë i vjetër që është aty para se Pakistani të formohej. Nuk e di nëse ndonjë i krishterë jeton atje, por nëse do mund të të çoj atje,'

Të lutem më çoj atje.

Hipa në qerre. Njeriu e goditi me kamxhik kalin e tij të përkulur, dhe u nisëm për te vendi i qetë. Kah mes i udhëtimit fillova të reflektoj atë që isha duke bërë. Ç'do thonin motrat e mia po të shihnin më të dashurën e tyre, Gulshanen e lumtur duke udhëtuar në një rrugë të hapur vetëm në një qerre me kali? Thjesht nuk do t'kishte asnjë arsytim për këtë në familjen tonë. Ndonëse nuk kisha zgjidhje. Jezusi më kishte dërguar në këtë udhëtim dhe unë i besova atij për përfundimin.

Erdhëm te një shtëpi e vjetër – një bashkësi krishtere, siç mësova më vonë. Veç kësaj qe edhe një shtëpi e madhe prapa një muri të trashë. Njeriu me qerre u ndal mu te porta e ngjitur për muri. Ja ku është - tha njeriu.

E pagova dhe më pas kalova nëpër portë te një vend i mbushur me lisa. U nisa drejt shtëpisë dhe pashë një njeri që rrinte në diell me një grumbull librash pranë një tavoline të vogël përballë tij.

Duke iu afruar njeriu shikoi lart. Zemra ime u hodh nga habia. Qe fytyra e atij që kisha parë në vegimin tim. Jezusi tha: ky njeri do të ta jap Biblën.

Njeriu foli me konsideratë, me zë gjysmë të ngritur:

Nëse ke ardhur ta takosh gruan time kam frikë se nuk është këtu. Ka shkuar për Lahore.

I fola shpejt: Nuk kam ardhur për ta takuar gruan tënde por kam ardhur të marrë një Bibël prej teje. Të kam parë në vegim.'

Njeriu dukej i alarmuar, dhe më shqyrtoi afërsisht, duke tentuar të depërtonte me vështrimin e tij instinktivisht, në shaminë që e kisha vënë mbi fytyrën time, derisa ecja nëpër kopsht. Tani e lashë shaminë time të binte nga fytyra dhe shikova prapë në të.

Kush je ti? Ç'fe ke ti? Vajza e kujt je ti?

Jetoj dhjetë milja përtej, dhe vij nga një familje myslimane.

Mund të shihja se sa i frikësuar qe nga kjo. Ç'fatkeqësi do t'i sillte kjo grua e huaj myslimane, me kërkesën e saj për Bibël?

Ai tha: nëse do t'isha në vendin tënd do të shkoja në shtëpi dhe do të lexoja Kuranin tënd. Ç'do gjë që ka në të është e mirë për ty dhe ç'do gjë që është në Biblën time është mirë për mua. Nuk të takon ty ta shqetësosh veten me këtë. U ngrit të më përcillte.

Ndonëse qëndrova në këmbë, zemra ime u shterr derisa kënaqësia që kisha filloi të largohej. Unë e kisha paramenduar këtë njeri të më mirëpriste, mbase edhe do t'ishite i përgatitur për vizitën time.

Jezus Emanueli më ka dërguar tek ti. Të lutem më beso.

Ai më studioi për një moment, e pastaj më kërkoi të ulem. Hyra në tregimin tim menjëherë, e turpëruar në fillim, duke u liruar më pas, dhe duke i përshkruar atij pak nga ajo se ç'ishite jeta ime për nëntëmbëdhjetë vjet, si e gjymtë. I tregova atij për udhëtimin në Mekë, për lutjet e shpresuara dhe të zhgënjyera atje. E përmenda vdekjen tragjike të babait tim me përfundimin e mahnitshëm të kësaj, Jezusi duke më folur dhe duke më drejtuar ta lexoja Kuranin.

Ai u përkul para me qëllim, me sytë e tij në fytyrën time. Kurrë më parë nuk kam qenë e shqyrtuar nga një njeri i huaj – veçse ai nuk më dukej i huaj. Vazhdova t'i tregoj për shfaqjen e mahnitshme të Jezusit në dhomën time, dhe për shërimin.

- E pastaj - i thashë - të pashë ty. Jezusi m'u shfaq sërish dhe m'i dëshmoi njerëzit e tij, dhe ti qe në mesin e tyre. Ai më tha të vijë tek ti për një Bibël. Dhe nëse edhe më tutje nuk më beson, dëgjoje lutjen që Jezusi më ka mësuar. I përsërita fjalët e lutjes 'Ati ynë'.

Sapo e përfundova mbretëroi një qetësi. Miku im u ul tani, me krahët e tij duke pushuar në krahët e karrigës, kurse koka e tij e përkulur në kraharorin e tij me mendime të thella.

- Është e mundur? - tha duke i folur më shumë vetës se mua. Nxori frymën nga thellësia e pastaj u ngrit.

- Ulu këtu për pak. Më duhet të shkoj dhe të lutem për këtë, meqë është një hap shumë serioz për të dy ne të ta jap një Bibël.

Ai hyri brenda ndërsa unë u ula nën shkëlqimin e diellit, zogjtë këndues fluturonin shpejt rreth lisave, krahët e tyre të imtë që lëviznin aq shpejt sa që dukeshin të rrinin të qetë në ajër.

Pas asaj që dukej kohë e gjatë ndonëse jo më shumë se një gjysmë ore, miku im erdhi nga shtëpia dhe tha: Jam lutur dhe i kërkova Zotit ç'të bëj dhe më duket që Ai po më flet të ta jap atë që dëshiron. Por besoj që ti e di se mënyra se si po kërkon ta adoptosh është e vështirë, dhe për këtë mund të përjashtohesh nga familja. Do të duhet të bartësh shumë dhe të humbësh shumë, por nëse qëndron besnike do të marrësh jetën e përjetshme.

- I di të gjitha këto - i thashë.

- Por kjo është udha që më duhet të shkoj. Unë dua ta ndjek Jezus Emanuelin i cili më ka shëruar dhe shfaqur rrugën e dashurisë.

Ai buzëqeshi dhe tha: tani mendo për këtë sërish. Kur do të japësh atë që duhet të japësh, djalli do të të sulmojë. Ai do të krijojë për ty shumë pengesa që t'i kalosh. Do të ketë një opozitë të madhe. Madje mund të jetë e mundur që edhe njerëzit e krishterë t'i krijojnë këto pengesa për ty.

Lotët vërshuan nga sytë e mi. 'Nuk jam duke menduar për këto pengesa. Unë di vetëm atë që Jezus Emanueli më është shfaqur. Ai më ka ngritur dhe më ka dhënë dritë. Dua të di më tepër për Të, dhe Ai më ka dërguar te ju për ndihmë. Të lutem më ndihmo'.

Me këtë rast më dha 'Dhiatën e Re' në urdu dhe një libër që quhej 'Martirët e Kartazhës'. Më pas e bëri një lutje të bukur, që vuri në fjalë ndjenja aq të thjeshta të vëllazërisë dhe mirësisë që më bëri të ndihem e fuqishme.

Nga shtëpia e tij unë mora një qerre sërish, prapa te Razia, për kohë të drekës. Nuk i sqarova udhëtimin tim, por vetëm thashë: 'E kam atë për çfarë shkova, por problemi nuk është i zgjidhur ende.' Pastaj e ndërrova temën, dhe ne qeshëm e bisedonim si të mos kishte ndodhur asgjë e çuditshme, deri kur Mexhidi erdhi për t'më çuar në shtëpi.

Tezja që duke më shikuar. Ajo me qëllim shikoi në mua, por unë u ktheva, duke qenë e sigurt se atë që sapo kisha përjetuar do të ishte e shkruar në fytyrën time.

- Si ishte Razia? - pyeti ajo.

- Mirë, ka ca nxënës të mirë dhe është e kënaqur që e motra i është martuar tani.

Është për t'u pikëlluar që nuk e kanë martuar atë akoma, por supozoj që familja nuk kishte të holla për të.

Po është e vërtetë. Ajo akoma duhet të marrë nxënës për të qenë një ndihmesë për babanë e saj, meqë puna e tyre është e vogël.

Thashetheme të tilla do të na kishin mbajtur të okupuar me kënaqësi për dy orë më së paku në kohë të vjetra, por Gulshanja e re kishte interesa më të rëndësishme.

I kërkova falje, shkova në dhomën e fjetjes, dhe e mbylla derën. Pastaj u shtriva në shtratin tim dhe pushova, e rraskapitur emocionalisht dhe fizikisht.

Mu atë natë fillova të lexoja Dhiatën e Re fshehtas. Si do t'ishte? Pyete një njeri te etur si duket uji? Pyete një foshnje ç'farë është qumështi i nënës? Unë e cila kam qenë e ushqyer me lëvozhga tani kisha gjetur bukë për urinë time, dhe lexoja të vërtetën për jetën dhe fatin njerëzor të shkruar në ato fletë. Jezusi më kishte thënë: 'Unë Jam Rruga, e Vërteta dhe Jeta.' Fjalët e tij në ungjij e ndriçuan të kuptuarit tim. Unë kurrë nuk e kisha kuptuar në të vërtetë Kuranin pa komentime. Ky qe një libër si asnjë tjetër. I hapi sytë e mi shpirtëror. Tregimet e saja jetësoheshin ndërsa i lexoja. I takova të 12 dishepujt, që e kishin shoqëruar Jezusin në vegimin tim të mrekullueshëm. E gjeta, fjalë për fjalë, lutjen që e kisha mësuar te këmbët e Jezus Emanuelit. E kuptova kuptimin e këtij emri të çmuar që m'u dha në vegim.

'Unë jam Jezusi. Unë jam Emanueli... Perëndia me ne'.

Unë isha rritur duke menduar për Perëndinë si shumë i largët dhe i paarritshëm. Këtu më në fund qe sqarimi i fuqive hyjnore dhe misioni i Jezusit – ai mundte të ngjallë të vdekurit sepse ishte Zoti i jetës. Ai do të vinte sërish, sepse qe i gjallë përjetsisht. Ai kishte fuqi të përjetshme sepse ishte Zot dhe jo vetëm një profet.

'Unë Jam Rruga, e Vërteta dhe Jeta'. Tani e kuptova si një përmbledhje e vërtetë e një personi që ishte Jezusi.

Në rrjedhën e leximeve të mia unë erdha te pasazhet lidhur me pagëzimin. Lexova tek Marku 1:9-11 se Jezusi qe pagëzuar. Te Romakëve 6:4 kisha lexuar: 'Ashtu si Jezusi u ringjall prej së vdekurish me anë të lavdisë së Atit, që ne të ecim në risinë e jetës'.

Risia e jetës. Kështu ishte se si ndiehesha – si të isha zhytur në një ujë burimi vërshues, të freskët, duke sjellur një jetë rrënoqethëse ndaj çdo pjese të qenies sime. Ashtu ky pagëzim qe një shenjë dhe vulë e kësaj përvoje.

Ndërsa argëtohesha me këtë një figurë më erdhi para e një vajze të re, të pikëlluar që rrinte në karrige derisa shërbëtoret e saja derdhnin ujin e burimit Zem Zem mbi të. Zem Zemi, uji i jetës, nuk i kishte pastruar mëkatet e mia e as që i kishte sjellur jetë mishit tim të vdekur. Jezusi më ka dhënë ujë shpirtëror të jetës për trupin tim të sëmurë dhe shpirtin. Tani unë doja të varrosesha me të me anë të pagëzimit. Mendova për këtë, duke mos e kapur me tërë forcën se ç'po meditoja, dhe ç'ndryshime do të sillte në jetën time.

- Dëshmovja - i thashë vetës: 'Tani e bëra atë që Jezusi kishte kërkuar. Mund të pagëzohem dhe të vij pastaj sërish këtu dhe të jetoj, apo jo? Pyetja qëndronte në ajër, duke pritur ndonjë zë për ta konfirmuar apo mohuar. Por fytyra e babait tim u ngritë para meje, dhe unë ndjeva dhimbje sikur një thikë të ishte ngulur në zemrën time.

'Oh baba, më fal, por më duhet ta ndjek Jezusin, i cili më shëroi.' Fola me zë të lartë e stresuar. Menjëherë një paqe e thellë erdhi mbi mua dhe u ndjeva e sigurt që kjo ishte rruga që duhet të shkoja. Askush dhe asnjëri nuk mund të më ndalte tani.

Aty kah 12 marsi kisha kaluar nëpër Dhiatën e Re. Po ashtu e lexova dhe 'Martirët e Kartazhës'. Qe një libër i mbushur me tregime për të krishterët e hershëm të cilët qenë hudhur para luajve, djegur në zjarr dhe të trajtuar në mënyra tjera të papërshkruara duke qëndruar besnik. E kuptova mesazhin që mu transmetua mua. Nuk e ndryshoi qëllimin aspak.

Të nesërmen e thirra Razinë sërish, dhe nga shtëpia e saj vazhdova te Majori si më parë. Zonja Major këtë herë qe në shtëpi. I tregova atyre shkrimet që kisha lexuar.

Këtu - thashë - kjo më tregon që duhet të pagëzohem. Ju lutem a mund të më pagëzoni?'

Ai e lëvizi kokën. 'Bija ime, ne nuk pagëzojmë në denominacionin tonë'. Ai shikoi në mua me një shprehje të çuditshme. 'A e kupton se ç'mund të të ndodh po e bëre këtë – nuk do të mund të kthehesh në shtëpi asnjëherë. Familja jote madje do t'përpiqet të të vras – oh po, edhe një familje e dashur si kjo e jotja mund të ndryshojë tërësisht kur të shikojnë një anëtar të familjes të braktis besimin mysliman?'

Qe një qetësi e shkurtër. Tëtoja të imagjinoj një rast të tillë të skandalit. Të përjashtohem nga familja, madje edhe e mbytur... E

mbaja mend këshillin familjar ... fytyrat skifteriane që të gjitha të drejtuara nga unë. Më pas mendova për fjalët e fundit të babait ndaj vëllait tim – 'Kujdesu për motrën tënde'. Me siguri, në fund, do t'i bindeshin urdhërësës së fundit të shenjtë. Por edhe nëse nuk do t'i bindeshin, dhe në të vërtetë do të përpiqeshin të më lëndojnë mua unë edhe më tutje duhesha të ndiqja këtë rrugë. Fjalët e Jezusit kishin ngulur rrënjë në jetën time dhe tani kishte freski, vitalitet dhe rritje ku më parë kishte sterilitet të një feje të caktuar në të kaluarën. Thashë me vendosshmëri, që të mos kishin asnjë dyshim ndaj vendimit tim:

'Jezus Emanueli më ka thënë që duhet të jem dëshmitare e tij, dhe pagëzimi është hapi tjetër që duhet të bëj. Më duhet të bindem apo do ta humbas paqen që e kam tani. Më mirë të vdes me Krishtin se të jetoj pa të.

Majori shkëmbu shikimet me gruan e tij ndërsa ajo pohoi me kokë lehtas. Ai m'u kthye mua:

'Le të bëhet ashtu. Nëse Jezusi të ka folur aq qartas atëherë nuk duhet të shkosh kundër vullnetit të tij. Pavarësisht, nuk do të ishte gjë e mençur nga ti të shiheshe duke shkuar në Lahore me mua. Gruaja ime do të të marrë me autobus. Veç kësaj ajo duhet të çojë vajzat tona në shkollë. Unë do t'ju vij pas'.

Sigurisht unë do t'jem e kënaqur të të shoqëroj Gulshan - tha zonja e Majorit, e përkulur para për të marrë duart e mi në të sajat. Qe një prekje njerëzore, duke më mirëpritur mua në familjen e besimit tim të ri.

Ashtu i bëra planet, me pak emocion. Ka mundur të jetë jeta e një personi tjetër që unë po anoja aq shumë. Islami, thuhet shpesh ashtu, qe lindur në shkretëtirë dhe ndjekësit e tij mësuajnë, në atë shkollë të rëndë dhe të vrazhdë, bindjen ndaj instancave më të larta. Ndjenjat personale nuk ishin konsideruar asnjëherë si një arsye e mjaftuar për ndonjë pabesi. Ashtu që, duke ndjekur Jezusin, unë kisha mundësinë të zbatoja – zakone jetëgjata të bindjes ku ndjenjat njerëzore do të mund të më tradhëtonin.

Akoma, duke i hartuar planet e mia, nuk mundja të sillja vetën ashtu, dhe të mbyllja derën plotësisht prapa familjes sime. Të jem e ndershme, unë shpresoja të mund të vazhdoja me pagëzimin dhe më pas të kthehesha në shtëpi, të jetoja jetën time. Një besimtar i

papjekur, e paramendoja që hapat që po bëja ishin që të gjitha ato që Jezusi më kërkonte – t'i gjeja të krishterët dhe t'u thoja atyre për shërimin tim, e pastaj të pagëzohesha.

Majori, përkundër kësaj, po shihte shumë më përpara se sa unë: 'Mos sjell asnjë para dhe asnjë xhevahir. Nëse e bën, është e mundur që pas pagëzimit dikush mund të ndjek të krishterët.' Ai fliste seriozisht, dhe unë shikoja në të duke interpretuar kuptimin e tij në mënyrë korrekte. Ai po fliste për një ndarje të pastër, si të duhesha të braktis çdo gjë prapa meje. Çdo gjë? – Para, xhevahirë, shtëpinë, tokat, dashurinë familjare dhe përkrahjen? A do të thotë që Jezusi me të vërtetë po kërkonte këtë nga unë? Mbase më ka ofruar këtë dhuratë të shërimit vetëm të tërhiqte çdo gjë tjetër që e bënte jetën të dashur?

I thashë Razisë, kur u ktheva tek ajo në atë ditë: 'A mund të vij të të shoh pas dy dite?'

Natyrisht - tha Razia - do të jem këtu.

I thashë tezës dhe xhaxhait në shtëpi që do të shkoja për vizitë te Razia pas dy ditëve, ndoshta do të shkonim në Lahore:

Do të firmos një çek për 75000 rupa, ashtu që të mund t'i paguash të gjitha llogaritë derisa jam në largësi - i thashë xhaxhait.

'Ku ke për të qëndruar në Lahore? - tha tezja, pak e mërrullur duke treguar mospëlqimin e këtij plani. Porse nuk mundte të refuzonte lejen time. Tani qesh një agjente e lirë, dhe për më tepër, ajo që firmos çëçet.

Oh do të mund të rrija me vëllanë dhe motrën time - thashë në pakujdesi. Do të shkruaj një letër.

Të nesërmen i kërkova tezës të më shoqëronte te varri i babait. Ajo e miratoi këtë shenjë devocioni. Ne morëm lulet nga kopshti dhe i lashë atje me ndjenja që vështirë përshkruhen. Respekti për kujtimin e tij qe përzier me të kuptuarit se përjetësia nuk ishte e tillë ç'më kishte mësuar ai, një parajsë e ngushëllimeve materiale, por prezenca e Jezusit.

Në natën time të fundit shkova në kopshtin tim, ku rrija shumë shpesh gjatë viteve të pashpresa. Duke qëndruar në vendin ku arkivoli i babait kishte pushuar, mendova për të sërish, e pikëlluar dhe e përmalluar.

Dielli u zhyt në flakën e kuqe, duke i goditur muret e shtëpisë. Unë ecja në mes luleve, frutave dhe gietheve, duke ndjerë aromën e përzier të trëndafilëve dhe luleve të portokallit. Një erë e lehtë e kësaj nate i lëvizte gjethet e portokallit dhe të mangos, kurse qielli lart meje që i pushtuar me ngjyrë të lehtë vjollce dhe të kaltër të mesnatës. Hëna që e ngritur lart, e madhe si një pjepër ndërsa yjet rrinin të shpërndara si diamantet e vegjël në palët e një natë te qetë. Prapa meje në shtëpi u ndezën dritat, dhe ndriçuan, më ngrohën dhe më siguruan. Megjithëkëtë qëndrova më tutje. Ishte si t'i shihja për herë të parë, tani mu para se të shkoja, dhe nuk lejoja as hijet tinëzare që krruseshin nën lisa të më frikësojnë.

'Përse ta bëj këtë? Mund të jesh ndjekës i Jezusit edhe pa këtë. Mund të humbasësh çdo gjë me këtë veprim.' Një mendim i tillë vinte nga drejtimi i errësirës. Mirëpo si një përgjigje ndaj saj një varg që kisha lexuar erdhi në mendjen time në formë të një zëri të butë:

'Ai që e do të atin ose nënën më shumë se unë, nuk është i denjë për mua...ai që nuk e merr kryqin e vet dhe nuk vjen pas meje, nuk është i denjë për mua.' (Mateu 10:38).

Shikova edhe një herë në shtëpinë time, dhe kujtoja, jo vetëm kohët e lumtura por edhe kohët kur më dukej si një burg, me mua, të burgosurën, duke shpresuar që isha në rrugë për parajsë. U thashë mendimeve të mia me zë: 'Çdo gjë ndryshon. Porse unë do ta kem këtë vend çdo herë në zemër.' Më pas e lash kopshtin dhe hyra brenda për t'u paketuar.

Të nesërmen firmosa dy çëçe – njërën prej 75000 rupa që i dhashë xhaxhait për shpenzimet e shtëpisë, që të mos ngelte pa para dhe të më kërkonte mua aq shpejt – tjetra, prej 40000 rupash, kisha paramenduar t'ia jepja Razisë, për të siguruar bashkëpunimin e saj në planin tim. Kjo do t'i linte dyert pjesërisht të hapur në rast se do të doja të kthehesha në shtëpi.

Më 15 mars, e përcolla xhaxhanë për në punë dhe e putha tezën dhe shërbëtoret Salimën dhe Semën, duke i mbajtur lotët.

Tezja më pyeti, 'Ku je duke shkuar kështu? Merre veturën tënde dhe shoferin me vete në Lahore. Si do të sillësh përreth? A je e sigurt që do të shkosh pa shërbëtoret e tua? Xhaxhai yt nuk është fare i lumtur me këtë.'



Të lutem mos u merakos, teze - i thashë - do të të shkruaj një leter. Ajo duheshte të jetë e kënaqur me këtë.

Mexhidi e solli makinën dhe unë u futa brenda. Shikova prapa njëherë në shtëpinë e bardhë të qetë ndërsa u kthyem në rrugë, më pas qe e humbur për ta shikuar. Gjëja e fundit që pa rojtari nga unë ishte dora, e cila përshëndeste nga prapa perdeve në xhamin e mercedesit.

Kisha ca vështirësi ta bindja Razinë të bashkohej me dëshirat e mia, kur i dhashë asaj paratë, ndonëse nuk ia tregova arsyen e vërtetë për sjelljen time të çuditshme...që po blija kohë, në mënyrë që asnjëri ta parandalojë pagëzimin tim.

'Kjo është për ty, sepse ke qenë mësuesja ime dhe shumë e mirë me mua. Do të shkoj në Lahore për të qëndruar me ca miq. Tani jam e pavarur dhe ndjehem e lodhur duke i sqaruar çdo gjë që më duhet të bëj xhaxhait dhe tezës. I thashë familjes sime që do të vije me mua që të mos merakosen.'

Fytyra e bukur e Razisë mori një shikim të dyshimtë: 'Natyrisht do të bëj çdo gjë që mundem për të të ndihmuar, por çka nëse familja jote do të vinte për të të kërkuar, dhe të më gjenin këtu?'

I thashë shpejt: Të lutem, nëse ndonjë nga ta vjen për të më kërkuar, të pretendosh që je në Lahore me mua? Lejo nënën tënde të dali jashtë për t'i shikuar ata ndërsa t'i rri brenda. Më vjen keq që nuk mundem të të sqaroj më shumë se kaq.

Razia shikoi e befasuar, ndonëse tha shpejt: natyrisht, Gulshan. Ç'do gjë që të duash. Besoj që e njohim njëra-tjetrën mirë, dhe kemi besim tek njëra-tjetra.

Mendoja vallë ç'do të mendonte ajo po t'i dinte intencat e mia të vërteta.

E lash atë si më parë, dhe mora qerre për te shtëpia në rrugën Kaqari. Majori dhe gruaja e tij më pritën ngrohtësisht dhe po të njëjtën ditë qesh marrë me makinë për në një shtëpi në Lahore, e drejtuar nga një pastor dhe gruaja e tij, të cilët i merrnin brenda myslimanët e konvertuar, dhe Revi dhe zonja Aslam Kan.

Kështu e fillova një fazë të re të jetës sime, si një e krishterë e sapo bërë, në mes të njerëzve të krishterë. Në fakt nuk qe aspak ashtu siç e kisha pritur.

## 9. Pagëzimi

Z. Aslam Kan qe një njeri shumë i këndshëm, që dukej t'i kuptonte të gjitha problemet që po kaloja. Ai së shpejti u bë Aba – xhi (baba) për mua. Ama – xhi, zonja Aslam Kan, qe e këndshme po ashtu, në mënyrën e vet. Një zonjë, e vendosur dhe e lirë nga fajësia, dukej të ishte çdoherë e zënë me shtëpinë dhe priste dhe nga unë të jem e zënë po ashtu.

Në momentin kur mbërrita ajo më tregoi dhomën e fjetjes së mysafirëve, me një shtrat thjesht të dekoruar dhe menjëherë mendova për atë që kam në shtëpi, që ishte më i gjërë, me mbuloje të leshta dhe çarçaf pambuku të përdredhur.

Ajo më tha: Kjo është dhoma jote. Këto mund t'i lësh rrobat tua. Banjoja është në atë drejtëm. Këtu ka shumë punë për t'u bërë sepse kemi shumë vizitorë. Të më falësh tani. Kam për t'i dhënë ca urdhëra shërbëtores. Ç'do gjë që të kesh nevojë duhet t'i drejtohesh shërbëtores. Dhe doli jashtë menjëherë.

Unë bëra më të mirën për të kënaqur z. Aslam Kan, por që s'kisha bërë kurrë më parë ndonjë punë shtëpie, dhe isha e marrë dhe e ngathët, dhe shumë e pagatshme për të qenë e kritikuar për detyrat e imta që më qenë dhënë. Kur nikoqirja erdhi prapa meje një ditë dhe bëri me gisht në stolitë që posa kisha pluhurosur, u ndjeva e turpëruar dhe e zemëruar, ndonëse i frenova ndjenjat përbrenda, të cilat i thartuan dhe prishën ditët e hershme në atë shtëpi. Doja t'i ktheshesha dhe t'i thoja asaj:

'Ke të drejtë Ama-xhi. Kam vepruar keq, por ke parasysh që para se të vija këtu kurrë nuk më është dashur të punoj. Asnjëherë nuk kam larë enët, pastruar dhomën, rregulluar shtratin, pastruar rrobat e mia, krehur flokët apo madje edhe të vishem vetë. Kjo qe jo vetëm ngase kishim shumë shërbëtores, por ngase isha në shtrat, e paaftë, për aq shumë vite.

Por nuk thashë asgjë të kësaj natyre. Do të dukej si të arsyetohesha dhe ç'do të ishte edhe më keq në sytë e saj, krenari. Ajo do të kishte mundur të përgjigjej që kësaj rradhe ishte mirë, por që do duhesha të mësoja, apo që isha përtace tej mase. Ashtu që durova ca net pa gjumë, dhe një pëshpëritje përçmuese në errësirë të dhomës sime.

Ende nuk është shumë vonë - tha ky zë. 'Vëllezërit dhe motrat e tua janë duke qajtur. Përse nuk kthehesh prapa.'

I pashë fytyrat e tezës dhe xhaxhait që shikonin me pikëllim në mua. Në pamundësi të pushoja u zgjova dhe endesha nëpër dhomë, përderisa beteja për t'i qetësuar përshpëritjet u bë e tepërt dhe i klitha Jezusit:

'Unë e kam nënshtruar veten time ndaj teje dhe ndiej se jam në shteg të duhur, siç më ke dëshmuar ti. Përse këto fytyra më iritojnë kështu?'

Më pas erdhi një zë i qetë, i ulët: 'Unë jam çdo herë me ty. Ata nuk mund të të dëmtojnë.' Në këtë mënyrë gjeta paqen ndërsa fjalët e Jezusit ngopën mendjen time, dhe zhduken përshpëritjet irituese.

Pas një javë apo më tepër vështirësitë filluan të largohen vetvetiu. Qesh më shumë aktive seç kam qenë në shtëpi dhe kështu fjeta më mirë, dhe shtrati dukej që nuk qe aq i fortë më. Lexova diçka që ndryshoi qëndrimin tim tërësisht ndaj të gjitha formave të punëve shtëpiake:

'Jezusi u ngrit nga darka dhe hoqi rrobat e tij, mori një peshqir dhe u ngjesh. Mbasi hodhi ujë në një legen, filloi të lante këmbët e dishepujve dhe t'ua fshinte me peshqirin, me të cilin ishte ngeshur...' (Gjoni 13:4-5)

Kjo qe diçka e re për mua. Këtu para meje qe zbuluar një shembull i përuljes dhe i shërbesës, që unë nuk do ta harroj kurrë, dhe goditi mu tek rrënja e krenarisë. Ndërsa punoja atë që më qe dhënë, unë mbaja parasysh shembullin e përsosur të Jezusit, që qe bërë shërbëtorë për mua: pastaj nuk ishte vështirë t'i shërbeje të tjerët për të.

Unë qesh në atë shtëpi për pesë javë para se të pagëzohesha. Në momentin që i bëra pyetje Rev Aslam Kanit për vonesën ai tha: 'oh, kam për të bërë shumë takime'. Më vonë kuptova që ai donte të më vëzhgonte për një kohë, të sigurohej nëse do të isha serioze lidhur me pagëzimin. Nuk do të qe mirë që të bëja këtë hap dhe pastaj të kthehesha prapa.

Por shqetësimi rritej se mos zbulohesha. Kisha frikë nëse familja ime kishte filluar të më kërkonte te Razia, andaj dhe i shkruajta asaj:

‘Unë akoma kam edhe ca punë për të bërë këtu, para se të kthehem. Të lutem të mos i tregosh familjes sime ku gjendem. Do të të sqaroj çdo gjë së shpejti.’

Më vonë kuptova që Razia dhe nëna e saj mbaheshin mirë me fjalë, dhe kishin mbajtur sekretin tim, edhe pse u kishte sjellur atyre vështirësi të mëdha. Më kënaqësi them që është e martuar tani – një mikeshë besnike, e ndershme që më kishte mbrojtur me çmim të madh atëkohë, megjithëse nuk kuptonte lëvizjet që unë po i bëja.

Tërë kohën unë isha me zotërin dhe zonjën Kan duke shkuar në kishën metodiste në rrugën Varis. Në mesin e të krishterëve unë gjeta lirinë në adhurim që asnjëherë më parë nuk e kisha njohur. Kishte shumë gjëra që dallonin shumë këtu.

Gjëja e parë që kam vënë re kur hyra brenda ishte dekorimi. Në xhaminë islamike dekorimi është dukshëm abstrakt – fjalë nga Kurani, tavani me lajle, shtylla, kubet, qilimet. Dritat dhe hijet përdoren po ashtu për efekt. Asnjëherë ndonjë figurë të portretizuar apo ndonjë figurë e Perëndisë, ngase si do ta paramendonin krijesat krijuesin e tyre? Këtu ishte një xham i ngjyrosur në dritare, me figurën e Jezusit duke u lutur, kishte lule në tavolina, dhe muzikë. Mbi hark qenë, jo me fjalë arabike, por fjalët, ‘Ja unë po qëndroj te dera dhe trokas.’ Mendova për këtë. Në Pakistan ka shumë trokitje. Çdo kush troket rëndë në dyer dhe porta, por trokitja e Jezusit në portën e zemrës sime qe shumë e butë.

Një gjë tjetër që kisha vënë re ishte mënyra e bukur se si familjet rrinin bashkë – burrat, gratë dhe fëmijët. Njerëzit e pamartuar qenë bashkuar me këto grupe familjare. Nga shtëpia zakonisht vetëm burrat do të shkonin në xhami. Femrat luteshin në shtëpi. Kuptova sa pak mësim fitonin shumë prej tyre, por pastaj Kurani thotë që femrat janë në një pozitë inferiore ndaj meshkujve, ndonëse thekson po ashtu që ato duhet të trajtohen me drejtësi dhe barazi. Porse meshkujt i përfaqësojnë gratë e tyre në xhami. Sa më ndryshe është në krishterim, ku Perëndia vepron në çdo shpirt njerëzor me anë të Jezusit, i cili vdiç për të gjithë.

Bibla thotë që në Krishtin nuk ka dallime sipas racës (hebre apo grek), klasës (skllav apo i lirë) apo gjinisë (mashkull apo femër). Këtu qe një trajtim i barabartë i një lloji të ri dhe të mrekullueshëm. Perëndia pranonte adhurimin tim në mënyrë të barabartë me atë të

vëllezërve në Krishtin, dhe bashkësia e besimtarëve karakterizohet me të mbledhurit së bashku si një trup i Krishtit.

Unë i ndieja këto lidhëse të padukshme të lidhnin tërë atë kishë së bashku me anë të lutjes në këtë 'bashkësi të re krishtere' për të sëmurët, të vjetrit dhe për nevojtarët. Ndihesha sesa isha e mirëpritur në mesin e tyre. Gradualisht fillova të shijoj se si kisha po e zinte rolin e familjes që kisha lënë prapa. Këtu kisha vëllezër dhe motra me bollëk.

Vura re që predikimet e pastorit ishin të qarta dhe të thjeshta, ndonëse merrej edhe me gjëra të thella, nga libri që më bënte aq shumë përshtypje. Nëpërmjet predikimeve të tij e dëgjoja Zotin Jezus duke më folur, jo dhe aq në mënyre direkte si atëherë në dhomën time, por në një mënyrë të tillë që Bibla të më fliste për jetën time.

Po ashtu vura re që ai fliste si të provonte t'i bindte disa nga dëgjuetit e tij. Fillova të kuptoj që disa nga ata që e quanin veten 'të krishterë' nuk qenë dhe aq të dhënë me zemër si unë. Unë kisha jetuar në një ambient fetar strikt që nga lindja, dhe nuk kisha kuptuar që kjo mund të ishte e vërtetë edhe për një mysliman po ashtu.

Nikoqirja ime më kishte paralajmëruar se po u tregoja njerëzve pak si tepër për veten. Unë megjithatë kisha treguar pak për shërimin dhe bisedën time dhe njerëzit në kishë qenë të mahnitur.

'Do të thuash që Jezusi të është shfaqur në dhomën tënde dhe të ka shëruar?'

Habitesha përse përvoja ime që aq e rrallë. Me siguri Jezusi do të kishte punuar në jetën e çdo besimtari si kishte bërë për mua?!

Është në bazë të besimit tënd - tha aba-xhi njëherë kur e pyeta. Kjo që një deklaratë mjaft çliruese. E kuptova që këtu që një parim i përfshirë - se besimi ishte çelësi për vazhdimësinë e kësaj përvoje të mrekullueshme krishtere dhe jetës me mrekullira që unë kisha përqaftuar. U ktheva prapa për të menduar se si që rritur besimi im në mënyrë të panjohur nga unë, që nga dështimi për t'u shëruar në Mekë. Kjo erdhi si një dhuratë, ky besim që mund të lëvizte edhe malet. Ka rrjedhur nga një gjendje e pashpresë dhe në nevojë. Klithma ime ka arritur te veshët e Perëndisë që nuk e njihja, por i cili më njihte, dhe ai kishte hyrë në jetën time. Unë vendosa, në qetësinë

e një nate për të mbajtur besimin të fortë, pavarësisht nga pengesat që do ishin para.

Më në fund edhe dita e pagëzimit tim erdhi, që me 23 prill. Kjo u realizua në një dhomë të shtëpisë në të cilën gjindej një vaskë e veçantë për këtë lloj ngjarjeje. Majori, gruaja e tij dhe disa prej miqve të tyre dhe ata të anës sime u mblodhën. Pastori i Rrugës Waris e bëri ceremoninë, e cila që e thjeshtë dhe e përsosur. Ndërsa po më zhyste në vaskë, unë ndieja që po braktisja Gulshanin e vjetër poshte atje në fund, me mënyrat e saja të të menduarit dhe dëshirat e vjetra dhe një Gulshan i ri po ngritej, 'e varrosur me të në pagëzim dhe e ngritur në risinë e jetës.'

Kjo jetë e re gufonte në mua dhe unë doja të dëshmoja për këtë. Pleqtë që ishin prezentë më dhanë një emër të ri: Gulshan Ester. Më vonë lexova që Estera që një dëshmitare e popullit të Perëndisë – hebrejve ndaj mbretit, dhe për këtë shkak ishte në rrezik. Dhe mua më dukej që kjo përshtatej shumë me rastin tim.

Pas shërbesës femrat vinin dhe më puthnin në ballë ndërsa meshkujt më jepnin dorën dhe më dëshironin mirëseardhje në kishën e Krishtit. Ndihesha e ngrohur me dashurinë e tyre të vërtetë krishtere. Kur të gjithë shkuan z. Aslam Kan më pyeti se si ndihesha: Mirë - u përgjigja - ndonëse tani dua të dëshmoj për atë që ka ndodhur.

Ai lëvizi kokën. 'Ti mund të dëshmosh me veprat tua. Nuk është e nevojshme të dëshmosh vetëm me gojë.'

Por i kisha mbajtur mend fjalët që Jezusi m'i kishte thënë: 'Ti je dëshmitarja ime. Shko te njerëzit e mi.'

Shikova në të, me kokë të ngritur, duke refuzuar të që mundur.

'Por unë ndiej që Jezusi kërkon nga unë të dëshmoj. Mund të flasë në kishë?'

'Nuk mendoj që je në të vërtetë e gatshme për këtë. Dëshmia jote mund të realizohet edhe në shtëpi. Perëndia do ta pranojë këtë.'

Porse ai nuk e njihte këtë Gulshane të re. I thashë: Mirë, nëse nuk mund të dëshmoj këtu atëherë më duhet të shkoj në shtëpi dhe t'i tregoj familjes time. Dua ta bëj këtë në çdo mënyrë.

Ai dukej me të vërtetë i shqetësuar rreth kësaj. 'Jo do t'ishite e rrezikshme për ty. Ata nuk do ta pëlqenin pagëzimin tënd në asnjë mënyrë dhe do të mundje të ishe e lënduar nga ta.'

'Nuk besoj që familja ime do të bënte gjë për të më lënduar, megjithatë nuk do të shkoj derisa të jetë çdo gjë në rregull. Mirë mbase mund të më dërgosh në ndonjë kolegji biblik në mënyrë që të mësoj më shumë për t'ju treguar atyre.

Ai shikoi në mua në mënyrë të çuditshme dhe po mendoja se ç'farë ishte duke menduar ai. Fillova të turpërohem nga pak me mosdurimin tim duke ia imponuar mënyrën time. Isha e re dhe e paduruar për ta bërë detyrën për të cilën isha e sigurt që Perëndia e kishte vendosur para meje, ndonëse nuk e kisha kuptuar sesa e papërvojë dhe e papërpunuar që isha. Sapo e kisha filluar peigrinazhin e vërtetë në jetën time.

Nuk mendoj se mund ta bëjmë këtë ende - tha z. Aslam Kan me vendosshmëri.

Je shumë e re në besim, por nëse ke dëshirë për të bërë ndonjë punë krishtere, ne mund të të punësojmë në shkollën për të verbër.

Ai më sqaroi pak lidhur me shkollën se si kujdeseshin për fëmijët të cilët nuk mund të edukoheshin në sistemin normal. Ai mendonte të me gjente një punë atje si mbikqyrëse. E gëzuar ndaj këtij mendimi u pajtova me këtë.

Menjëherë e takova drejtorin e shkollës dhe shumë shpejt ai erdhi me makinën e tij të më merrte. Kjo ndodhi të nesërmen dhe ne kaluam mbi urën e vjetër Ravi, me ujin e tij të ndyrë, për të kaluar në sheshin në të cilën gjendej shkolla dhe më dukej që po prisja veten për ta humbur të kaluarën time. Prej tani e tutje isha një person i ri, me emër dhe fat të ri.

Puna ime si mbikqyrëse në shkollën 'Lindja e Diellit për të Verbër' në Lahore shënonte një periudhë të re të rritjes. Duke qenë e varur nga të tjerët, tani në një moment u bëra përgjegjëse për një grup të fëmijëve të verbër të vegjël, për t'u kujdesur për nevojat e tyre fizike. Tani në një botë plotësisht të re duhet të mësohesha të përballem, të qëndroj në këmbët e mia. Nuk qe e lehtë.

Jo e lehtë, por shumë më mirë sesa do të mund të ishte. Kjo ndërtesë me tulla të kuqe ka parë shumë ndryshime që nga themelimi i saj nga mirëbërësi indian z. Ganga Ram, si një spital apo shtëpi leprozësh. Zonja Fison e mori në dorë institutin në vitin 1958 si shkollë krishtere për të verbër, e cila u pensionua me 1969. Mendoja për të në mënyrë mirënjohëse. Për mua kjo qe një ambient

i përsosur, i mbrojtur që të mësoj të jetoj në një botë jashtë velit. Si një shenjë e ndarjes nga jeta ime e vjetër unë i preva flokët shkurtë, dhe nga rrobaqepësi kërkova të m'i bënte dy xhaketa të bardha për t'i veshur kur dilja jashtë mbi këmishat e mia.

Këtu gjeta shpërblime të vërteta për kënaqësinë time – jo në rupa sepse pagesa ishte vetëm 40 sosh në muaj – por në dashurinë e pakritikuar të fëmijëve për të cilët kujdesesha. Fëmijët në shkollë rangoheshin nga mosha 5 deri në 16 vjeç. Gjysma e tyre ishin myslimanë dhe gjysma tjetër të krishterë dhe ata luanin dhe dukeshin të lumtur së bashku, e vetmja ndarje ishte për mësimet fetare dhe lutje. Në seksionin tim të shkollës qenë 40 fëmijë. Unë duhesha të kujdesem për çunat e vegjël, të isha me ta gjatë ngrënies, të kujdesesha në oborret e shkollës dhe të flija në konvikte. Duhet të kujdesesha për rrobat e tyre dhe për larjet, t'u ndihmoja atyre gjatë larjes, t'i rregulloja shtretërit e tyre, dhe t'u ndihmoja në detyrat që nuk i bënin mirë – larjen e dhëmbëve pas ngrënies. Po ashtu duhesha t'i laja dritaret dhe t'i pastroja tavolinat.

Përveç tyre duhesha t'u mësoja fëmijëve Biblën dhe një herë në dy javë kur do të ishte rendi im t'i çoja fëmijët në kishë.

Aty qenë dhe dy mbikqyrëse të tjera, kusherira, të cilat ishin të krishtera. Fillimisht ato nuk ishin shumë miqësore, flisnin njëra me tjetrën por jo me mua megjithëse punonim shumë afër së bashku, duke treguar mospëlqim ndaj meje në mënyra jo të përshtatshme. Por pas ca ditëve ato u afruan pak me mua dhe filluan të më ndihmojnë në punët që ishin të vështira për mua, dhe më përkthenin kur flisja me drejtorin që fliste vetëm gjuhën angleze e jo urdu.

Pastaj kur duheshin të shkonin te drejtori për gjëra të ndryshme më kërkonin dhe mua po ashtu. Më ndihmonin kur kisha vështirësi për shkak të duarve të mia. Puna këtu që më e rëndë seç isha mësuar unë, dhe duart më dhembnin. Gjatë javës së parë ato u acaruan nga sapuni që përdornim për larjet e rrobave. Më pas e dogja njëherë dorë në kuzhinë. Së fundi, duke i pastruar tavolinat i shpova duart dhe ato gjakosnin. Qesh në një gjendje mjaft të palakmuar. Rozina, njëra nga përkthyeset erdhi me mua për të përkthyer te drejtori.

Ai që shumë i këndshëm, por ndërsa i dha një pomadë Rozinës për djegien time, ai më tha:



Nuk mund të bëj asgjë për të ta lehtësuar punën. Më vjen keq, por nëse është një punë shumë e rëndë, do të duhesh për ta braktisur.

Mos u brengos, ne do të të ndihmojmë - tha Rozina me lehtësi derisa u kthye në vendet tona, dhe unë në mirënjohje i buzëqesha.

Por menjëherë në dhomën time i ndava të gjitha vështirësitë me burimin e ngushëllimit tim që nuk di të dështojë asnjëherë. Shpejt kuptova që sikurse duart e mia qenë djegur – me siguri nga pakujdesia – duart e Krishtit qenë gozhduar në kryq për mua, dhe vuajtjet e mia në krahasim me ato ç'përjetoi ai qenë asgjë.

Këto ishin sipërfaqësore, ndërsa, betejat më serioze po përgatiteshin për t'u luftuar.

Së shpejti pasi arrita në shkollë i telefonova vëllait tim to vogël, Alim Shahut. I thashë atij:

- Kam qenë duke menduar që do të ishte e ndershme për të treguar që unë jam bërë e krishterë dhe jam duke punuar në një shkollë për fëmijët e verbër në Lahore.

Një frymëmarrje e thellë u dëgjua menjëherë në anën tjetër të linjës:

- Ç'gjë është kjo që ke bërë? -tha Alim Shahu - eja, kthehu në shtëpi dhe harroi të gjitha.

'Tani që e kam gjetur udhën, të vërtetën dhe jetën si mund t'i harroj të gjitha këto.'

Ai tha: 'Qenke çmendur tërësisht! Nëse vazhdon të ma thuash këtë, dera ime do t'jetë përjetë e mbyllur për ty?' Sa më përket mua, ti je e vdekur.'

'Mirë, ma thuaj këtë: si mund ta lëshoj të vërtetën dhe të kthehem prapa tek ti? Nuk mund ta bëj këtë në asnjë mënyrë.'

Zëri i tij qe i trembur dhe i lëmuar: Kuptova. Në këtë rast dera ime është e mbyllur. Ti je e vdekur! Nuk dua kurrë ta shoh fytyrën tënde sërish dhe ti nuk ke për ta parë timen.'

I buzëqesha kësaj. 'Mirë. Nëse dera jote është e mbyllur dera e Atit tim qiellor është e hapur për mua. Nëse jam e vdekur për ty kjo është meqë jam e vdekur në Jezus Krishtin. Dhe nëse ti vdes po ashtu në Jezus Krishtin, atëherë ke për të jetuar dhe ti – dhe atëherë ke për të më parë mua.'

Përgjigja e tij qe për ta mbyllur telefonin.

Po në të njëjtën ditë i shkruajta xhaxhit tim për t'i treguar që isha bërë e krishterë dhe që qesh pagëzuar. Po ashtu i shkruajta dhe

Safdar Shahut të njëjtën gjë. Isha në pritje të reagimeve të tyre por me një nervozë, duke dashur të isha e kuptuar, e pranuar ashtu siç isha tani dhe e lejuar të jetoj në mesin e tyre sërish. Ndonëse në zemrën time e dija që kjo nuk do t'ishte e mundur. Nuk do t'isha e lejuar të adhuroja e lirë siç dëshiroja po të shkoja në shtëpi.

Gjatë kësaj kohe në shkollë nuk ia besova veten askujt. Kjo qe këshilla e Rev. Aslam Kamit. Isha në një pozitë shumë të pasigurt, me shumë kundërshtime që ngriteshin dhe pastori i dashur në të vërtetë frikësohej për mua dhe për të krishterët e tjerë të përfshirë me mua. Andaj kur fëmijët më pyesnin rreth vetvetës, unë i mënjanohesha përgjigjeve direkte. Porse kisha shumë gjëra të tjera t'u tregoja për ç'gjë do të donin të dëgjonin. Ata parapëlqenin t'i dëgjonin tregimet e mia nga Bibla.

Oh Baxhi - zëri i tyre do të ngritej lart në kohën e fjetjes.

Të lutem na trego një tregim tjetër.

'Mirë, vetëm edhe një tjetër e pastaj do t'i fikim dritat.' Dhe do t'u lexoja atyre apo t'u tregoja tregime që Jezusi i kishte treguar, për nëntëdhjetë e nëntë delet që ishin të sigurta në kopenë e tyre dhe për njërin që ishte vetëm në kodër, e humbur. U tregoja atyre për birin e vogël që mori të gjitha paratë që babai i tij do t'ia linte në trashëgim dhe që i shpenzoi të gjitha, sa që asnjë nuk e dëshironte si mik dhe asnjë baba nuk do t'ia besonte pasurinë e vajzës. Unë po ashtu ndaja me ta tregimet që qenë në Kuran – lidhur me Abrahamin dhe Isakun dhe Ismaelin dhe Sarën dhe Hagarën. Myslimanët besojnë që Abrahami (të cilin e quajnë Ibrahim) përgatiti të flijojë Ismaelin si sakrificë. Ngjarja a Biblës dëshmon që Abrahami ofroi Isakun, i cili ishte biri legjitim.

Kishte ca rregulla në shtëpi kundër dhënies së 'ngjyrës' religjioze, në veçanti kur i tregoja tregimet mysli-manëve, ashtu që duhesha të veprojë brenda këtyre rregullave. U tregoja fëmijëve që të dy versionet dhe pastaj do t'i pyesja, 'cila nga këto është e vërteta?'

Çdo njëri grup do të thoshte që e vetja qe në rregull. Së paku patën mundësinë të dëgjonin nga unë që kishte dy versione.

Ne këndonim së bashku. I mësoja ata himne dhe vjersha, gjë që të gjithë fëmijët i pëlqenin. Një ndër më të favorizuarat, e cila këndohej me kënaqësi të madhe qe:

'Këndoju ato sërish për mua,

Fjalët e mahnitshme të jetës.

Më lejo të shikoj më tepër nga bukuria e tyre,

Fjalët e mahnitshme të jetës.’

Rreth orës 9 të mbrëmjes dita mbaronte me vështirësi dhe pastaj gjeja kohën për vetën time për të lexuar dhe studiuar Biblën. Saherë që e hapja atë e njëjta gjë me ndodhte çdo herë. Qe si të kisha një interpretues, që më ndihmonte për të kuptuar. Nëse do të pyesja vetën time një natë: ‘Ç’nënkuptonte kjo?’ do të mund të isha e sigurt se para se të kalonin ca ditë do ta kuptoja. Po rritesha në njohuri të thellë shpirtërore.

Ky lloj mësimi vinte nga ajo që përfitoja nga fëmijët e verbër. Ata plotësonin të gjitha nevojat e tyre me durim dhe gëzim. Sa i doja për këtë, dhe duke i shikuar ata mësoja po ashtu. Mbase e kuptoja gjendjen e tyre aq mirë, meqë ndieja ndërsa i shihja duke luajtur, që edhe unë një kohë qesh e verbër ndaj dashurisë së Perëndisë. Porse tani mund të shihja.

Atëherë familja ime kundërsulmoi. Mora një letër nga Safdar Shahu, të cilën po e prisja një kohë të gjatë, me një ndjenjë frike.

Ai filloi me butësi si çdo herë, me thënie që nuk kishte pritur të dëgjonte një lajmë të tillë nga unë: ‘Ti je motra ime e dashur. Ti e doje Perëndinë aq shumë, babai të donte aq shumë dhe ti ke mësuar shumë nga ai për islamin. Në fakt nuk kam nevojë të të tregoj – ti e di këtë. Po ashtu duhet ta kuptosh që një bijë nga familja Sajed nuk mund të shkojë në rrugën që ti po shkon. Duhet të kthehesh patjetër në shtëpi.

‘Vëllai më ka treguar që je bërë e krishterë dhe për besimin tënd në Jezusin si Bir të Perëndisë. Kjo gjë nuk është e drejtë për familjen apo fenë tonë. Të propozoj që sapo ta lexosh këtë letër të kthehesh në shtëpinë time dhe të dëgjosh këshillën time. Siç e di unë i kam të gjitha letrat ndaj të gjitha pronave që janë në emrin tënd. Nuk mund t’i jipet një të krishtereje që ishte vajzë e një Sajedi.’

Ai më pas shtoi që i tërë Pakistani kishte kuptuar tani që isha bërë e krishterë dhe me këtë nuk më lejohej prona. Letra u përmbyll:

‘Nëse nuk e braktis krishterimin nuk do të lejoj që asnjë gur të kthehet prapa nga ty. Feja ime më lejon ta vras një motër që është bërë e krishterë – dhe të shkoj në parajsë sërish.’

Letra më shqetësoi shumë. Babai ma kishte lëshuar pronën e tij me dashuri dhe tani ata po kërkonin çpasurimin tim sepse jam bërë e krishterë. E paramendoja shtëpinë time të bardhë dhe ndieja për të qarë. Nuk dukej të ishte e drejtë.

Ndonëse duke u lutur për situatën kalova nëpër Gjonin 14: 1-4. 'Zemra juaj mos u tronditë. Besoni në Perëndi dhe besoni edhe në mua! Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe nuk do t'ju thoja. Unë po shkoj t'ju tregoj një vend.'

Këto fjalë më sollën ngushëllim. Kisha një shtëpi të premtuar lart.

E grisa letrën dhe i hodha copëzat në shportën e zbrazët të letrave. Pastaj shkova në bashkësi dhe fillova të këndoj, duke i menduar fjalët, 'Ç'mik na është Jezusi.'

Tre ditë më vonë u shfaq edhe sulmi i tretë – një letër prej shtëpisë nga xhaxhai im. Qe 10 faqe e gjatë, e shkruar në letër të bardhë por të ngjitur lart brenda një zarfi të kaltër.

Në të ai thoshte që më mungonin shumë në shtëpi, duke i përmendur Salimën dhe Semën – Kë do ta shërbejnë ata tani? Kjo më goditi një herë apo dy.

Letra kërkonte që të kthehesha në shtëpi me fjalë shumë dashamirëse dhe përfundoi:

'Je bërë ateiste? Ne po lutemi që të kthehesh në islam dhe në shtëpinë tënde.'

Dielli ndriçonte mbi fëmijët derisa ata luanin në bari mu në mes të kompleksit, ndonëse aty ku qëndroja me letër në dorë, një hije e përhimtë e frikës dhe e dyshimit shtriu duart e ftohta mbi mua.

E palosa letrën por duke u lutur në këtë mënyrë: 'Oh Zoti Jezus, nuk u kam bërë asgjë të keqe. Përse sillen në këtë mënyrë me mua? Tani jam në të vërtetë e rrethuar nga ta. Do t'më ndihmosh ç' përgjigje t'u jap atyre?'

Kur më pas pata mundësinë të mendoj më shumë rreth kësaj, një prospekt tërësisht i ndryshëm nga kjo m'u ofrua. Ata nuk do t'më jepnin pronën time dhe më në fund do të isha e lirë nga e tërë barra e saj. Do të mund të kaloja jetën time duke shërbyer në shkollën e të verbërve dhe të shkoja në kishë për adhurim.

'Nuk duket më e mirë kjo se jeta e padobishme që kisha, e paralizuar në shtratin tim? - i thashë vetës.

Kalova një ditë duke medituar dhe lutur si të përgjigjesha dhe e bëra këtë në një letër të copëzuar nga një ushtrimore:

‘I dashur xhaxha,

E kam marrë letrën tënde dhe jam e vetëdijshme për të gjitha që ke thënë. Me gjithë respektin unë do të doja t’i theksoj pesë pika:

1. Unë e kam gjetur të vërtetën, e cila është rruga e vetme për të Perëndia. Jezusi tha ‘Unë jam dera: nëse dikush hyn nëpërmjet meje, do të shpëtohet; do të hyjë, do të dalë dhe do të gjejë kullotë.’ (Gjoni 10:9). Nëse ti shkon në ndonjë shtëpi nuk mund të hysh brenda veç derës.

2. Unë e kam gjetur të vërtetën. Jezusi tha ‘Duke qenë se ju them të vërtetën, nuk më besoni. Cili nga ju më bind për mëkat?’ (Gjoni 8:45).

3. Unë e kam gjetur jetën. Jezusi tha ‘Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur duhej të vdesë do të jetojë.’ (Gjoni 11:25)

4. Unë kam gjetur faljen për mëkatet e mia.

5. Unë kam gjetur jetën e përjetshme. ‘Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.’ (Gjoni 3:16). Ti më ke quajtur ateiste, dëshmoje përmes këtyre pesë pikave që unë i kam gjetur. Ose dëshmoje apo merre si paralajmërim të mos më thërrasësh më ateiste.’

Nuk thashë gjë për pronën apo për ndonjë gjë tjetër. Nga ajo ditë deri sot nuk kam patur ndonjë përgjigje ndaj kësaj letre.

Pas kësaj, për disa muaj qesh lënë në paqe, megjithëse xhaxhai dhe tezja siç mësova më vonë, vetëm ca javë pas marrjes së përgjigjes sime, morën pakot e tyre, lanë shtëpinë dhe ishin nisur për Karaqi, disa thonë për Iran, duke qenë se ishin trembur shumë nga kjo gjë. Kjo ndodhi për arsye se i frikësoheshin zemërimin të Safdar Shahut, i cili i mbante ata përgjegjës për atë ç’ndodhi.

## 10. Motrat

Erdhi dhjetori – e me të edhe përgatitjet për Krishtlindje. Shumë prej fëmijëve të krishterë do të shkonin në shtëpitë e tyre, por disa do të rrinin. Kështu ne dekoruam dhomën e qëndrimit me një pemë dhe në të vumë ca flamuj dhe bëmë një grazhd të vogël, por mbi të gjitha pamë një dritë të mahnitshme në tregimin e thjeshtë të fëmijërisë së Krishtit në fytyrat e lumtura, të kënaqura.

Për mua po ashtu qe një përvojë – shija e parë e kësaj feste të krishterë. Sikundër këndoja shpesh deri atëherë:

‘Sa qetë, sa qetë dhurata e mrekullueshme na u dha,

Dhe Perëndia kështu vendos bekimet qiellore në zemrat e njerëzve.’

Nuk është habi që edhe të krishterët nominal që nuk janë njohtuar asnjëherë me themeluesin e besimit, gjejnë bekime në të festuarit e lindjes së tij, qoftë me gjel deti apo puding me kremë apo me pulë, pilaf dhe oriz të ëmbël. Gëzimi i krishtlindjes i tejkalon të gjitha kufijt.

Drejtori dhe gruaja e tij i dhuruan çdo fëmije nga një dhuratë me embëlsira dhe lojëra të imta, dhe ne të gjithë shkuam në shërbesë në ‘Armatën e Shpëtimit’ me një minibus të shkollës.

Së shpejti pas Krishtlindjes, unë pranova një vizitor të papritur i cili më solli një lajm të tmerrshëm. Dhëndrri im, Bland Shahu nga Ravalpindi erdhi për të më parë. Ai qëndronte në dhomën e vizitorëve, i lodhur dhe i tronditur dhe më tha që motra ime Anisa, qe shumë e sëmurë dhe ndodhej në Guxherat, ku kishte qenë tre muajt e fundit në një shtëpi me qera për t’u shëruar për shkak të një shtatëzënie të vështirë nga mjeku i tyre familjar, që qe shpërngulur atje në spital. Në muajin e shtatë shtatëzënia kishte marrë kahje të gabuar. Foshnja qe e vdekur dhe mjekët në spital nuk patën mundësi të ndalin gjakderdhjen.

‘Ajo është në momentin e vdekjes dhe nuk e ndalë së përmenduri emrin tënd. A ke mundësi të vish menjëherë me mua? E kam veturën jashtë.’

Qe një thirrje që nuk mund ta refuzoja. Një derë që mendoja se ishte e mbyllur përjetë u hap sërish.

‘Oh motra ime e dashur! Natyrisht që do vijë, ndonëse më duhet të marrë leje së pari.’

I kërkova falje duke dalë nga dhoma. Një zë i lehtë më pëshpëriti në vesh: 'Ajo do t'jetë e vdekur kur të kesh arritur. Është humbje kohe për të shkuar. Ata nuk do të lejojnë të flasësh për gjëra të tilla. Ata në fakt do të tentojnë të parandalojnë edhe kthimin tënd.'

Para se të takoja drejtorin, hyra në dhomën time dhe u luta. Përgjigjja erdhi menjëherë: 'Shko menjëherë te ajo. Ajo nuk ka për të vdekur. Do ta mbaj në jetë.'

Kërkova për dy ditë leje dhe ato mu dhanë, dhe hodha ca gjëra të vogla në çantën time. U nisëm në 5 të mëngjesit. Për afro tre orë udhëtim iu afruam Guxheratit, ku dhe u pritëm me lajm të tmershëm.

Ajo ka vdekur - tha mjeku i motrës sime, z. Kan.

Ajo vdiq në orën 7 meqenëse kishte humbur shumë gjak.

Hyra në dhomën ku qëndronte e shtrirë motra ime. Kishte marrë një pamje ngjyrë të verdhë në të gjelbër, ndërsa buzët e saja qenë në të kaltër. Burri i motrës sime u largua për shkak të vërshimeve nga lotët dhe që mënjanuar në mënyrë të këndshme nga njëri prej familjarëve të tij.

Dhoma që mbushur me vajtues... anëtarë të familjes dhe fqinj – lajmi i vdekjes udhëton shpejt dhe njerëzit vijnë shpejt për të ofruar respektet e tyre ndaj të vdekurve.

U përkula dhe fillova të qaj përballë shtratit. Jezus - thashë në zemrën time - Ti më the që ajo do t'ishte e gjallë. Ç'gjë më duhet të bëjë? Ajo qenka e vdekur.

Vazhdova të lutesha. Jezus, ti je Rruga, e Vërteta dhe Jeta. Të lutem bëje këtë mrekulli dhe ringjalle. Vazhdova të lutesha kështu ndërsa një mendim më erdhi fuqishëm se Jezusi më kishte thënë: ajo s'ka për të vdekur. Do ta mbaj në jetë. Andaj vazhdova të lutem: 'Zot, jepi pak jetë që të mund t'i flas vetëm pak për ty.' Më pas dëgjova një zë: Ajo nuk është e vdekur. Ajo është e gjallë. I kam dhënë asaj jetën. Me të ndëgjuar këtë u ngrita menjëherë dhe u thashë të gjithëve: Përse qani të gjithë? Ajo nuk është e vdekur – ajo është e gjallë.

Mbretëroi një tmerr i përgjithshëm. 'Qenka çmendur fare. Çojeni në dhomën tjetër. Mbylleni.'

Më hodhën jashtë në një dhomë fjetjeje të zbrazët. E dëgjova të mbyllej rezja e derës nga jashtë. Unë s'isha asgjë tjetër veç një e

burgosur. Këmbëngula në lutje: 'Zot zgjoje motrën time që të mund të besojnë se është e gjallë.'

Deri në këtë moment ata qenë duke i bërë ritualet e fundit dhe përgatitjen e arkivolit. Trupi i motrës sime që larë dhe rrobat qenë ndërruar më parë. Ajo do të duhej të lahej edhe një herë, por jo gjatë natës. Dhe ora kishte ecur në tetë të mëngjesit para se rezja e derës të dëgjohej edhe një herë dhe unë qesh liruar për të përshendetur edhe një herë motrën time.

Isha duke qëndruar pranë shtratit të saj me gra të tjera. Gruaja e imamit e bëri kalmasin e saj dhe pastaj ajo dhe tri të tjera lëvizën para ta kapin trupin për larjen përfundimtare. Unë pashë në duart dhe këmbët e saja kënen e kuqe ... shenjë e lumturisë, shenjë e gjakut.... Më pas ata do të mbështjellnin motrën time në çarçaf dhe do ta vendosnin në arkivol.

Befas motra ime e lëvizi krahun, i hapi sytë, u ngrit dhe shikoi përreth me habi. Pastaj i analizoi duart e saja në paqartësi dhe pyeti: Ç'ndodhi?

Njerëzit bërtisnin, ranë prapa, ndërsa disa tentuan të largohen nga dhoma. Qe një panik e pabesuar. E pëqafova Anisën dhe ajo u ngi për mua. Njerëzit filluan të kthehen. Dhe të gjithë shikuan kah unë. 'Ç'bëre? Si ka mundësi njeriu i vdekur të rrijë ulur?'

Qesh e mbushur me gëzim dhe me një ndjenjë të madhështisë së Perëndisë. U thashë, me buzëqeshje: Pyeteni atë ç'ndodhi?

Anisa fliste si zakonisht në stilin e saj të qetë. Mos u frikësoni nga unë. Unë jam e gjallë.

Burri i saj dhe imami, maulvi dhe muezini nga xhamia erdhën me vrap, pasi dëgjuan zhurmën. Maulvi vendosi dorën e tij në kokën e saj dhe pyeti: Bati, ma thuaj të vërtetën. Ç'ndodhi? Ç'ndodhi me ty? Katërmbëdhjetë orë më parë ti ishe e vdekur! Ne po bëheshim gati për funeralin tënd!

Ajo tha: nuk isha e vdekur.

Doktoresha që aty: ti ishe e vdekur. Nuk kishte shenja të jetës në ty - insistonte ajo.

Nuk qesh e vdekur por isha në gjumë - tha motra ime. 'Derisa po flija pashë një ëndërr që po bëhesha gati për të vënë këmbën në një shkallëz. Në maje të kësaj shkallëze që një njeri në rroba të bardha që gjithashtu kishte dhe një kurorë të artë, dhe në të njëjtën kohë



ndriçonte me ballin e tij. Pashë që mbante dorën e tij mbi mua, e cila ndriçonte po ashtu. Ai më tha: ‘Unë jam Jezus Krishti, Mbreti i mbretërve. Kam për të të kthyer prapa dhe në kohën e duhur do të sjell sërisht këtu. Dhe pas kësaj hapa sytë menjëherë.’

Ajo e thoshte këtë me një fytyrë të ndriçuar nga gëzimi. Fjalët nuk mund të përshkruanin gëzimin dhe ngazëllimin në familjen tonë. Unë e shfrytëzoja rastin për t’u treguar të gjithë atyre që do të donin të dëgjonin për këtë profet shërimbërës, që ishte më tepër se një profet – Jezusin.

Veç kësaj edhe burri i Anisë, i cili ishte njëri ndër kundërshtarët më të mëdhenj në fillim, tani pohonte që lutjet e mia e kishin sjellur gruan e tij në jetë.

‘Cili është profeti më i madh që ke parë?’ pyeti ai tri ditë pasi mysafirët u shpërndanë. Unë e mora Kuranin dhe i tregova pasazhet lidhur me Jezusin nga sureja Merjem. Më pastaj ia tregova në Bibël edhe tregimin e ringjalljes së Lazarit në Gjonin 11:43-44: ‘A mund të besosh tani që Jezusi ka ngritur të vdekurit? Këtu thuhet që ai kishte urdhëruar “Lazar dil jashtë” dhe ai doli.’

Ngadal u përgjigj, ‘Po, unë besoj që kjo është nga Jezusi, biri i Merjemës. Gruaja ime ka një jetë të re.’ Ai dukej shumë i lumtur dhe i pranonte ato që unë i thoja.

Ndonëse ishte Anisa ajo që përjetoj ndryshimin më të madh. Ajo çdoherë ka qenë një motër e dashur për mua dhe tani siç vihej re ajo nuk mund ta mbante më gëzimin dhe paqen. E dëgjova atë duke i thënë maulvit dhe gruas së tij të gjitha rreth vegimit të Jezusit dhe vëreja që ata i dëgjonin të gjitha me vëmendje. Porse pas kësaj ata filluan të më merrnin në sy për të keq.

‘Më trego më shumë për Jezusin’ më pëshpëriti ajo në momentin kur kishim një kohë të lirë së bashku. Kështu që i dhashë një kopje të vogël të Dhiatës së Re dhe ajo më premtoi që do ta lexonte, megjithëse ajo ndjente që kishte nevojë që dikush t’i ndihmonte për ta kuptuar. Ajo filloi nga ungjilli i Mateut dhe unë i sqarova mënyrën se si Jezusi qe lindur dhe prej çfarë linje rridhte ai.

Vazhdo të lutesh për mua. Unë do të qëndroj besnike ndaj asaj që kam parë, që të mund ta ndjek atë që më dha jetën - tha ajo.

Jam e martuar dhe kam nevojë për shumë lutje.

Sytë m’u mbushën me lot. E ndieja pozitën e saj nga brendësia.

Pas të gjitha këtyre ngjarjeve mendja më ishte larguar fare nga shkolla e 'Lindjes së Diellit', porse befasisht m'u kujtua që duhej të kthehesha prapa. Në të vërtetë unë mezi prisja për t'i treguar dikujt atje lidhur me këto mrekulli. Kur u nisa për të marrë autobusin prapa për Lahore, Anisa e shtrëngoi dorën time dhe më tha: 'Dera ime është hapur për ty. Kurdo që të kesh dëshirë mund të kthehesh te ne. Edhe nëse pjesa tjetër e familjes nuk don për të të shikuar, unë dua.'

Ndërsa autobusi tërhoq nga stacioni i Guxheratit, e rraskapitur nga njerëzit nga qyteti dhe të tjerë, u ndala për t'i menduar ngjarjet që nga vizita ime, duke mos dashur të ishin si një ëndërr e lumtur për mua. Tërë këto ngjarje kishin përmbledhur një gjë – që unë doja këta njerëz dhe botën e tyre sërish, ndonëse nuk mund të jetoja më në të. Qe një pelegrinim, por jo në rrugë për Mekë porse në një rrugë më direkte te Perëndia nëpërmjet Jezusit. Shkolla e 'Lindjes së Diellit' qe bërë për mua si pjesë e pelegrinimit tim. Derisa autobusi ngjitej lart rrugës për në Lahore, unë mendoja për t'i përqaftuar fëmijët e verbër sërish.

Por tërësisht e pavetëdijshme unë kisha bërë një gabim trashanik. Kur arrita në shkollë, tri ditë me vonesë, autoritetet e shkollës më thanë:

'Ti i kërkove vetëm dy ditë, por qëndrove pesë.'

Qe një intervistë e dhimbshme në të cilën u përjashtova pa pasur mundësinë të arsyetoja vetën. Megjithëse ia dorëzoja mbrojtjen time Perëndisë dhe e lejova atë të sillej si gjykatës.

Disa minuta më pas unë qëndroja anash rrugës Ravi pranë një shtylle elektrike, edhe më tutje e shokuar dhe konfuzë nga befasia e largimit tim. Qesh e uritur – koha e drekës kishte kaluar dhe unë nuk kisha ngrënë asgjë që nga mëngjesi i hershëm. Ishte ftohtë dhe me mjegull. Errësira do të vinte së shpejti. Fytyrat mjaft të duruara të fëmijëve të verbër mu shfaqën në mendje, dhe sytë m'u mbushën me lot. Ata nuk do të kishin më tregime nga Ba-gji. Veç kësaj kisha ca të holla borxh. Më nuk kisha asnjë rupi veç disa nga ato që m'i kishte dhënë motra ime atë mëngjes. Rrija aty e habitur, e vetëdijshme që ishte një zonë e vetmuar dhe që një myslimane e kthyer do të mund të priste shumë pak mbrojtje.

Atë - i thashë Perëndisë duke e dorëzuar fatin tim në duart e tij - ka njerëz të mirë dhe të këqij në këtë qytet. Ke ndonjë vend për bijën tënde? Të lutem më trego ku mund të shkoj.

Menjëherë e kuptova përgjigjen: 'Shko prapa në Guxherat.' Kisha para të mjaftueshme sa për rrugë. Hipa në orën 2 në autobus dhe pastaj në një qerre dhe e befasova motrën time. Ajo u hodh me krahët e saj mbi mua dhe me shumë gëzim më tha:

Më vjen shumë mirë që je kthyer tek unë. Tani mund të më ndihmosh në lidhje me Biblën.

Edhe Bland Shahu që i kënaqur të më shihte sërish, meqë do të isha shoqëruese e gruas së tij. Ajo e ndiente mungesën e fëmijëve të saj, të vajzës tetë vjeç dhe tjetrës gjashtë vjeç, të cilat ishin në Ravalpindi së bashku me gjyshërit e tyre. Atij gjithashu i duhej të shkonte atje për të kontrolluar diçka lidhur me biznesin e tij, në të cilin ishte partner.

Ashtu që për një kohë unë dhe motra ime përjetuam marrëdhënien e re pa asnjë pengesë. Sikundër dy qengja të rinj ne ushqeheshim nga bimët e gjelbëra të fjalës së Perëndisë, dhe dukej shumë qartë ndryshimi i saj ndërsa mësonte më tepër rreth përjetimit të një jetese të re. Ajo ishte më pak urdhëronjëse ndaj shërbëtorëve dhe ndonjëherë do të bënte punën vetvetiu. Ajo në fakt edhe do t'u kërkonte shërbëtorëve për të ngrënë më parë, 'Të varfërit kanë të drejtë më parë.' Ajo e kishte gjetur vargun 'Vlerësoji të tjerët më shumë se vetvetën.'

Kur e pyeta, sa për t'u siguruar lidhur me motivet e saja, 'Përse po e bën këtë?' Ajo u përgjigj, 'Sepse po të vdisja nesër do të dija ku do të qëndroj, po përpiqem të jem një nga shërbëtorët e tij të bindura.'

Reagimi i shërbëtorëve që me të vërtetë i befasishëm. Që nga momenti kur Bibi u ngrit nga të vdekurit ajo është bërë si një engjëll - më thanë ato. Tani ato punonin edhe më shumë për të, duke i shërbyer asaj nga gjithë zemra. Ndaj meje shfaqnin respekt të madh po ashtu.

Një nga ditët ajo më pyeti rreth pagëzimit tim dhe ndërkohë i dëgjonte me kujdes sqarimet e mia lidhur me kuptimin që kishte. I thashë – është me rëndësi që të varrosesh së bashku me Krishtin në pagëzim nëse me të vërtetë e don jetën. Kur ne pagëzohemi ne e

pastrojmë trupin tonë, mendjen dhe shpirtin dhe bëhemi pjesë e popullit të tij.

Pastaj ajo tha: dua të pagëzohem meqë jam e krishterë tani. Kam ndryshuar në zemrën time tani dhe dua të bëj një hap më tutje tani.

Gëzimi im qe përzier me frikë në këtë moment. Mua më kishte kushtuar shumë për t'u pagëzuar. A e kishte kuptuar ajo me të vërtetë çmim do të duhej të pagonte për këtë akt?

Porse Anisa këmbëngulte. 'Do të isha e lënduar po të mos pagëzohesha - tha ajo - nuk do të isha myslimane e as e krishterë. Do të isha jashtë - më tha me vendosmëri dhe unë kapitullova. Ç'të drejtë kisha unë ta refuzoja ndihmesën time për të? Ndonëse e kuptova menjëherë që rreth kësaj nuk do të kisha ndihmë nga pastori i krishterë – kjo do të ishte katastrofë për familjen e Bland Shahut, nëse jo edhe nga ndokush tjetër. Do të duhesha ta kryeja ceremoninë vetvetiu.

Një pasdite i kërkuam shërbëtores ta mbushte vaskën e thellë nga cementi me ujë të vakët dhe për të bërë gati ca peshqire dhe rroba të pastra. Pastaj e larguam atë. I pashë sytë e saja të errëta dhe kurriozë të ngulitura në ne ndërsa e mbyllëm derën e banjos.

Qëndrova me Anisën në ujë dhe e pyeta nëse do të rrëfente besimin e saj në Krishtin. Ajo tha: tani do ta varros veten time të vjetër dhe do të jem e re në Jezusin, dhe do të jem besnike.

Pas kësaj e zhyta në ujë në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë dhe e dorëzova nën mbrojtjen e Perëndisë. Qe një moment triumfues. Më pas Anisa më kishte treguar se kur ishte lutur ajo qe ngritur lart me krahët e engjëjve dhe kishte parë në vegim njerëzit duke qëndruar përreth dhe duke lavdëruar Jezusin.

Unë sapo kisha filluar të mësoja që, megjithkëtë, sa herë që ndieja gëzim mbi diçka duhesha të isha në dijeni dhe e kujdesshme për aktivitetet e forcave të errta të së keqes, dhe ky rast nuk qe një përjashtim. Dhëndri im kishte dëgjuar për pagëzimin. Besoj që shërbëtorja veshëmprehtë i kishte treguar diçka dhe ai kishte filluar ta merrte në pyetje motrën time lidhur me atë ç'kishim bërë.

Anisa dukej e frikësuar, 'Ai më pyeti për pagëzimin natën e kaluar dhe unë i thashë atij ç'nënkuptonte pagëzimi. Tani është i zemëruar. Ai nuk e pëlqen dhe nuk e kupton tërë këtë lidhur me kryqin. Nuk mund t'ia sqaroj atij. Mendoj që është duke kërkuar një moment për

t'argumentuar me ty. Të lutem përpiqu mos ta shqetësosh atë apo ka për të të kërkuar që të shkosh nga këtu.

Unë tentoja të pajtohesh veçanërisht me dhëndrin tim, por prapëseprapë rashë brenda në një argument me të.

Ai më sfidoi për t'i treguar dallimet në mes të të lexuarit të Kuranit dhe Biblës. Natyrisht që duhesha t'i tregoja që Jezusi qe dallimi më i madh. Ai ishte udha, e vërteta dhe jeta...

Leximi i Biblës është krejt në rregull, porse kryqi nuk është në rregull - tha Bland Shahu.

Thuhet edhe në Biblën tënde që vetëm njeriu i mallkuar ka për të vdekur në kryq dhe si ka mundësi që njeriu i mallkuar t'i jap jetë një tjetri. Ai mbante një shikim triumfues dhe mendonte që më kishte futur brenda një kurthi.

Kjo qe vetëm një hyrje për të cilën kisha nevojë. I lexova atij 1Korintasve 1:18 – “ Sepse mesazhi i kryqit është marrëzi për ata që humbin.”

Ai nuk tha gjë, dhe e fuqizuar vazhdova më tutje për t'i lexuar nga Gjoni 1:29 – ‘Ja qengji i Perëndisë që heq mëkatën e botës.’

Motra ime dëgjonte e ulur, me një shikim të largët në sytë e saj, duke mos u përzier fare.

E çova atë te Tora, te rrënjët e tij myslimane për t'i sqaruar si fljijimet e gjakut për zëvendësim i qenë dhënë Abrahamit nga Perëndia, dhe pas Jezusit nuk kishte më nevojë për to. Këtë ia dëshmovava nga Zanafilla 22:11-12 ‘Mos e zgjat dorën tënde kundër djalit’, dhe pastaj nga Gjoni 12:32 – ‘Dhe unë, kur të jem ngritur lart nga toka, do t'i tërheq të gjithë tek unë.’ I tregova atij që vetëm përmes fljijimit madhështor të Jezusit në kryq mëkatet tona mund të jenë të falura...zëvendësuesi i plotë dhe i përsosur.

I thashë atij që këto gjëra i kam gjetur të përmendura në Kuran së pari dhe më pas kisha gjetur kuptimin e plotë dhe më të thellë në Bibël. I tregova për profetët që patën paralajmëruar Jezusin. Po ashtu i përmenda që Bibla nuk ishte vetëm një libër i thjeshtë por një fjalë e gjallë e Perëndisë dhe që çdo gjë që kishte ndodhur në jetën time, pata gjetur ndihmë për të në Bibël.

E përfundova me Veprat 4:11-12: ‘Ky është guri që ju, ndërtuesit, e hodhët poshtë dhe që u bë guri i qoshes. Dhe në asnjë tjetër nuk ka

shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër në qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem.

E tërë kjo që në dhomën e ditës në 10 të mëngjesit. Ai rrinte aty si të ishte i hipnotizuar. Pastaj u rikthye dhe mezi shikonte në mua. 'Do të më bësh edhe mua të krishterë? Ti je këtu në shtëpinë time duke ngrënë nga tavolina ime dhe duke nënçmuar besimet tona myslimane në këtë mënyrë! Dil jashtë tani menjëherë dhe kësaj radhe mos u kthe më.'

Motra m'i futi ca para dhe pëshpëriti. 'Mos u kthe prapa në Lahore. Nisu për Ravalpindi dhe kam për të të gjetur atje kur të vij.'

Ajo më dha adresën e një mikeshë të rëndësishme familjare, një shia tjetër, burri i së cilës ishte një zyrtar qeveritar i lartë. Ajo mbante një pozitë të lartë në shoqatat humanitare që merreshin me përmirësimet e fatit të grave, duke u ofruar kushte më të mira. Mbase ajo do të kishte ndonjë punë për mua.

Kjo që një lajm i mirë. Unë kisha nevojë për një punë. Në këtë mënyrë u ktheva prapa për te stacioni i autobusit me një qerre dhe kapa autobusin për Ravalpindi. Tre orë e gjysmë më vonë hipa në një qerre tjetër, që më lëshoi mu te porta e një shtëpie impesive në rrugën Peshavar. E dërgova një shënim nën emrin tim dhe të babait tim po ashtu, në mënyrë që zonja që po kërkoja të dinte që isha një mikeshë e afërm familjare dhe të përkujtonte më lehtë kush isha.

E ftuar brenda, unë hyra nëpërmjet një porteje të lartë në mur, duke ndier që kjo ishte një hap i duhur për një përfundim të mirë.

## 11. E zënë në grackë

Qëndroja në dhomën atraktive të zonjës që kisha ardhur ta takoja, duke e vështruar aq shumë sa mundesha. Ajo ishte një grua me pamje të dalluar, më e gjatë se unë, me fytyrë të ndritshme dhe flokë të shkurtër. Ajo mbante një këmishë kameze dhe pulovër me një shall të qendisur përreth krahëve të saj.

Ajo më buzëqeshi me një ndjenjë dashurie. 'Sa mirë nga ti që më viziton. Nuk e di nëse jemi takuar më parë? Burri im nuk është për momentin këtu. Ai është në Islamabad deri sonte dhe është një njeri shumë i zënë.'

I tregova që kisha dëgjuar për burrin e saj që ishte një njeri shumë i rëndësishëm. Zonja e uli kokën në shenjë mirësjelljeje dhe kërkoi të na shërbehej çaj. Ndërsa e pinim çajin, me filxhanet kineze më të mira të mundshme, ajo vazhdonte të mbante një rrjedhë të mahnitshme të një bisede shumë të sjellshme, duke më pyetur për shëndetin tim dhe se si kisha udhëtuar nga Guxherati. Ajo qe shumë e kujdesshme të dëgjonte për Anisën. Nuk doja të hyja në detaje meqë ndieja që nuk donte që shërbëtoret e saja të dëgjonin ç'flisnim ne.

Pasi e përfunduam çajin ajo më ftoi ta ndiqja atë. Ajo më udhëhoqi në dhomën e saj të fjetjes, e mbylli derën dhe më kërkoi të ulem, pastaj vazhdoi të m'i bënte pyetjet të cilat kishin ngelur në ajër, të pabiseduara mes nesh:

'Përse ke ardhur e pambuluar? Dhe përse e vetme? Në familjen tënde vajzat nuk dalin në këtë mënyrë. Ç'ka ndodhur me ty? Ke ndonjë problem?'

Unë e kisha të veshur një pallto të bardhë me xhakëtë kameze dhe mbaja një shall përreth kokës sime. Prej shumë kohës tani e kisha lënë anash mbulojën. Sidoqoftë, nuk doja të argumentoja lidhur me këtë tani.

Thashë: me siguri je e befasuar të më shohësh të pambuluar. Por a nuk të befason të më shohësh duke ecur? Ju e dini që isha e gjymtë dhe e sëmurë në shtrat për 19 vjet?'

E di këtë. Mirëpo tani më trego, cili doktor të ka shëruar kaq mirë?

'Do të ta tregoj doktorin tim' ia lexova tregimin e të paralizuarit që bartej nga katër persona dhe i cili që ngritur nga Jezusi tek Marku 2:9-11, pastaj ia dhashë asaj një Bibël në urdu që ta shikonte vet.

Ajo e mori librin sikur të ishte një gjarpër, e shikoi për një moment dhe më pas ma ktheu prapa. Ky libër ju takon të krishterëve - tha ajo me një shenjë neverie.

Po ashtu është dhe unë jam po ashtu e krishterë - iu përgjigja.

Ajo e kapi krahun e karriges. 'Ç'jam duke dëguar?'

Kjo është e vërtetë. Unë i takoj tani personit që më ka shëruar.

'Çfarë saktësisht je duke thënë me këtë?' Andaj i tregova tregimin tim, duke mos i përmendur ca emra të krishterë.

Mikpritësja ime po përpiquej të përmbante vetvetën. Ajo u ngrit nga karriga dhe bëri ca hapa të shpejtë rreth dhomës, duke ardhur pastaj të qëndronte përballë meje sërish, dhe duke anuar para e fiksoi shikimin e saj në mua me një shqetësim të madh:

Por pastaj - tha ajo - nëse Jezusi të paska shëruar, a është e domosdoshme për t'u bërë e krishterë?

Në rastin tim, po. Unë e kam gjetur një jetë të re dhe tani i takoj një personi që më ka dhënë këtë jetë të re. Kjo është arsyeja që jam përjashtuar nga shtëpia. Ndonëse nuk kam ardhur këtu për ta diskutuar fenë me ty. Kam ardhur këtu nëse do të mund të më gjeje ndonjë punë në njërin nga institucionet tua të grave. Mund ta bësh këtë? Një punë e thjeshtë do t'ishte mirë. Nuk jam duke pritur diçka që paguhet shumë.

Mbretëroi një qetësi e shkurtër, ndërsa i shikonte figurat e qilimit të shtrenjtë. 'Tani e kuptoj. E di çfarë unë në të vërtetë mendoja, se mos të ka kidnapuar ndonjë nga shtëpia jote dhe e ke gjetur këtë vend këtu për ndihmë.'

Ajo qeshi e trishtuar. 'Mirë. Sonte mund të rrih këtu me mua dhe pastaj nesër do të rregulloj diçka për ty.'

Ajo më dha dhomën dhe qesh e servuar me darkë nga një prej shërbëtoreve të saja. E thashë një lutje të shkurtër dhe shkova në shtrat, e lodhur por e qetësuar. Lidhjet familjare edhe në distancë qenë, pas të gjithave, më të fuqishme seç kisha menduar.

Ditën e nesërme pas mëngjesit, të cilën e bëra vetë në dhomën e qëndrimit, e takova burrin e saj. Ai e mori ofensivën menjëherë duke më pyetur në mënyrë xhentile, për të mohuar krishterimin. Natyrisht



unë e hodha poshtë kërkesën e tij, po ashtu në mënyrë xhentile. Unë po dridhesha në brendësi sepse pranë e kisha një njeri të fuqishëm në qeveri. Do të ishte e lehtë për të të më largonte si një mizë të mërzitshme, megjithëse që një mik i ngushtë familjar.

Ai tha: 'Mendo rreth kësaj ç'po flet. Ka ende kohë për ty të përqafosh islamin sërish, dhe unë kam për të të ndihmuar të pajtohesh me familjen tënde.' A ishte kjo si një lloj kërcnimi?! I qetësova nervat. Tani kisha një rast që nuk guxonte të humbej.

'Ju falemnderit por jo' - i thashë. 'Nuk u fjalosa me ta. Unë jam në paqe me të gjithë. Ai në të cilin unë besoj është Princi i Paqes dhe ai mund t'ju japë paqe edhe juve po ashtu.' Fjalët më dolën nga goja para se të dija që i kisha thënë.

'Përse nuk e lëshon krishterimin?' më tha ai, duke humbur pak nga durimi i tij i ngrirë. 'Nëse nuk do të jetosh me vëllain apo motrën mund të rrish këtu tek unë tërë jetën tënde.'

Qe oferta më e bukur dhe pa dyshim e thënë sinqerisht.

'Ju falemnderit, por krishterimi im nuk është vetëm një religjion, të cilin njeriu mund ta braktisë kurdo që njeriu të ketë dëshirë, ka të bëjë me një ndryshim jete. Po që se do braktisja jetën time në Krishtin me siguri do të vdisja.'

Pastaj vazhdova - shih nëse mund të më gjeni ndonjë punë për mua dhe nuk kam për t'ju mërzitur më.

Për një moment qëndroi si një statujë e pastaj u largua. 'Oh po, ne do përpiqemi të gjejmë diçka për ty.' I bëri me sy gruas së tij ndërsa po largohej nga dera.

E dëgjova zërin e saj duke i thënë shoferit ta bënte veturën gati. 'Eja,' tha ajo dhe ne hipëm në veturë për t'u drejtuar ka qyteti. Autoja u ndal jashtë një porteje të madhe të hekurt, e vendosur në mure të larta. Lart mund të shihja majën e një ndërtese të madhe nga çimentoja. Një shenjë shfaqte që ishte Burgu Qendror në Ravalpindi. Siç dukej këtu ishte vendi ku do të punoja.

Shoferi e ftoi rojën dhe ai e hapi portën. Mikesha im më futi brenda në zyrën e mbikqyrësit dhe ajo bisedonte me të për disa momente në anglisht gjë që ishte shumë e qartë për mua. Mbikqyrësi pastaj i ra zilës dhe një grua në moshë u shfaq, me zhurmën e një grumbulli çelsash. Mbikqyrësi tha diç që unë nuk mund ta dëgjoja dhe bëri me kokë në drejtimin tim dhe gruaja më tha menjëherë - eja.

Mikesha ime e këndshme tha: shko me këtë zonjë. Ky vend do të jetë më i mirë për ty.

E falëndërova atë ngrohtësisht dhe ndiqja gruan andej ka shkonte. Një derë nga shtyllëzat që e hapur dhe gruaja më tregoi dhomën e gjatë, si një hallë me tavane të larta dhe pa dritare. Drita që ekzistonte aty vinte vetëm nga dera e cila ishte me hapësira, e vendosur në një nga muret. Aty që një tjetër derë e fortë në murin e kundërt. Rreth dhjetë gra qenë të shtrira në copëzat e ndyera të fletëve të pambukta të palmës, që rrinin përballë njëra tjetrës me qëndrime të një indiference të ngrysur. E dëgjova derën të mbyllej prapa meje dhe çelësi hyri në dryrin e derës, dhe unë e pandihmë shikova në gruan më të afërt që e kisha.

‘Ç’po ndodh tani. Cila është puna që kam për të bërë?’

‘Punë? Nuk ka punë këtu. Ti je në burg sikurse ne. Ç’ke bërë ti që të jesh këtu?’

M’u nevojiten një apo dy minuta që vija në vete. Kjo e ashtuquajtura mikeshë familjare më paska sjellur në burg për shkak të të qenurit e krishterë! Unë qesh e mashtruar dhe e zënë në grackë. Vrapova për te dera duke e goditur derën. Asnjë nuk erdhi. Bërtita. Asnjë nuk u përgjigj veçse gruas së re që kishte folur më parë.

‘Mund të bërtasësh sa të duash – nuk kanë për të të liruar.’

Iu ktheva asaj: Ç’është ky vendi këtu?

‘Si nuk është e qartë për ty, e mjera ti. Ky është një paraburgim, ku të mbajnë deri në gjykim përveç nëse e ke dikë që do ta paguante kaucionin.’ E tëra që shprehur me terme më të ashpra seç duhej.

U përpoqa të qetësohesha dhe të mendoj. Sa gjatë do të mbahesha këtu? Me ç’krim do t’me akuzonin? Edhe të qenurit e krishterë qenka krim? Me siguri me anë të kushtetutës të jesh pjesë e një minoriteti nuk do të ishte krim. Megjithkëtë, me anë të ligjit islamik, unë isha fajtores për ofendimin më të madh, sikurse që isha bërë si e paprekur nga familja ime.

Ky mendim më përkujtoi premtimin që Anisa e kishte bërë ndaj meje. Pastaj sytë e mi u kthyen drejt çantës sime. Me pak mëshirë që kishin çanta ime kishte ngelur e paprekur. Dhe Bibla ime ishte aty me ca rroba të pastra – pasuri që nuk krahasohej në atë vend.

Shikoja përreth vetes më me kujdes. Ku do të mund të pushoja unë në këtë vend? Dhoma që e madhe rreth 80 hapa në gjatësi, me tre

apo katër dhoma anësore në të cilën gjendeshin ca shtretër me skelet hekuri, të mbuluara me batanie të errëta. Këtu s'kishte fare rrymim të ajrit nga ajri i pastër i netëve të Himalajës që vinte vetëm nga zbrazësirat e portës. Por diçka më thoshte që këtu nuk do të mund të flija. Dhomat qenë shumë të errëta dhe pa ajër, pa asnjë dritare – sikurse varreza. Dhe unë nuk kisha dëshirë të isha e ngrënë nga banorët e këtyre batanieve. Jashtë në të ftohtë, në dyshtemenë e fortë dhe të ndotur gratë tjera e kishin mbështjellur vetën plotësisht në çarçafe dhe qenë të shtrira në copa të ndyera. E mbështjellur me aq rroba sa mundja të veshja unë qëndrova tërë natën, duke shikuar e përgjumur përtej shtyllave të burgut në qiellin e një nate të pastër, me hënën dhe yjet e saja.

Higjiena që një gjë që më shqetësonte vazhdimisht, sikur ishte edhe për gratë tjera. Një erë shumë e pakëndshme shfaqte praninë e një toaleti megjithëse nuk kishte ujë të qarkullueshëm dhe mjete të duhura pastrimi – vetëm një *mutka* apo një kazan me ujë i përbashkët për ne gjatë tërë ditës. Kjo mbushej çdo ditë nga njeri i posaçëm. Ishte një gotë në zingjirë e lidhur me majën e kazanit, dy gota për të pirë me to dhe një kovë për rituale pastrimi. Ndonëse asnjëherë nuk e kisha vënë re ta përdornin për këtë qëllim derisa qesh aty. Lutja ishte një gjë shumë e largët nga mendjet e tyre.

Tri herë brenda ditës rojtari sillte diçka që ngjante në ushqim – bukë e tharë dhe çaj për mëngjes ndërsa për racionet tjera supë të hollë thjerrëze, patate jo të ziera mirë dhe ndonjëherë vezë të pashijshme. E tërë kjo përkujdesje – të cilën unë nuk do ta kisha ushqyer as lypësin në shtëpinë time – bënte që të burgosuret të shkonin aq larg, sa ndonjëherë do të hidhnin çajin mbi rojtarin, do ta mallkonin atë dhe kuzhinierin, si dhe policinë dhe gjykatën dhe njëra- tjetrën me një gjuhë që më bënte t'i mbyll vëshët e mi.

Përtej portës së dukshme ne mund të shihnim në një distancë, brenda intervaleve, anëtarët e familjeve apo miqtë e të burgosurve. Më pas porta do të hapej dhe një apo dy nga gratë do të nxirrej jashtë për një kohë të shkurtër për t'u dërguar në dhomën e vizitorëve, e që ktheheshin me pajisje për ta bërë jetën të durueshme – çarçafe të pastra, ushqim. Së shpejti oriz i ëmbël dhe pilaf dhe copëza të pulës shkonin përreth, porse asnjë nga ana ime.

Askush nuk dëshmonte ndonjë interes në prezencën time, apo ndonjë dëshirë për të më akuzuar me ndonjë akuzë. Megjithëse, siç mësova, kjo nënkuptonte të ishte një burg vetëm i përkohshëm, për ata që prisnin gjykimin. Sa do të mundte njeriu të kalonte këtu deri në gjykim.

E pyeta gruan e vjetër portiere, 'Përse jam këtu?'

'Nuk e di përse. Mbikqyrësi më urdhëroi kështu,' tha gruaja me shumë indiferencë. 'Unë vetëm po zbatoja urdhërimet.'

Në një nga blloqet tjera të burgut nga ana e meshkujve dëgjoheshin bërtimat e njerëzve që rriheshin, dhe atë shumë rreptë. I dëgjova gratë tjera – disa prej të cilave dukej të kishin lidhje me gangsterët nga qyteti – të thoshin se kjo ishte për të nxjerrë nga ta rrëfimet e përshtatshme me qëllim të kishin akuzë të duhur. Unë mësova po ashtu që qe e mundur edhe për gratë të rriheshin – nga gratë – për të njëjtin qëllim. Unë prisja, në hamendje nëse ky do të ishte fati im.

Gjatë javës së parë as që mund të flija mirë në dyshemenë e fortë, e as të haja ushqimin e burgut. Një nuhatje në supë më bëri të humbisja tërë apetitin që kisha. Nuk më pëlqente ndytësira, apo morrat, erërat, apo në fillim edhe shoqëria. Edhe pse e hedhur në valët e dyshimit, dallgëzat e frikës, unë do të lexoja ca pjesë nga Bibla ime e çmuar – dhe kuptoja që bota gradualisht do të vinte në rregull dhe një paqe filloi të rridhte si një lum. Lexova lidhur me Pjetrin dhe Gjonin në burg tek Veprat 12:6-8. Mu bë e njohur që ishte një shok për ta sikurse për mua të trajtoheshin si kriminelët e përditshëm. Porse ata ishin falënderues dhe këndonin lavdërime. Apostulli Pal po ashtu thoshte: 'Jeni falënderues në çdo gjë.' Mirë atëherë, unë do të falënderoj Perëndinë pasi kisha mundësinë të dëshmoja për Perëndinë në rrethana të njëjta.

Së pari, ndërsa e përdorja përtacinë e sforcuar për të medituar mbi fjalën e Perëndisë, u përpoqa ta izoloj vetën time nga shoqet e burgut. Shumë prej tyre, ishte e qartë, qenë kriminele që e parapëlqenin të keqen, pjesë e bandave dhe plehra të qytetit të madh, thyes të dyqaneve, vjedhës të xhepave, kidnapues dhe një vrasëse nga provinca kufizuese veriperëndimore, e cila kishte mbytur burrin e saj. Oh kjo krenari! Ky burg shërbente si një shërim i përsosur për të.

Qetësia ime e zgjatur, ndërsa e përkushtoja vetën time ndaj librit tim vetëm sa e zmadhonte respektin dhe kureshtjen e tyre për mua. Unë qesh një enigmë e cila do ta zbulonte vetën gradualisht.

‘Ç’je duke lexuar kështu me kaq interes?’ U përqendrova tek ajo që po fliste, një grua e re me fytyrë të prishur në të cilën qenë të shkrura të gjitha llojet e së keqes. ‘Ti ke qenë duke e lexuar atë libër me ditë të tëra duke mos e përqendruar vëmendjen në ne fare. Duhet të jetë i mirë. Për çfarë flitet?’

‘Do me të vërtetë të dish çfarë ka në këtë libër?’

Po. Çdo gjë vetëm për ta kaluar kohën në këtë gropë-ferri - thoshte gruaja - emri i së cilës ishte Kalsum. Gratë tjera ndërprejnë pëshpëritjet për të dëgjuar bisedën tonë.

Ashtu që fillova të flisja me këtë grua në lidhje me të. E ngrita librin. ‘Kjo është një pasqyrë.’

‘Si është një pasqyrë? Unë mendoj se është një libër’ – një grua tjetër, të cilën njihja si Katon, vështronte përreth për të fituar përkrahje për këtë ide.

‘Po është një libër që në të vërtetë është si një pasqyrë, sepse pikërisht këtu ne e shohim vetën tonë në raport me Perëndinë, e ai është gjykatësi i të gjithë njerëzve.

‘Anët jo të mira,’ thoshte njëra nga gratë me një qeshje të madhe.

Ti ke të drejtë - i thashë. ‘Kjo pasqyrë na i shfaq gjërat që i bëjmë dhe i quan ‘mëkat’. Mëkatet tona nuk janë të mira në sytë e njeriut e as në sytë e Perëndisë. Njeriu i gjykon mëkatet tona dhe ka për të na dënuar për atë ç’kemi bërë. Porse Perëndia është i shenjtë dhe ai duhet të na gjykojë edhe më shumë për shkak të mëkatit tonë. Mëkati nuk e kënaq Perëndinë. Ajo e ofendon atë. Ai duhet ta dënojë mëkatin me vdekje.’

E kisha vëmendjen e plotë të këtyre grave të mjera, të cilat e prisnin gjykimin e tyre. Vazhdova më tutje: ju mund të mendoni, atëherë nuk ka shpëtim për ne. Ne duhet ta vuajmë dënimin tonë. Por pasqyra na tregon që Perëndia ka dy mënyra të konsiderimit të mëkatit tonë. Njëra mënyrë çon në vdekje, tjetra në jetë dhe ne mund të zgjedhim cilën do të marrim.

Një qetësi me nervozizëm mbretëroi për ca çaste, e thyer nga Kalsumi e cila bëri një pyetje, ‘Si do ta bëjë pasqyrja tërë këtë?’

‘Na tregon që Perëndia vetvetiu ka siguruar mënyrën e faljes së mëkateve. Ai na quan neve mëkatarë për të ardhur tek ai me qëllim që mëkatet tona të falen. Ky libër thotë “Ejani ju të gjithë të rënduar dhe të munduar dhe unë do t’ju jap ç’lodhje. (Mateu 11:27-30).’

Qesh e befasuar nga reagimi i tyre ndaj kësaj. Ata e ndiqnin argumentin për së afërmi. Një grua tha: nuk mund ta mohojmë që nuk jemi të rënduar me mëkatet tona. Për këtë arsye jemi këtu. Askush nuk mund të mënjanojë atë ç’kemi bërë ne.

Ia sqarova asaj doktrinën e faljes e përshkruar te Gjoni 1:8-9: ‘Po t’i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na i falë mëkatet tona dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.’

Disa prej tyre qenë shumë të prekur nga kjo. Lotët rridhnin nga sytë e tyre. Më kërkuan t’i mësoj më shumë. Andaj edhe vendosëm që çdo mëngjes do të bëja një studim Bible me një grup prej tyre.

Brenda një kohe të shkurtër fillova të vijja re një ndryshim në ta, që shndërriste nëpër velin e ndyer. Ato filluan të ndanin me mua pulën dhe pilafin e tyre, po ashtu edhe çarçafet e pastra që mbështillja vetën time gjatë gjumit. Rezultati më i mirë ishte që shtatë prej tyre rrëfyan mëkatet te Perëndia dhe pranuan fajin e tyre të cilin e mohonin para autoriteteve, duke e përfshirë edhe vrasësen nga provinca veriperëndimore dhe dy vjedhëset. Ato më siguruan që asnjëherë më nuk do t’i përsërisnin krimet e njëjta. ‘Kjo është puna për të cilën ke ardhur këtu’ i thashë vetës, derisa muaji përvidhej në mënyrën e tij të mërzitshëm.

Tri nga gratë qenë marrë për gjykim dhe ato shkuan me lotë në sy sepse po më linin. Por më pas edhe unë qesh thirrur. Dera e burgut u hap një ditë dhe më çuan në dhomën e mbikqyrësit, ku edhe e gjeta Anisën e tmerruar me mikeshën së cilës i kisha besuar – që dukej aq e pashqetësuar sa s’kishte mundësi.

Anisa u hodh në mua dhe më përqafoi, ashtu e ndotur siç isha. Pastaj iu kthye gruas së vjetër dhe filloi ta merrte në pyetje:

‘Ç’ka bërë motra ime të jetë kështu e hedhur në burg. E ka mbytur dikë ajo?’

Motra jote është bërë e krishterë. Ajo e ka mohuar islamin.’ Kjo, siç nënkuptonte nga zëri, qe një mëkat më i madh se vrasja.

‘Ky ishte besimi i saj personal. Ajo e ka gjetur të vërtetën dhe nuk ka frikë të dëshmojë për këtë, dhe ti nuk mund ta vësh një person në burg për këtë, përderisa nuk ka më shumë ligje në Pakistan.’

Mikesha jonë nuk kishte çfarë të thoshte ndaj kësaj. Ajo lëvizi krahët e saj. ‘Mirë, nëse do ta marrësh në shtëpi mund ta marrësh.’

Anisa u kthye kah unë. Gulshan duhet të vish tani me mua në shtëpi. Nuk u kënaqa me këtë. ‘Përse duhet të vij në shtëpinë tënde. Burgu është më i mirë se shtëpia jote.’

Ajo ndiehej e lënduar. ‘Pse e thua këtë?’

‘Meqë burri yt është ofendues i Jezusit dhe i kryqit të tij, unë nuk dua ta dëgjoj më. Këtu në burg gratë kanë qenë duke më dëgjuar dhe e kanë rrëfyer Jezusin dhe unë mund të bëj një punë të dobishme.’

Motra më përqafoi me lot në sytë e saj. ‘Ti e do Jezusin aq shumë.’

‘Do ta jepja jetën për Jezusin,’ Ishte e vërtetë që ç’do gjë që kishte ndodhur qe për të më forcuar në besim. Kam qenë duke kaluar në tunelet e errëta të dëshpërimit, por mu në errësirë ndriçonte një dritë.

Anisa thoshte, ‘Edhe unë e dua Jezusin. Dua të mësoj më shumë për të nga ti.’

Më pas më tregoi ç’kishte ndodhur me burrin e saj.

Me sa duket kur e kisha lëshuar shtëpinë e tij, mu në të njëjtën ditë ai kishte përjetuar një aksident dhe si rezultat gjendej në spital gati një muaj. Ajo nuk kishte patur mundësi për të më kontaktuar më herët, meqë detyra e parë e saj ishte e lidhur me burrin e saj.

Ajo vazhdoi: ‘Ai nuk ka për të bërë asgjë kundër teje. Ai më ka dhënë leje të të marrë në shtëpi.

Sa shpejt gjërat marrin kahe tjetër. Për një moment unë po jetoja me plehun e një shoqërie femërore në burg – duke gjetur ëmbëlsi në mesin e tyre. Vetëm për një orë apo më tepër unë isha duke u zhytur në vaskën e motrës sime në shtëpinë e saj të mirë në qytetin satelitor, Ravalpindi, dhe shërbëtoret që prisnin çdo komandë time – duke u hamendur sa do të zgjaste kësaj rradhe para se t’me jepeshin urdhërimet e marshimit për shkak të pamundësisë sime të rri e qetë në lidhje me besimin tim.

## 12. Tunduesi

Tani mendoj që qëndrimi im në Pindi me motrën dhe dhëndrin tim që një nga periudhat më të mira të jetës sime që kur u bëra e krishterë. Anisa bënte çdo gjë për mua – dhe burri i saj ishte i këndshëm, në mënyrë të përlur. Sërish isha pjesë e familjes sime, gjë që trajtohesha me dashuri dhe konsideratë.

Në shtëpi ishin ca shërbëtorë – dy apo tre gra shërbëtoresh, një për punë teknike, një kuzhinier dhe një shofer. Biri i kuzhinierit punonte në kopsht. Ndërsa më nuk më kërkoheshin t'i rregulloja dhe pastroja tavolinat. Por shërbesa që më kërkoheshin ishte t'i argëtoja vajzat e vogla dhe e bëja këtë për Anisën që shumë kohë më parë ajo e bënte për mua – u thoja tregime. Ishte një rol i kënaqshëm.

Në të njëjtën kohë fillova t'i vështroja shërbëtoresh me një interes të veçantë, e vetëdijshme për të gjitha punët e shtëpisë që duheshin bërë – të gjitha larjet e enëve, dyshemetë, rrobat, të gjitha pastrimet, larjet, shkëlqimet, heqjen e pluhurit, të gjitha mbledhjet, rregullimet, mënjanimet. Fillova të isha falënderuese për shërbesën e njerëzve me një buzëqeshje. Nuk kushtonte asgjë dhe vetëm shkaktonte lumturi.

Ne u afrum shumë pranë së bashku, unë dhe motra ime, motra në Krishtin tani. Shpenzonim nga dy apo tre orë në ditë në të studiuarit e Biblës. Shumë shpejt Anisa e kuptoi një fakt themelor: se ishte e mundur të lidheshe me Biblën në një mënyrë jo të mundshme për Kuranin. Njeriu mund ta lexonte si një libër të zakonshëm, duke i njohtur nga një pikëvështrim tjetër ca nga gjarjet që qenë të përbashkëta për myslimanët dhe historinë hebreje, ndonëse kishte më tepër këtu, një autoritet i pagabuar i së vërtetës.

Ajo thoshte: 'Sa fjalë të këndshme që janë këto. Ato të sjellin ngushëllim.' Ajo e kishte në mendje fëmijën e saj të humbur.

Thashë: është e gjallë. Këto janë fjalët nga Ati ynë qiellor. Për ç'do gjë që ndjen i ke fjalët përkatëse këtu, e pikëlluar apo e lumtur. Gjëja kryesore është për të kuptuar se mëkatet tua janë falur, dhe për të ecur me Jezusin ditë për ditë.

Ajo tha: E ndiej që ai është këtu me ne, ndërsa ne jemi duke biseduar për të.

E drejtova tek vargu "kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin tim, unë jam në mes tyre". (Mateu 18:20).



‘Kur ne lutemi Ai është çdo herë dëgjon. Ne e kemi mësuesin me vete. Ne kuptojmë duke qenë se Fryma e tij i Shenjtë na udhëheq’.

Bland Shahu nuk qe dhe aq i lumtur për interesin e ri të gruas së tij. ‘Mos i trego çdo kujt që je ngritur nga të vdekurit nëpërmjet Krishtit. Mbaje në qetësi - i kishte thënë ai. Porse nuk mendoj që ajo e vinte re këtë.

Për shkakun e saj nuk u tregoja të gjithëve se isha e krishterë, megjithëse nëse do isha e pyetur në mënyrë të drejtpërdrejtë do u thoja në lidhje me vegimin dhe shërimin tim – që zakonisht do i qetësonte ata.

Anisa dhe burri i saj kishin shumë të afërt dhe miq, dhe çdo ditë takoja vizitorët e saj në shtëpinë e këndshme që kishin. Traditat shumë strikte të një shtëpie shiite kërkonin që, ç’do gjë ndodhte në pjesët tjera të botës muslimane, këtu divizionet fundamentale të gjinisë ngeleshin. Vizitorët meshkuj dhe gra edhe nëse do vinin së bashku, do rrinin të seksione të ndara të shtëpisë apo në dhoma të ndara. Kishte momente kur unë si e krishterë, ndihesha e padurueshme me këto ndarje të njerëzve, në veçanti pasi e dija në shoqërinë ku Krishti ka sjellur njerëzit e tij së bashku jeta do mund të vazhdonte shumë mirë pa to. Porse në Pakistan, një shtet i themeluar nga idetë islamike, çdo pjesë e jetës sonë sociale do të mund të matej kundër mësimeve të Kuranit dhe interpretimeve të shkrimeve nga tradita. Tensionet e situatave kundër jetës qytetare, me sofistikimin e tij të madh qenë më të qarta për mua seç ishin në Xhang, e cila qe një vend rural dhe më prapa në këto çështje. Një pjesë e imja gjykonte, ndërsa pjesa tjetër kënaqej me mënyrën e vjetër të përjetimit të shoqërisë femërore dhe bisedave feminine, të papenguar nga prezenca e ndonjë mashkulli.

Sa lehtësuese ishte t’i dëgjoje të gjitha këto detaje të imta lidhur se kush do martohej me kë, cili fëmijë ishte i sëmurë e cili mirë, ç’po mësonin në shkollë, ç’karrierë do ndiqnin. Tani vajzat kishin filluar të edukoheshin, disa edhe shkonin në kolegji, megjithëse të fitonin karrierë të mirë për ta më pas nuk ishte gjë e lehtë dhe jo çdo herë e admiruar.

Vajza mund të ishte një doktoreshë apo mësuese e vajzave, apo një motër medicinale. Qe më vështirë për të shkuar në ndonjë ambient ku do të mund të punonin me meshkuj, si brenda në zyre. Ndonëse

t'i mbaje vajzat e edukuara në shtëpi derisa ato martoheshin po bëhej goxha e vështirë për familjet, me shumë njerëz të rinj që e shtyenin martesën ndërsa studionin për karrierë jashtë vendit. Ekzistonte një kontraditë çdo herë prezente në mes idealeve religjioze dhe botës ashtu siç ishte. Ah po, këto probleme takonin çdo familje edhe sot – ata fajësojnë influencën e jashtme nga perëndimi për shkatërrimin e standardeve, dhe ktheheshin me një lehtësim në vlerësimet e më të lumtura – duke lënë anash ëndërrat e një jetese më të mirë, të ardhmen më të bukur për bijtë dhe bijat e tyre. Dëgjoja, tani shumë më e vetëdijësuar se më parë që këto ëndërta ishin vetëm lule të kalbura, gati për t'u mënjanuar nga një erë e rëndë. Këto tensione nuk do kalonin. Atëherë nuk e kuptonim si loja zhonglere e logjikës së jetës kundër asaj religjioze e përseritur çdo ditë, do të çonte në një eksplozim.

Anisa i vendosi mendimet e mia në fjalët e saj: Ata janë të shqetësuar për fëmijët, por ku janë duke shkuar jetët e tyre?

Kotshmëria e jetës së religjionit pa Krishtin e dërrmonte atë ndonjëherë.

Përvoja e të qëndruarit në të dy anët e perdes purda më bënte të kuptoj sa e fuqishme dhe e sigurt që ishte themeli që kisha për jetën time. Lumturia ime tani nuk varej nga të përmbushurit e ambicieve të mia – qëndronte në bërjen e vullnetit të Perëndisë. Dhe kështu asnjëherë për ndonjë moment nuk e kisha lejuar vetën time të paramendoja që kjo periudhë paqeje të zgjaste përjetë. Dhe me të vertetë ishte ashtu.

Në nëntor mësova që dhëndri im do të lëvizte për një kohë nga Ravalpindi për në Lahore, për interesa të biznesit të tij.

Ne të gjithë duhet të shkojmë po ashtu tha Anisa. 'Dhe kemi për të qëndruar te Alim Shahu.'

Isha shumë në ankth ndaj këtij lajmi.

'Më vjen shumë keq por nuk mund të vij me ju në Lahore. Vëllai ynë Alim Shahu më kishte thënë që dyert e tij do ishin të mbyllura për mua që kur u bëra e krishterë.'

Fytyra e motrës sime u deh si e një fëmije kur qante. 'Kam nevojë për lutjet e tua dhe ndihmën tënde. Nëse Alim Shahu nuk ka për të të lejuar brenda unë do të marrë me qira një shtëpi tjetër dhe do të vijë me ty.'

'Dhe ç'do bëj burri i yt pastaj – mendoj se do të të divorconte pas kësaj.' E përqafova atë dhe u pajtova të shkoj me ta. Do të shikonim si vëllai ynë do të priste mbërritjen time.

Në këtë mënyrë me 28 nëntor u bëmë gati të niseshim me makinë në orën 4 të mbrëmjes dhe plaçkat tona i vumë në kamion.

'Më vjen shumë mirë t'ju shoh. Jeni shumë të mirëpritur në shtëpinë time.'

Qe vëllai im që po fliste. Nuk mundja t'u besoja veshëve të mi. Ishte sikur ajo bisedë e hidhur në telefon të mos kishte ndodhur fare.

Familja u vendos përkohësisht me Alim Shahun derisa do të gjenin një shtëpi. Unë qesh e akomoduar në një dhomë të këndshme fjetjeje dhe një shërbëtoreshë me rrinte pranë.

E di që i keni miqtë e juaj këtu - thoshte vëllai im shumë papritur. I kam thënë shoferit tim për t'ju çuar kudo që të doni.

E falënderova ngrohtësisht, por brenda kësaj qe një ndjenjë alarmimi. Qe tepër mirë për të qenë e vërtetë.

Kur e diela erdhi, unë i kërkova shoferit të më çonte në rrugën Varis në kishën metodiste. Pastori më mori dorën time tek dera dhe njerëzit më përshëndetnin me shumë kënaqësi, ndonëse njëri më pyeti 'si je? Ku ke qenë deri tani? Ke nevojë për diçka?' Unë në fakt nuk u thashë gjë lidhur me vështirësitë e mia, duke qenë se i besoja Perëndisë për t'i zgjidhur ato.

Katër muaj më vonë, ndërsa po lutesha një mbrëmje maji në dhomën time, e ulur në karrigë me Bibël të hapur në gjunjët e mia. I dëgjova kërcitjet e këmbëve dhe hapa sytë. Ja aty po rrinte Alim Shahu përballë meje duke më shikuar, me një buzëqeshje në fytyrën e tij. Ngela e palëvizur dhe për disa arsye isha duke menduar për tigrat.

'Uroj të jesh e lumtur në shtëpinë time' tha ai me zërin më të këndshëm të mundur. 'Shpresoj të kalosh mirë me gruan time dhe të jesh e lumtur me fëmijët e mi. Shpresoj shërbëtorët të të mos shkaktojnë ndonjë vështirësi.'

'Jam shumë e lumtur këtu,' thashë, duke e menduar sinqerisht.

'Ne të duam shumë dhe do donim të rrije me ne për të mirë. Në fakt kam qenë duke menduar të ndërtohet një shtëpi për ty në Gulberg.' (Kjo ishte një rrethinë e bukur, moderne për njerëz të pasur, pesë apo gjashtë milja tutje).

Ai vazhdoi, 'Dhe do doja të vije me mua për pushime. Muajin tjetër kam për të vizituar vendet islamike... Mekën, Medinën. Do të kishe dëshirë të vije me mua?'

Ai qe duke më tunduar. Mendova për pak për: 'Unë do të t'i jap të gjitha këto, nëse ...' (Mateu 4:8-9).

Nuk përtoj të vij me ty - i thashë - megjithëse nuk ka për të bërë ndonjë dallim përsa i përket besimit tim.

Si të mos kisha folur fare ai e mori Biblën nga prehëri im dhe u ndal për të shikuar në faqet e hapura duke i menduar gjërat. 'E tëra që kërkoj nga ty për të t'i dhënë ato është mu ky libër. Ma jep Biblën dhe unë do ta çoj prapa në depot e shoqërisë biblike që të mos e lexosh më. Dhe fillo të mos shkosh më në kishë dhe unë kam për të të dhënë çdo gjë që të duash.'

Thashë me zë të lartë: Psalmi 119:105 "Fjala jote është një llampë në këmbën time dhe një dritë në shtegun tim". Kjo është fjala e Perëndisë dhe më flet për dallimet në mes të duhurës dhe të gabuarës. Nuk mund të ta japi ... kjo është pjesë e jetës sime.'

Mund të shihja që filloi të zemërohej. Menjëherë vazhdova: 'Nuk mund ta ndaloj të shkuarit në kishë, sepse ajo është shtëpia e Perëndisë. Nusja duhet bërë gati sepse dhëndri është duke ardhur. "Dhe cilido që më mohon para njerëzve edhe unë do ta mohoj para Atit tim në qiell.'" (Mateu 10:3).'

Ai kërceu lart. E hodhi Biblën në mua. 'Para se të dalë dielli ta lëshosh shtëpinë time, nuk dua të të shoh sërish këtu.'

Kurtha qe bërë gati. Kishte susta, porse ishte e zbrazët. Viktima kishte ikur.

Asnjë tjetër nuk më erdhi pranë atë natë. U shtriva për të fjetur me një zemër të rënduar. Të nesërmen gati të gjithë e kishin kuptuar. Nusja ime nuk e hapi gojën fare me mua. Vëllai im nuk shihej aspak. Asnjë fjalë nuk dilte as nga Anisa dhe burri i saj. Shërbëtorët vetëm që e kishin lënë mëngjesin dhe kishin dalur menjëherë jashtë.

E pikëlluar e paketova çantën time dhe katër apo pesë veshje të përgatitura për mua nga Anisa. I lashë rrobat e cilësisë së lartë që m'i kishte dhënë Alim Shahu, meqë ai kishte thënë: të mos marrësh asnjë gjë nga kjo shtëpi.

Valixhja ime qe në korridor dhe unë po shkoja në drejtim të saj, kur ja Safdar Shahu po vinte. Nuk e kisha parë që kur e kisha lënë

Xhangun, porse fjalët e një mirënjohjeje të lumtur vdiqën në buzët e mia ndërsa po e shihja ç'kishte në dorë. Qe një revole.

Më kapi me dorën e tij dhe më tërhoqi poshtë kah bodrumi i shtëpisë. 'Rri atje dhe mos lëviz!' më urdhëroi ai. U binda. Safdar Shahu mundte, kur ngacmohej, të ishte mizor. Shkoj që ta thërrishte Alim Shahun. Një qetësi e vdekjes mbretëronte në shtëpi, një erë frikeje.

Vëllezërit e mi erdhën poshtë me fytyra të ashpra dhe u ulën. Zemra më rrihte ndërsa këmbët më dukeshin si një kashtë, megjithëse qëndrova e ulur në karrigë, duke tentuar të isha e qetë.

Vëllezërit rrinin përballë meje, në anën tjetër të tavolinës. Përpiqesha të shikoj në fytyrat e tyre të mbushur me urrejtje, por ata po shikonin brenda sikur të mos ishin të vetëdijshëm për vështrimin tim. Safdar Shahu ia kaloi revolen Alim Shahut:

'Përfundoje këtë mallkim në familjen tonë! - kërcëllinte ai.

Alim Shahu e kapu dorëzën e revoles dy-cilindrëshe dhe ngadalë e sollti përreth për ta drejtuar në kokën time.

Ai fliste me një dëshpërim të thellë:

'Përse do që të vdesësh? E tëra që duhet të bësh është të mos vazhdosh ta pranosh Jezusin si Bir të Perëndisë dhe që nuk do të shkosh më në kishë. Atëherë jeta jote ka për t'u kursyer sepse unë nuk do të gjuaj.' Fytyra e tij dukej e varur dhe e dërrmuar nën dritën e poçit dhe pashë në ç'zor që ishte – duke e luftuar dashurinë për mua për të cilën qe mësuar nga babai.

Kjo qe edhe për mua një moment i tmerrshëm. Unë isha mësuar t'i trajtoja vëllezërit e mi me respektin më të madh si çdo vajzë myslimane.

Kurrë nuk i kisha kundërshtuar përderisa Jezusi erdhi në jetën time dhe jam përpjekur që kurrë të mos flas brutalisht me ta, duke ditur që mund të varesha në dashurinë dhe vlerësimin e tyre, dhe mbrotjen e tyre, nëse kjo do ishte ndonjëherë e nevojshme. Në këtë rast poashtu, babai im u kishte dhënë atyre një detyrë serioze të përkujdeseshin për mua, porse ai nuk ishte pjesëmarrës i një krize si kjo asnjëherë. Unë po i shqyeja ata për gjysmë nëpërmjet konfliktit të dashurisë dhe detyrës.

Por unë duhesha të shkoja para. Nuk mundja të kthehesha prapa, jo tani.

‘Mund të më siguronit që nëse nuk më gjuan tani nuk do të vdes?  
Është e shkruar në Kuran që kur një njeri është lindur njëherë ai ka  
për të vdekur. Prandaj, vazhdo para, gjuaj. Nuk më pengon të vdes  
në emrin e Krishtit. Në Biblën time thuhet: Ai që beson në mua,  
edhe sikur duhej të vdesë do të jetojë (Gjoni 11:25).

Arma u lëkund dhe ra poshtë.

Safdar Shahu fliste në qetësi. ‘Nuk ke nevojë ta mbysësh këtë të  
krishtere dhe të fajësohesh për këtë. Ajo tanimë është mallkim për  
ne. Hidhe jashtë.’

Ata më shtyen para tyre për t’u ngjitur shkallëve lart. E mora  
valixhen time në korridor dhe dola jashtë derës. Vëllezërit u kthyen  
të mërzitur në shtëpi.

‘Asnjë armë e sajuar kundër teje nuk do të ketë sukses’. E dija ku e  
kisha lexuar këtë, (Isaija 54:17) porse nuk e dija ishte kaq saktësisht e  
realizuar.

## 13. Qiriu

Ku mund të shkoj, o Atë?' – derisa qëndroja vetëm anash rrugës Samanabad, në përpjekje për të tërhequr prapa lotët nga shoku dhe dhimbja nga kjo skenë që sapo kisha përjetuar, dhe duke shikuar poshtë dhe lart pa ndonjë arsye rreth asaj ç'të bëj më tutje. Por përgjatë kësaj rruge në formë piste trafiku që i zbrazët, dhe një linjë e konsiderueshme e shtëpive që qëndronin prapa mureve të gjata nën shkëlqimin e mëngjesit, nuk zbulonin asgjë të zhvillohej nga jeta përparimtare. Tanimë pa menduar fare u ktheva në të djathtë dhe fillova të ecja në shtegun e cementuar të këmbësorëve për një milja larg, ku qëndronte autobusi. Ndërsa mbërrita atje unë tashmë e kisha në mendje – Gjon dhe Bimla Emanuel do t'më ofronin strehim.

Gjon Emanueli, një kopshtar nga autoritetet e qytetit, jetonte në koloninë Medina së bashku me gruan e tij dhe të katër fëmijët e tyre. Kjo familje ndiqte shërbesat te kisha në rrugën Varis. Ata më patën ftuar një herë a dy dhe mbaj mend të isha kënaqur atje duke biseduar për Zotin, shërimin dhe fuqinë shpëtuese. Ata më patën thënë 'Eja tek ne në ç'kohë të duash; shtëpia jonë është çdo herë e hapur për ty.'

Te stacioni i autobusit kishte një variacion të transportit. Mora një *riksab* për Muzai Çang dhe prej aty një minibus që shkonte për Gurumangat. Nga këtu që një ecje e shkurtër përgjatë vijës hekurudhore për në koloninë Medina.

Zgjedha rrugën e ngushtë, të pluhurosur që kalonte në mes shtëpive duke u mënjanuar rrugëve të hapura që çonin në një pishinë aty pranë. Te shtëpia e Gjon Emanuelit e kapa fundin e dorëzës së metaltë që varej jashtë dhe godita fort në dyert e dyfishta nga druri në muret e larta. Pas një kohë të shkurtër Bimla e hapi derën dhe i nguli sytë befaz në mua, e pastaj më kërkoi të hyja brenda.

I ndava ca fragmente me atë ç'kishte ndodhur me mua duke i kërkuar një strehim të përkoshëm. Ajo pa që po dridhesha dhe hodhi krahët e saj mbi mua: 'Ti je mëse e pritur të qëndrosh me ne dhe ç'do gjë që kemi mund të ndajmë së bashku.'

Kur Gjon Emanueli erdhi në shtëpi me biçikletë në pasditën e vonshme, ai e dëgjoji ndodhinë time me kujdes. 'Mos u shqetëso. Unë jam vëllai yt në Krishtin' - më siguroi. Sa e çuditshme që mund

të ndihem aq afër me njerëz që nuk janë të gjakut tim, mendoja, e ngrohur nga përkujdesi i tij. Dukej që bashkimi i besimtarëve të vërtetë në Krishitën do të mund t'i lidhte ndjekësit e tij njëri me tjetrin me lidhje më të fortë sesa lidhjet e gjakut apo e martesës. Shtëpia e tyre, të cilën e kishin me qera, qe e vogël – me vetëm një dhomë të ndejes me verandë. Në njëërën anë të kësaj verandeje ishte kuzhina dhe një tjetrën toaleti. Pyesja veten ku do të flinin që të gjithë – dukej që do të flija me fëmijët e tyre, më e vjetra e së cilave ishte vajza tetëvjeçare, në verandë. Kjo përmbante ngrohje dhe shndërrohej në dhomë në kohë më të ftohtë. Gjoni dhe Bilma fjetën në kompleks, sikundër ishte zakon të bëhej kur shtëpitë janë të vogla ndërsa familjet e mëdha. Nuk kishte bari e as lule – nuk kishte vend të rritej asgjë. Kompleksi qe rregulluar me argjilë dhe kashtë mbi për ta bërë një sipërfaqe të fortë dhe qe gëlqerosur, ashtu që u bë një vazhdim i shtëpisë. Megjithatë, kishte lule nëpër vazo për ta ndriçuar shtëpinë. Një akomodim i thjeshtë në krahasim me ngushëllimin që kisha lënë prapa meje, porse ishte e mrekullueshme për të patur liri të nxirrja Biblën dhe të lexoja hapur dhe për të pasur kohë lutjeje dhe studimi me Gjonin dhe Bilmën. Unë për këtë qesh përballuar edhe me vdekjen.

Natën e parë, e shtrirë në *çarçaf* me një çarçaf në ajër të hapur, nuk mundja të flija për shkak të mosnjohjes së ambientit, për shkak të mendimeve të mia garuese dhe për shkak të tingujve të natës së bezdisshme. Në atë vend njerëzit shkonin në shtrat herët, për t'u zgjuar në mëngjes herët menjëherë pas daljes së diellit për t'u përgatitur për udhëtim në qytet për punën e tyre. Por ndërsa rrëmuja e jetës së përditshme qe suspenduar dhe zhurmat nga pompat e ujit vdiqën, ra një qetësi e madhe, në të cilën filluan të dëgjohen tinguj të tjerë, origjinën e të cilëve duhesha hulumtuar.

Kishte kërcitje dhe kacafytje të mive. Prapa shtëpisë drenazha e dobët kishte krijuar pellgje të ujit, në të cilat familjet e lumtura të bretkocave argëtoheshin dhe insektet që dëgjoheshin nga kaçubet. Nuk kishte rrjetë të më mbronte nga mushkonjat, të cilat vallëzonin mirë mbi mua. Fëshfëritjet e imta mbi mushamat e kashtës së çatisë së verandës më bënë të pyesja veten se ç'hardhuce apo kacabu do të binte mbi kokën time. U kisha lakmi fëmijëve për gjumin e qëndrueshëm dhe të pavetëdijshëm. Frymëmarrja e tyre e lehtë filloi



të dëgjohej më shumë sa më shumë që shqetësohesha, derisa u përngjante zhurmëve të një deti të largët.

Pas një përpjekje i mbylla veshët dhe i ktheva sytë në brezin e qiellit të cilin mund ta shihja nga nën veranda. U përpoqa ta dërgoja veten në gjumë duke i numëruar yjet nëpërmjet pulitjes së syve, porse këto vetëm sa më zgjuan më shumë. Pastaj hëna e vetmuar u ngrit mbi fushën e vizionit tim, duke e larë kompleksin me dritën e saj misterioze, aq e dashur nga poetët dhe të dashëruarit. Pastaj dukej që një autoritar Navabi i erës, xheloz për një bukuri të tillë argjendi, ftoi velet e grisura të reve të fsheh fytyrën e saj nga sytë e përmalluar. Shikojë vallëzimin e hënës dhe të yjeve në mbarë qiellin ndërsa ora shkonte para dhe ndieja goditjet dhe vuajtjet e ngjarjeve të ditës në një fokus më real.

Qe një nga ato periudha të kohës ku çështjet e jetës qëndrojnë qartas nga ngatërresat e zakonta sipas së cilës shumë ngjarje merrnin pjesë. Pashë që unë, Gulshan Esteri, e varfër dhe e urryer nga ata që duhej përkujdesur për mua dhe tani e përjashtuar nga dyert e tyre, isha tani e lirë nga pengesat. Veli i religjionit të trashëguar, që një kohë më kishte ndarë nga një Perëndi të cilin askush s'mund ta njihte, qe i grisur, duke e zbuluar Perëndinë në fytyrën e Jezus Krishtit, Zotit tim. Tashmë shtegu i dishepullizimit qe shënjuar, dhe qoftë me kënaqësi apo me dhimbje unë duhet të ecja me bindje në të. Ndonëse nuk isha vetëm. Është njëri me mua i cili është i fuqishëm dhe që do të sigurojë për të gjitha nevojat e mia. E përgjumshme e pashë qiellin e zbehtë t'i gëlltiste yjet duke e lënë yllin e shkëlqyer të mëngjesit, lajmëtarin e agimit. Duke menduar për Jezusin, Yllin e Mëngjesit me plotë shpresë, i dërguar nga Perëndia për ta ndriçuar jetën time, rashë më në fund në një gjumë të shkurtër por të papenguar.

U zgjova me qepallat e rënda në dritën e plotë, kur çuni katërvjeçar Gudu, më preku në krahun tim. Edhe pse me vështirësi që kisha për t'u larë me ujin e tërhequr nga pompa e kopshtit, unë vazhdova të mendoj lidhur me idenë që qe kristalizuar brenda natës – duheshë të gjeja ndonjë punë sepse nuk mund të prisja nga miqtë e mi të përkujdesen për mua.

Drejtoresha e shkollës private të vajzave më shikoi poshtë dhe lart ndërsa po qëndroja në zyrën e saj, e hutuar para kësaj gruaje të

hijshme dhe të frytshme, që përreth saj kishte një erë autoriteti. Tashmë dhe unë isha e patundur. Ajo e rregulloi shallin e saj dhe në mënyrë të sjellshme tha: mirëmëngjes, zonjë! Si mund t'ju ndihmoj? Keni fëmijë këtu?

'Jo, nuk kam fëmijë këtu. Kam ardhur të shoh nëse keni nevojë për një mësuese në shkollën tuaj.'

Shprehja e saj ndryshoj nga një hetim i sjellshëm në atë të një përfillje të lehtë. Mund të shihja që çasja ime direkte kishte përfituar ca pika të zeza. Do të kishte qenë më mirë t'i kisha shkruar, jo të vija, si një shërbëtore apo një kopshtare, për të kërkuar punë.

'Çfarë lëndësh ju mësoni, dhe ç'kualifikim keni ju?'

Unë mund të mësoj urdu, njohuritë religjioze islamike, histori, gjeografi dhe matematikë, deri në nivel kolegji.

Ajo shikoi në mua me vëmendje, duke i korigjuar mendimet e saja. Një mësuese e përkryer e vajzave - tha ajo - megjithëse për fat të keq posti i lirë që patëm është i mbushur, dhe nuk mund të ju punësoj, por nëse e leni emrin dhe adresën tuaj te sekretarësja, unë do t'ju kontaktoj për ndonjë vend të lirë.

Ajo u ngrit nga tavolina e rëndë për të më liruuar, megjithkëtë unë mbeta edhe më tutje. Qesh e dëshpëruar.

'Ka ndonjë mundësi që ju të dini nëse ndonjë nga vajzat ka nevojë për mësim në shtëpi, për arsye të ndryshme, mbase ndonjë sëmundje apo prindërit e tyre nuk duan t'i lejojnë në shkollë?'

'Më vjen keq që nuk di. Por nëse dëgjoj, atëherë kam për të të informuar, nëse e leni emrin dhe adresën tuaj te sekretarësja.'

Për dy apo tre javë kam qenë duke ardhur në qytet, e kaloja Fortesën e Kuqe, për të kërkuar ndonjë punë, duke i shpërndarë kualifikimet e mia nga shkolla në shkollë, si një thashethemexhi. Adresat më vinin nga zyrja e papunësisimit, ku i befasoja zyrtarët me aplikacionin tim. Për ta isha si një enigmë e vërtetë – një grua e re e një klase të lartë, me duar të papërdorshme për ndonjë punë, me siguri e papërkrahur nga familja e saj.

Gjoni dhe Bimla më siguruan sërish dhe sërish për përkrahjen e tyre, ndonëse e dija se isha edhe një gojë tjetër për t'u ushqyer me një rrogë të ulët të një personi. Andaj lutesha për punë dhe ecja nëpër rrugë me diellin që piqte, me një vrimë në këpucët e mia dhe kur

ndihesha e zemëruar dhe e deinkurajuar mendoja për Jezusin se si ecte ai nëpër rrugë që të vdiste për mua.

Kur e vizitova zyrën e papunësimit për të katërtën herë, dëgjova që një zonjë reportere kërkohet për një revistë javore me zyrë në pazarin e vjetër Anarkali. Emrin Anarkali e dija, lule shegë, si një nga këto heroinat tragjike që qëndrojnë në historinë tonë. Ajo që e djegur për së gjalli nga perandori mongol, meqenëse, pa asnjë faj të sajin, ajo pat rënë në dashuri me gjysmëvëllain e saj Salem. Edhe një vajzë tjetër në fatkeqësi - mendoja, duke u përpiqur të përkujtoja nëse ai ishte përgjegjës për dënimin e saj të tmerrshëm. Me siguri jo, sepse ai ishte biri i perandorit.

E kisha parë revistën, e dija që i kishte 24 faqe, me fotografitë e njerëzve të famshëm në mbështjellësin e ngjyrosur, dhe që kishte prirje politike. Dëshpërimi më bëri më të guximshme dhe unë kërkova për një intervistë atje.

Të nesërmen në orën 10 u paraqita në katin e parë të zyrës së revistës në Anarkalinë e vjetër. Redaktori ishte një njeri i gjatë, i pashëm, me një natyrë të paanshme, që vishte një kostum të zi të lehtë, dhe me një sjellje shumë të mirë në fakt.

Uluni ju lutem - më tha - duke indikuar në një karrigë në mënyrë shumë precize, pak më larg nga tavolina e tij e shkëlqyer, aty ku kishte qilim. Ai preku një sustë dhe kërkoi nga një i ri të më shërbente një pije të ftohtë. Ai e solli një shishe me pipë në të.

‘Më intereson të di përse keni nevojë për punë në përgjithësi?’ thoshte ai, dhe dhëmbët e tij të bardhë dukeshin në buzëqeshje.

Nuk kam prindër dhe jam e arsimuar. Dua të përfitoj për jetesën time - i thashë.

Ai luante me një stilograf me maje të artë, dhe vura re aromën e dobët të parfumit, me siguri nga pasroja e tij. Por më thuaj - tha ai - përse vëllezërit dhe motrat e tua nuk kujdesen për ty në mënyrë që ti të mos punojë?

‘Oh ata janë të gjithë të martuar dhe të vendosur nëpër shtëpitë e tyre dhe unë nuk dua të jem një barrë për ta, dhe kjo është arsyeja përse kam nevojë për punë.’

Ai donte të dinte ku tjetër kisha kërkuar për punë dhe i tregova për mosuseksin e aplikimit tim në shkollë. Drita nga dritarja me rrjetë dhe perde të vendosur ra m’u në fytyrën time ndërsa bisedonim dhe

vura re që ai po më studionte me vëmendje. Më pas u shfaq pasi kishte vendosur në lidhje me mua, shumë shpejt mendova më vonë. 'Mund të fillosh që nesër. Eja në mes orës 8.30 dhe 9 dhe mos u brengos – unë do të t'i tregoj pyetjet bazë që ke për t'i bërë gjatë një interviste. Do të kesh nevojë për të punuar bukur shumë për të shkuar edhe në shtëpitë e njerëzve – e ndonjëherë edhe nëpër shkolla.'

Jam mjaft me përvojë përsa i përket shkuarjes nëpër shtëpia të njerëzve - mendova por nuk thashë gjë.

Më sqaroi që do të paguhesha me një rrogë të thjesht prej 100 rupa në muaj. Kjo nënkuptonte kundër çdo gjëje që unë mund të fitoja nga paratë që zonjat do të paguanin për privilegjin e të qenurit të intervistuar. Kjo ide vlente se nëse ata paguanin, do të mund të thoshin ç'do gjë të donin. Do të merrja 20 përqind nga kjo shumë. Qe një sistem që vepronte më shumë për ta sesa për mua, porse nuk kisha fuqi pazarllëku.

- Ti nuk je myslimane - më tha ai. Ishte më tepër një deklaratë faktike sesa një pyetje.

- Jam e krishterë - iu përgjigja duke pritur gjatë në një moment agonie derisa ai mendonte. Më në fund ai e futi lapsin prapa në xhepin e sipërm të këmishës së tij, u ngrit nga karriga dhe tha: Mirë, nuk ka lidhje dhe aq shumë. Dukesh ashtu siç the, një person i arsimuar që nuk ka frikë për të biseduar me njerëz.

Dolëm jashtë nga zyra e redaksisë ku dhe takova tre reporterë meshkuj, një fotograf dhe një shtypës. Ai më ofroi një tavolinë vetëm mua. Qe një dhomë e tretë ku ne drekonim – të ofruar falas.

Aty qe edhe një punëtor i cili bënte punë nga më të ndryshmet, dërgonte letrat, kryente porositë, merrte drekën dhe përgatiste qajin.

Ditën e nesërme arrita në punë në kohën e caktuar dhe takova kolegët e mi. Unë isha e vetmja femër në mes të shtatë meshkujve dhe të gjitha brengat e mia në lidhje me shifrën qenë të pabaza – të gjithë më trajtonin me respekt të veçantë dhe në dhomën e reporterëve mua më quanin 'Bagji' (motër). Mësova të gjitha që munda gjatë katër ditëve të ardhshme duke përfshirë dhe dhjetë pyetjet bazë. Isha e përcaktuar të kisha sukses.

Informacionet, siç kuptova shpejt, duheshin shkruar në dhomën e redaksisë dhe të kontrolloheshin nga redaktori para se t'i

dorëzoheshin shkruarjes në urdu në faqe të mëdha të fletave. Redaktori më pas do ta ekzaminonte edhe një herë punën për t'u siguruar që nuk kishte gabime para se t'i dërgohej shtypit. Ndonjëherë duhesha ta shoqëroja punëtorin në postë për të çuar apo mbledhur pakot.

Kur ktheheshin pakot e revistave të sapo printuara, ishte puna ime t'i palos dhe adresoj ato. Qesh e pajisur me etiketa dhe ngjitës dhe kënaqesha duke mësuar detyrat e reja ndërsa prisja me pak shqetësim për intervistën time të parë. Kjo duhej të ishte me gruan e ish ministrit të jashtëm, i cili kishte dhënë dorëheqje nga qeveria për shkak të vështirësive personale me z. Buto, kryeministrin. Kjo do të thotë që do të duhesha të bëja pyetje të cilat zonja do të mund t'i konsideronte pak të bezdisshme – porse qesh e siguruar nga redaktori që ajo mezi do të priste rastin për të shfaqur anën e saj të situatës. Ai kishte të drejtë, si zakonisht.

Isha e pranuar nga zonja shumë mirë në dhomën e saj të pritjes dhe më kërkoi të ulesha. Mendja më shkoi menjëherë tek ajo zonja tjetër e këndshme e cila më kishte çuar në burg. Më duhet ta pranoj që ishte kënaqësi tani të isha pjesë e shtypit, e në këtë mënyrë edhe poseduese e një fuqie më të madhe se në të kaluarën. Unë isha tani hetuesja.

I bëra dhjetë pyetjet e mia, një nga një. 'Përse ka dhënë dorëheqje burri juaj?' 'A jeni e lumtur në lidhje me këtë?' 'Ku jeni shkolluar?' dhe kështu me rradhë.

Pyetjet nuk ishin dhe aq depërtuese, ndonëse fakti që i qenë bërë të gjitha një gruaje dhe si rezultat do të lexoheshin nga mijëra njerëz poshtë dhe lart shtetit, fliste me të madhe rreth ndryshimeve që merrnin pjesë në shoqëri gjatë asaj kohe.

Altafi, fotografuesi më shoqëroi në këtë intervistë dhe të tjerat. Me këtë më ishte siguruar dhe mbrojtja dhe ai qe tepër i kënaqur t'i takonte femrat. Njëra pjesë e shoqërisë ishte ende e fshehur nga vështrimi dhe trajtohej si pronë personale e pjesës tjetër. Çdo ide moderne që ndërfitet ka një rrugë të gjatë për t'u balancuar ndaj traditës, që edhe më tutje mbante meshkujt dhe femrat në lidhje të afërt, të pasurit dhe të arsimuarit, sikurse dhe të varfërit dhe të injoruarit.

Altafi ishte i dobishëm edhe në aspekte të tjera po ashtu. Zonja lëshonte ndonjëherë, disa fjalë angleze, duke përshkruar jetën e saj. Kjo më turpëronte shumë sepse ndalesa e vjetër e babait tim e kishte mbajtur këtë gjuhë nga unë, dhe tani në një shoqëri ku ishte vula e një edukimi, më nevojitej. Megjithkëtë shoqëruesi im përkthente për mua dhe gjithashtu mendonte për pyetjet tjera që duhej bërë, kur mendja më zbrazej.

Kur përfunduan të gjitha pyetjet, zonja më pyeti për veten time:

- Ti je e shkolluar apo jo?

- Mjaft e shkolluar sa për të marrë në intervistë - i thashë. Ajo qeshi.

- Nuk është dhe aq shpesh që njeriu të takojë një grua me të vërtetë të shkolluar - thoshte ajo.

Kur u shfaq artikulli im, i rishkruar nga redaktori, mbante emrin tim Gulshan, nën titullin e saj. Ai nuk do ta shtonte dhe emrin e krishterë Ester. Zonja pagoi 700 rupa për të dhe unë fitova 140 nga to, 100 i dhashë Gjon Emanuelit dhe 40 i mbajta për veti. Në fillim ata nuk donin t'i merrnin paratë ndonëse unë insistoja.

Ne jemi shumë të lumtur që Perëndia është duke të ndihmuar - thanë ata. Kështu ndihesha dhe unë. Për herë të parë në jetën time kisha filluar të fitoja para, duke ecur në udhën time nëpërmjet edukimit që kisha marrë. Në mënyrë të padukshme, vizioni i zemëruar i fytyrave të vëllezërve të mi filloi të fishkej diku në prapavijë.

Me një rast tjetër intervistova drejtoreshën e shkollës së mesme të vajzave në Lahore. Qesh nervoze rreth të shkuarit atje, sepse kisha frikë në rrjedhën e pyetjeve të mia para një gruaje të mençur, e mbuluar me autoritet sikurse *burka*. Por fotografuesi, Altafi, më siguroi:

- Thuaji asaj që do ishte mirë të sqaronte çdo gjë në mënyrë që lexuesit të kuptojnë. Pastaj dëgjoji me kujdes dhe shkruaji të gjitha. Mos ke frikë të bësh pyetje të thjeshta – shumë lexues të tu nuk do të donin të ishe shumë e mençur.

Qe një këshillë e mirë. U ula aty me thjeshtësinë time më të madhe dhe mora një leksion nga drejtoresha lidhur me dallimet në mes të një shkolle private dhe asaj shtetërore. Një përparësi e padyshimtë sipas pikëvështrimit të saj ishte që ajo kishte një dorë më të lirë – nën pronarët e mëparshëm ajo ishte përgjegjëse për një marrëveshje

të madhe dhe kuotat e anëtarësisë ngriteshin lart. Një situatë më e pavoritshme tani ishte që kishte më pak objekte në numër. Përveç këtij informacioni unë vura re disa detaje lidhur me dhomën, për vetë zonjën, për stafin e saj të cilin e takova, lidhur me gjendjen e shkollës që e vështruam dhe me paraqitjen e vajzave.

Fotografuesit i pëlqeu kjo intervistë e rëndësishme së madhe dhe atij i ishte kërkuar për të fotografuar çdo gjë duke përfshirë edhe vajzat. Ato ishin mjaft tërheqëse në mbulesat e bardha me *dopatën* e tyre të kaltër që ishte uniforma e tyre, dhe mendoj që për ta kjo ishte një risi argëtuese meqë qeshnin tepër, duke i mbuluar gojët e tyre me anë të *dopatave*.

Për shkak të artikullit mora një lavdërim nga redaktori – jo keq - tha ai. Ai nuk ishte një nga ata që do të ngazëlleshin. U ktheva në shkollë tri ditë pasi artikulli u shfaq për të mbledhur shumën e rupave që kishin ngelur – të intervistuarit çdo herë paguanin kaparin. Kuptova që drejtoresha tani ishte plot me kureshtje për mua, sepse një nga personeli i saj që ishte i krishterë, i kishte thënë diçka lidhur me ngjarjen time.

Përse je bërë e krishterë? Më lejo të të ndihmoj të rikthehesh në besimin tënd mysliman - tha drejtoresha. Kështu, në prani të personelit të saj i fola pak rreth kësaj. Ti ke një qëndrim të dashur dhe një besim të fortë - më tha udhëheqësja.

Nervoza ime filloi të zhdukej meqë asnjë incident nuk u paraqit rreth asaj që kisha shkruajtur. Puna filloi të bëhej çdo herë më e lehtë për mua, dhe ishte bërë gjë e zakonshme ta shihja emrin tim në artikuj. Qe një ndjenjë e çuditshme të mendosh që fjalët e mia lexoheshin në tërë Pakistanin – dhe me siguri ushqenin aspiratat e femrave të reja, duke dëshmuar ç'gjë mund të arrijnë njëra nga to. Por përkundër kësaj, unë shembulli i tyre, kisha mendime dhe ambicie që qëndronin në një drejtim plotësisht të kundërt, për të shërbyer Perëndinë dhe kryer vullnetin e tij. Vallë pse isha unë këtu, duke punuar për këtë revistë – diçka tërësisht jashtë karakterit me tërë atë që kisha qenë më parë? Shtegu im i pelegrinimit më kishte udhëhequr këtu, por për ç'arsye? Kjo qe një enigmë dhe unë kisha lënë anash të luaja me të dhe vetëm jetoja nga dita në ditë në dy pjesë plotësisht të ndara të jetës sime, jetën e punës dhe jetën e lutjes.

Ndonëse kolegu im gazetar ishte i vetëdijshëm që una isha e ndryshme nga ta. Për rreth dy javë ata arritën të kuptonin që isha e krishterë, megjithëse nuk e dinin që një kohë kam qenë edhe myslimane po ashtu. Ata më përqeshnin për shkak të besimit tim – ti beson në tre zotëra - thoshin ata duke qeshur. Unë përpiqesha t'u tregoja që nuk ishte ashtu siç mendonin, që ishte vetëm një Perëndi me tre manifestime – Ati, Jezus Krishti Biri i Perëndisë, e jo vetëm si një profet, dhe Fryma e Shenjtë, i dërguar në ditën e Pentekostit për të banuar në jetën e besimtarëve me jetën e Krishtit, që t'i mësonte dhe bënte të shenjtë. Por ata ishin me pikëpamje të tillë që nga fëmijëria, të mendonin për krishterimin si më inferiorë ndaj pastërtisë së religjionit të tyre monoteist, dhe si do t'ua ndryshoja unë mendjen atyre? Sidoqoftë kuptova, që asnjëri në atë zyrë nuk e mbante kohën e faljes së drekës, dhe hamendesha sesa kuptim për ta kishte besimi i tyre.

Ndarjet mes zyreve qenë bërë vetëm nga një tabelë dhe redaktori zakonisht do të përfundonte përcëimin e tyre duke hyrë brenda për t'i ndalur ata. Mos u tallni me të. Ajo është e vetmja femër dhe ju nuk guxonin të jeni të ashpër me të.

Një ditë rreth orës katër, ndërsa po ecja poshtë shkallëve për t'u kthyer në shtëpi, pronari i një ëmbëltoreje ngjiti me zyrën tonë, z. Jusuf, më bëri zë.

- 'Selam alejkum (paqja qoftë me ty) - tha ai. Unë u ndala dhe prita derisa erdhi lart tek unë. Alejkum selam (paqja qoftë dhe për ty) - iu përgjigja.

Ai më tha: zonjë, ju kam parë duke kaluar këtej dhe kam qenë duke menduar që ju duhet të jeni një person i edukuar pasi punoni në një revistë. Unë po kërkoja një mësuese për të tre fëmijët e mi, dhe po mendoja nëse ju do të ishit e interesuar t'i mësonit ata pas punës tuaj? Mund ta rregullojmë pagesën lidhur me mësimet.

Unë hezitova. Paga ime në revistë nuk qe e madhërishme, sepse vetëm dilja jashtë një apo dy herë në muaj, përkundër meshkujve që ishin në terren gjatë tërë kohës, edhe jashtë Lahores. Shkova me të në shtëpinë e tij dhe takova gruan dhe fëmijët e tij dhe të gjithë e pëlqyem njëri-tjetrin aty në vend dhe u goditëm rreth çmimit menjëherë. Unë do t'ua mësoja fëmijëve urdun, matematikën, shkencat islamike, historinë dhe gjeografinë kur do të vinin nga



shkolla për dy orë në ditë, nga 4 deri në 6 pasdite. Për këtë kërkova 150 rupa në muaj dhe të më ofrohej dhe darka çdo ditë. Nuk kisha për të ardhur të dielave.

Kjo punë e re kishte një efekt. Duhesha t'i leja miqtë e mi të dashur në koloninë Medina, sepse do të ishte errësirë derisa do të kthehesha në shtëpi dhe për një grua nuk ishte dhe aq e sigurt të ecte e vetmuar në rrugët e errëta. Lahore kishte namin për hajdutë të xhepave dhe kidnapues – me të cilën gjë isha shumë e njohur me përvojën e të qenurit në burg. Andaj fillova të banoja me zotën dhe zonjën Nelam. Ata jetonin në rrugën Varis, afër kishës dhe jo shumë larg nga Anarkalia e vjetër. Unë e njihja z. Nelam që nga ditët e shkollës së 'Lindjes së Diellit', ku dhe ishte mësues i muzikës.

Aty nga dhjetori unë tashmë kisha shkruar tetë apo nëntë tregime, të gjitha nga 'Gulshani' apo ndonjëherë, 'nga reporterja jonë', dhe ndiejta që redaktori ishte i kënaqur me mua. Në javën e dytë të muajit ai më ftoi në zyrën e tij.

Ti je duke ecur më mirë seç kisha menduar - tha ai. Unë do të doja të të mbaja këtu, por një gjë është e domosdoshme – duhet të kthehesh në besimin musliman.

Unë rrija sikur të isha shndërruar në një shkëmb. Ai vazhdoi më tutje:

Tani e di ngjarjen tënde përse je e krishterë. Por më lejo të të them që nëse vëllezërit e tu nuk të ndihmojnë, unë do të dal për ndihmë – vetëm braktise krishterimin. Jo, dëgjo, unë do të lejoj të qëndrosh në shtëpinë time. Do të vë në udhëheqje të reporterëve të tjerë. Do të punësoj edhe një reportere tjetër dhe do të ofroj një pagë rrafsh prej 1000 rupash në muaj...

Me një shpejtësi të madhe të realitetit u zgjova ndaj domëthenies së këtij fjalimi. Ky njeri ishte në kontakt me Alim Shahun – ata mbase ishin miq që shkonin në të njëjtat klube. Ai me siguri ka ditur për mua që nga fillimi dhe ka qenë duke punuar me durim deri në këtë moment. Qe ngjarja e njëjtë që përsëritej. 'Tregoji asaj sa dashuri kanë myslimanët për njëri-tjetrin, atëherë mbase do të kthehej prapa, meqë është në nevojë për të fituar për jetesën e saj dhe për të banuar me njerëzit e tjerë.' Dhe unë, e cila isha aq e kënaqur me progresin tim të shkruarit, kisha dështuar të mendoj përse ky njeri i botës do

të merrte dhe mbante dikë të papërvojë si mua? Dhe si do të mësonin që kurrë nuk do të kthehesha në vathë?

Mora frymë thellë. 'Mos mendoni që nuk e vlerësoj ofertën tuaj. Unë do të doja me të vërtetë të vazhdoja punën time këtu për ju, por më duhet t'ua them që nuk mund ta lë besimin e krishterë. Jezusi është jeta ime. Atë që e kam gjetur në të asnjë fe nuk mund ta siguroj.'

Mu atë ditë më vonë, gruaja e redaktorit hyri brenda për të më parë, gjatë rrugës së saj për në Anarkalinë e vjetër – për të bërë përpjekjen e fundit të më kthente mendjen time, supozoj.

Ajo më ftoi në zyrën e burrit të saj ndërsa ai ishte i zënë duke i lexuar dëshmitë në dhomën e reporterëve.

Ti je mjaft e mençur - tha ajo. Përse je e krishterë?

Ngatërrimi i vërejtjes së saj më bëri të rënkoj në brendësi. Për një mysliman të gjithë të krishterët janë njerëz budallenj që besojnë një gënjeshtrë. Vura re që kjo grua nuk kishte ndriçim shpirtëror dhe nuk ndieja se duhej thënë të gjitha sërish.

Thashë me butësi: nuk do të jesh në gjendje për të kuptuar periudhën në të cilën gjendem tani. Perëndia është aq real me mua.

Ajo më shikoi ndërsa fytyra e saj u ngurtësua dhe iku pa asnjë fjalë tjetër.

Në fund të ditës redaktori më dorëzoi zarfën ku gjendeshin 125 rupa. Më vjen keq - tha ai - por nuk mund të punosh më këtu. Me shumë keqardhje për shkuarjen tënde, unë dhe gruaja ime do të të përkujtojmë çdo herë.

Më vjen keq po ashtu, porse Perëndia do të më gjejë një punë tjetër - thashë, me kokë të mbajtur lart, ndonëse në brendësi qesh larg nga trimëria. Redaktori vërehej qartas që vuante me ndjenjat e tij humanitare meqë ndërsa po ecja te dera tha:

Në qoftë se do kesh nevojë unë do të të ndihmoj, por që problemi i fesë do të ngelet.

Mos u brengos - i thashë - Perëndia im ka për të më ndihmuar. Para se të kërkoj ndihmën e njeriut do të kërkoj ndihmën e Perëndisë. Dhe e lash zyrën e tij.

Reporterët tjerë qenë shumë të palumtur për shkuarjen time. Kemi kaluar aq kohë bashkë dhe tani je duke shkuar, vetëm e vetëm për shkak të fesë. Mirë, Krishti të ka shëruar – por përse nuk jep disa para dhe ta lësh me kaq?

Ai është më tepër se kaq për mua - thashë dhe ua dhashë dorën duke u premtuar se do të lutesha për ta. Pastaj u nisa për të ecur poshtë shkallëve duke tundur kokën nga shoku i dëbimit, mu atëherë kur fillova të ndihem e sigurt nga ky sulm i veçantë.

Jashtë u mbështeta për muri për të marrë veten. Duhej të ishte një arsye për tërë këto përvoja të hidhura. Në zemrën time i klitha Atit në qiell dhe aty për aty Ai m'u përgjigj me një fjalë ngushëlluese:

Çdo ditë do të kesh fuqinë time. A nuk të kam premtuar kështu? Në fakt nuk isha në dijeni që para meje shtrihej toka ime e premtuar dhe që po përgatitesha për të hyrë në të.

## 14. Dëshmia

- Është një vizitor këtu për ty - tha zonja Nelam në mëngjesin e 30 dhjetorit, ndërsa unë e habitur ngrita kokën nga libri im.

Qe z. Gjill, një plak nga kisha në Kolegjin e Krishterë Foreman, i cili më kishte sjellur një ftesë. Ai pa vonesë u ndal te pika kryesore.

Drejtuesi Arthur i kishës metodiste, Kolegji Krishter i Foremanit, ju ka bërë një ftesë për të predikuar në shërbesën e Vitit të ri. Ju mund të predikoni çfarëdo mesazhi që të keni dëshirë. Ç'thuani?

Nuk u përgjigja për momentin. Kolegji Krishterë Foreman qe një vend i madh dhe kisha ishte përplot me njerëz me influencë. Si do të mund të rrija unë para një turme aq të madhe për të predikuar? Gati sa u ndjeva për të refuzuar, pastaj m'u kujtua diçka që më kishte folur Perëndia:

'Shko dhe predikoj popullit tim.'

Kur qesh shëruar Jezusi më kishte dhënë këtë urdhër për ta bërë këtë, ndonëse atëherë nuk isha e gatshme. Por ai vegim shkëlqyes kishte ndriçuar rrugën time të rëndë, duke më mësuar për të njohur Perëndinë nëpërmjet fjalës së tij dhe nëpërmjet besimit. Mbase kjo ftesë, e ardhur në momentin kur se prisja, ishte një shenjë që isha e gatshme për t'i dëshmuar kishës ç'kisha parë nga hiri i tij i madhërishtëm dhe dashamirësia e tij?

Porse tani e dija që nëse rrjedha e veprimeve ishte në rregull disa faktorë do të përputheshin – rruga do të hapej, një fjalë do t'më vinte nga Zoti dhe do të ekzistonte një paqe e brendshme dhe siguria që veprimi ishte i duhur.

Shikova lart tek i dërguari. 'Do të vij' i thashë, 'Por si do të arrij atje nga kjo shtëpi?'

'Ti do të jesh mëse e pritur të qëndrosh me mua dhe gruan time në shtëpinë tonë nesër mbrëma në Koloninë Vadani. Ajo gjendet afër kolegjit dhe pastaj ne do të të çojmë në shërbesën e ditës së Vitit të ri.'

Kamla Nelam ra dakord me këtë ide dhe ishte rregulluar që z. Gjill do të vinte për mua të nesërmen për të më çuar te shtëpia e tij. Unë shkova për t'i mbledhur mendimet e mia për testin që më priste.

Nesër mbrëma, në dhomën e qëndrimit të zonjës Gjill, frika më kaploi ndërsa sodisja atë që duhet të bëja. Krenaria po e ngriste kokën e saj... Doja aq shumë të lija përshtypje të mirë.

Në gjunjët e mi përfundimisht shpreha mendimin me zë të lartë: 'Si do të flas për ty? Kanë kaluar katër vjet që kur të kam parë. Si do të të përshkruaj?'

Thënë me një fjalë dukej qesharake. Ç'gjë kërkoja unë? Një interpretim të përsëritur të një përvoje të shenjtë? Menjëherë sapo e ngrita zërin vura re sa qesharake qe për t'u brengosur për gjëra të tilla. Në qetësinë e mendjes sime, e përkulur në prezencën e Perëndisë, e dëgjova zërin e butë, e të qetë: 'Fryma ime do të jetë me ty.' Gëzimi më përshkroi. Premtimi qe i mjaftueshëm.

Ishte padyshim hera e parë në jetën time që duhej të përballesha me një turmë të tillë. Mësuesit, profesorët, infermierët, doktorët nga spitali i afërm i krishterë – që të gjithë të edukuar mirë dhe të sigurt në vetvete. Megjithkëtë ndjeva një fuqi frymëzuese të vinte mbi mua ndërsa po dëshmoja rreth shërimit tim dhe shfaqjes së hirit të Perëndisë në jetën time nëpërmjet një vuajtje aq të madhe. Audiencia qe tërësisht e qetë dhe absorbonte çdo fjalë, duke mos i hequr sytë fare nga fytyra ime.

Ndërkohë që zbrita nga katedra njerëzit vinin tek unë për të më treguar ç'kishte qenë domethënëse për ta. Kjo ishte e fuqishme - tha njëri apo dy nga ta. Nuk e vumë fare re kalimin e kohës - disa thoshin - me lot në sytë e tyre. Gratë duke dalur jashtë thoshin: ke vuajtur shumë në vetën tënde. Le të jemi në kontakt me ty, dhe më ofronin adresat e tyre.

Diçka nga ofertat m'u dhanë për të shkuar më vonë në shtëpinë e z. Gjill për të ngrënë drekë. Nëpërmjet një kënaqësie të paqartë mendoja për vëllezërit e mi – sa do të doja të dëgjonin për këtë kthim të ri të motrës që kishin gjykuar.

Si rezultat i këtij mëngjesi, unë qesh e ftuar të udhëheqja takimet e rregullta të grave në kishë në Kolejin e Krishterë Foreman. Kjo do të thoshte që duhej të lija punën time në shtëpinë e z. Jusuf, dhe të hidhesha në punën që me të vërtetë doja ta bëja – ungjillizimin. Të gjitha kishat në atë pjesë fillonin të më ftonin një nga një për të predikuar, duke i paguar dhe shpenzimet.

Gjatë muajit prill dhe maj kam qenë duke jetuar me disa miq në Kanal Park. Në qershor një familje tjetër më mori në shtëpinë e tyre dhe aty qëndrova deri në ditën e dasmës së birit të motrës sime.

Një kamp veror i grave po përgatitej të mbahej në Mure. Kjo pjesë, 8000 këmbë mbi nivelin e detit, në kodrinën e Himalajeve, dhe dy orë e gjysmë me autobus nga Ravalpindi, ishte një stacion i vjetër kodrinor, që datonte që nga pushtimi britanez. Tanimë njerëzit e pasur shkonin atje për pushime, për t'u kënaqur me klimën e freskët dhe pamjen e maleve, me një apo dy maje me borë përgjatë tërë vitit. Në Mure mbahej një numër i madh i aktiviteteve krishtere – shkolla e gjuhës për misionarë, shkolla krishtere për fëmijët e misionarëve dhe të njerëzve të tjerë. Kjo, përkundër të gjitha shkollave në nivel deti, ngelte e hapur gjatë verës dhe mbyllej vetëm gjatë dimrit për një muaj, ku bora e madhe mbyllte rrugët e rrezikshme malore. Mureja që po ashtu shumë e zënë gjatë verës me kampet dhe konferencat e mbajtura nga grupet krishtere anembanë Pakistanit.

Kampi i grave në Mubarik, në të cilën isha e ftuar si folës kryesor, që vetëm për një javë, në qershorin e hershëm. Duhesha të udhëtoja me tren nga Ravalpindi me drejtuesin e kampit, z. Hadajat, dhe ishim gati të niseshim të premten në orën 4 të mëngjesit. Unë po mendoja për udhëtimin tim të parë në jetën time me tren.

Porse të enjtën në mëngjes, rreth orës 10 mora një mesazh nga motra ime, Samina, e cila ishte në Samanabad dhe përgatitej për dasmën. Djali i saj do të martohej atje të shtunën dhe ajo donte që unë të isha një nga mysafiret e saja.

Djali i saj e bëri ftesën në mënyrë verbale në dhomën ku qëndroja si vizitore. I buzëqesha me dashuri. Nga ajo pak që kisha parë tek ai gjatë viteve të rritjes, Mahmudi që një nder i familjes dhe unë do të doja të kisha marrë pjesë në dasmën e tij, ndonëse kishte shumë pengesa:

I çova prapa një përgjigje verbale nëpërmjet Mahmudit.

“Të lutem thuajni nënës tënde që ju dua shumë që të dyve, por nuk mund të vij. Çdo kush do t’jetë kundër meje për shkak të besimit tim dhe prezenca ime vetëm që do ta shqetësonte atmosferën, e cila do të duhej të ishte një ditë e lumtur për të gjithë ju. Nuk do të ishte gjë e mirë që unë të vija dhe pavarësisht nga kjo më duhet të udhëtoj të

premtën në një konferencë në kodër. Kërkoj nga ju të gjithë t'i pranoni faljet e mia në refuzimin e ftesës suaj të këndshme.'

Nipi im u largua që aty me Jamahën e tij, por i pikëlluar. Ndërsa unë vazhdova me përgatitjet e mia. Aty kah ora dy e drekës Mahmudi u kthye sërish.

'Teze, duhet të vish patjetër në dasëm. Nëna thotë që nuk do të martohem unë pa praninë tënde. Dhe dua të vish po ashtu. Dhe birit të madh i rrodhën sytë lot.

Bëra një vendim të shpejtë. 'E vetmja gjë që mund të them është që do të shkoj te zoti dhe zonja Hadajat për të kërkuar opinionin e tyre. Është plotësisht e mundur që të marrë pjesë në dasmën tënde dhe pastaj të nisem në kohë për të zënë autobusin për Ravalpindi, i cili do të lidhjet me atë që nisët për Mure të dielën në mëngjes.

Fytyra e Mahmudit shkëlqeu. A mund të hipësh në ndenjësën e pasmë teze? Unë kam për të të dërguar tek hadajatët - tha ai. Kështu për një kohë të shkurtër fqinjët do të kishin kënaqësinë e një spektakli të një gruaje të re të ulërinte prapa në motoçikletë, e kapur fortë për këmbëshën e një të riu para saj.

Kur i përmenda miqve të mi dilemën në të cilën isha, ata e zgjidhën menjëherë për të më këshilluar të pranoja ftesën:

Do të jetë një dëshmi - thanë ata. Disa nga të afërmit e tu nuk të kanë parë që nga shërimi yt.

Kjo ishte e vërtetë. Mendoja prapa në atë takim të tmerrshëm me xhaxhallarët. Përkujtoja sytë e tyre të ngurtësuar, që dilnin jashtë nga fytyrat e inatosura ndaj kësaj vajze të re të pacipë, e cila guxonte të njolloste traditat familjare dhe ligjin islamik. Por a ishin më të ndryshëm ata? Dyshoja lidhur me këtë. Ndonëse, mund të kishte një apo dy mundësi për të dëshmuar, dhe unë e doja motrën time dhe djalin e saj. Për hir të tyre do të shkoja.

'Ke të drejtë,' thashë. Dhe meqë kjo vështirësi qe rregulluar, z. Hadajat shikonte oraret e autobusëve në ditarin e tij dhe zbuluam që kishte një autobus që nisej nga Badami Bag në Lahore në orën 12 të mesnatës të shtunën, që do të më çonte në Ravalpindi me kohë për të marrë autobusin tjetër për Mure, për të arritur me kohë të flisja në takimin tim të parë të dielën pasdite.

Nipi më çoi në shtëpi sërish me Jamahën e tij dhe më premtoi që do të vinte për mua të nesërmen për të më çuar në dasmë.

Dhe, të nesërmen me një çantë të vogël me vete, qesh përcjellur për në Samanabad në një stil madhështor nga nipi im.

Dasma, ashtu siç kisha parashikuar, qe një katastrofë që nga fillimi e gjer në fund. Disa nga të vjetrit e morën prezencën time si një ofendim të drejtpërdrejtë dhe kthenin shpinën e tyre kah unë sa herë që shfaqesha në rrethinën e tyre. Të tjerët, për të cilët ndjenja e fortë e xhihadit qe argument fortë i zgjedhur, ashtu që vështirë gjeja ndonjë mundësi për të biseduar me motrën time Saminën, apo Anisën, që nuk i kisha parë për rreth një vit.

Goditja kryesore e sulmit qe: Përse të besosh në Jezusin, si Bir të Perëndisë?

Biblën time e kisha në çantë, por që nuk kisha nevojë ta përdorja – fjalët për të cilat kisha nevojë vinin në gojën time të paprositura dhe me fuqi. Kjo mundësi, vura re, nuk do të më ofrohej edhe një herë, andaj flisja me çdo kë që shfaqte një interes sado të vogël. Argumentet vetëm sa ngriteshin dhe dukej që nuk kisha kohë as për të ngrënë. Kundërshtarët e mi kryesorë, vëllezërit e mi, nuk i pashë. Safdar Shahu kishte qëndruar në shtëpi kur dëgjoi që unë do të vija, ndërsa Alim Shahu rrinte me mysafirët meshkuj, për të mos u takuar me mua.

Dalngadalë kundërshtarët e mi bienin poshtë, një nga një, me mendime të tilla si: oh ajo është e marrë, lëreni të lirë - dhe - ajo nuk ka lidhje me ne; mos i flisni asaj.

Befas vështrova orën. Qe 11 para mesnate. Dëgjova një zë të më thoshte: nesër ke për të dëshmuar në Mure dhe ti je ende këtu. Me këtë panik lehtë të goditur u nguta për në dhomën e motrës sime dhe kërkova nëse ndonjë do të më përcjellte në Badami Bag. Porse makina e Saminës përdorej për mysafirët tjerë, Anisa qe e zënë me ata të burrit të saj – dhe disa nga vizitorët tjerë refuzonin – në fakt e dëgjova njërin të thoshte: nuk duam ta ndotim veturën tonë. Kërkoji Jezusit tënd për ndihmë.

Samina më erdhi pranë dhe kapi dorën time – Gulshan më vjen keq që nuk mund të të ndihmoj. Përse nuk qëndron me ne sonte dhe nesër do të të çonim në stacionin e autobusit?

Kjo do të ishte e arsyeshme meqë kishte rrezik në rrugë për një grua të ecte e vetmuar në këtë kohë të natës. Porse një ndjenjë urgjence më kaploi. Urdhëri më ishte dhënë, dhe duhej të gjeja rrugën time



disi. Pa u përshëndetur fare u largova qetësisht nga shtëpia, me të gjithë komoditetin dhe sigurinë, për në rrugë. Retë ishin duke e mbuluar hënën, ndërsa shtëpitë dhe pemët merrnin forma jetëshkurtëra në errësi. Degët e pemës së madhe të manës fëshfëritnin mbi kokën time. Lëvizja me nervozizëm duke iu larguar hijeve të tyre.

‘Zot ti më ke bërë të shenjtë. Kujdesu për mua dhe më ndihmo të arrij stacionin e autobusit në kohë. Unë jam tërësisht në duart tuaj!’- u luta.

Kur mbarova lutjen lotët nuk mund t’i mbaja më. Prezenca e Perëndisë që në tërësi përreth meje në errësi, dhe në këtë rreth ndihesha e sigurt.

Pastaj larg nga unë dëgjova duke u afruar, gërhimën e butë të një motori të motoçikletës, dha gati menjëherë pashë dritat e parme, dritat e gërshetuara në velin e zi të një nate, ndërsa vetura lëviste në drejtimin tim përgjatë pistës së ngrohtë. Pashë që ishte një rikshë e mbuluar. Po e sjellte dikë në dasëm mbase, apo kishte për të marrë dikë pas një ditë të gjatë pune?! Duke u lutur që njeriu të ndalej për mua unë i bëra me dorë dhe riksha u afrua në anën time.

‘Mund të më çoni në Badami Bag sa më shpejtë që mundeni? Kam për të zënë autobusin që nisët për Ravalpindi sa më shpejt të jetë e mundur.’

Nuk mund ta shihja fytyrën e tij, por ai bëri me kokë dhe unë u futa brenda duke mos i lejuar vetes të dyshoja nëse ai ishte një kopuk që do të shfrytëzonte situatën time. U nisëm menjëherë, duke zgjuar jehonat. Sa shpejt dukej që kalonim nëpër këto rrugë. Kur iu afruem Badami Bagut sipas orës time dukej që kishim kaluar pesëmbëdhjetë milja për pesë minuta. Njeriu në rikshë, pa asnjë fjalë mori valixhen time dhe e barti deri te autobusi për Ravalpindi. Mirë i ndërtuar dhe i veshur me një mantel të gjatë të çuditshëm me një ngjyrë kafeje jo të qartë, ai ecte para meje dhe ndieja që ai duhej të ishte një patan nga veriperëndimi i Pakistanit.

Ai e vendosi valixhen time nën një ulëse diku para dhe ishte gati të nisej që aty pa pritur fare për pagesë, dhe kur e ndala për ta pyetur: sa duhet të të paguaj?

Ai u kthye pjesërisht dhe më tha: Perëndia më ka dërguar për t’ju ndihmuar. Shkoni në paqe. Pastaj tërhoqi mëngën e mantelit të tij

dhe në krahun e tij të fuqishëm pashë një fjalë të shkruar me shkronja të ndriçuara, Petrus (Pjetër). U përpoqa të shihja fytyrën e tij por vura re vetëm sytë e tij që shkëlqenin.

Lotët nuk i përmbaja dot nga sytë e mi dhe më duhej t'i fshija. Kur u ktheva sërish ai qe zhdukur pa marrë asnjë para. Duke dyshuar mos e kisha ëndërruar këtë epizodë, shikoja rreth stacionit të autobusit që ishte i zënë në këtë kohë të natës, ku njerëzit udhëtonin më me qejf ndaj vapës së ditës, dhe pashë vetëm udhëtarët që shtrinin këmbët e tyre për një rrugë të gjatë.

U ula në vendin tim në një ulëse të rehatshme, e vetmja femër në autobus që udhëtonte vetëm duke mos vënë *burkën*, dhe i pagova kondukterit për çmimin e kërkuar.

U ndalëm për një gjysmë ore freskie në Xhelum, diku rreth gjysmës së rrugës dhe sërish por më pak në Guxharkan. Filloi të bëhej më ftohtë ndërsa ngritëshim në kodrat e Himalajeve. Dhe në kohën kur mbërritëm në Ravalpindi, rreth orës 4.45 të mëngjesit ndërsa futëshim në mes turmës së njerëzve, lopëve të dobëta dhe dhive, veturave, rikshave, kamionëve, biçikletave dhe qerreve për te stacioni në Ragja bazar, dielli kishte filluar të pikturonte qiellin nga lindja me reze të arta të agimit.

Autobusi për Mure qe më i vogël dhe udhëtimi ishte më i ngadalshëm dhe më i rrezikshëm për shkak të rrugëve malore me kthesa, me hapësirë vetëm për dy vetura për të kaluar. Ishte një rrugë e frekuentuar mirë në këtë kohë të vitit, ku njerëzit piqeshin për shkak të vapës tronditëse. Ishim të ulur anash dhe unë kisha shpinën time të kthyer kah malet në mënyrë të mos shihja përtej skajeve të shpatit.

Në orën 11 të drekës mbërritëm në Mure. Dola jashtë te ndalesa e autobusit, në këtë shpat që gjendej nën qytet. I dhashë valixhen time një hamall i cili më udhëhiqte në një rrugë të shkurtër për në kampin Mubarik. Afër kampit roja vuri re që ne po vinim dhe erdhi për të më përshendetur dhe mori valixhen.

Kampi i grave për mua qe një javë e jashtëzakonshme. Aty ishin tridhjetë gra nga Peshavari, Silkoti, Karaqi, Fazalabadi (më parë i quajtur Lialpur) dhe nga Hiderabadi. Perëndia kishte vendosur dorën e tij shëruese në këto vende ku gratë qenë me plot plagë dhembëse.

Fjeta në një shtëpi dy katëshe duke ndarë dhomën me Ruthin nga Abotabadi. Aty kishte mësim të mëngjesit dhe mbrëmjes dhe kohët e ngrënies, ndërsa koha tjetër që e lirë, ndonëse unë isha e zënë gjatë tërë ditës duke biseduar me gratë lidhur me barrët e tyre. Një mësuese nga shkolla shtetërore në Lahore më tregoi që kishte vështirësi t'u dëshmonte myslimanëve atje. U lutëm së bashku dhe flisnim lidhur me frikën që mund ta lidhte personin në një situatë të tillë dhe unë i dhashë premtimin e Krishtit: nuk do të lëshoj e as braktis. Më pas kur u ndamë ajo me gëzim më tha: më ke dhënë një shpresë të re të përballem me çdo lloj problemi.

Kur grupi i femrave u largua, një grup i të rinjëve që kishin ardhur nga Peshavari dhe Rev Sajedi, që drejtonte kampin e tyre, më kërkuan të rrija për t'ju folur dhe atyre. Një zyrtar i ri i gjykatës erdhi dhe më tregoi që punonte me myslimanët dhe që ishte i turpëruar për të dëshmuar. Ndava nga Mateu 10:31-33 dhe u luta me të. Në ditën e katërt ai erdhi sërish dhe tha që ishte i inkurajuar tani.

'Frika ime mori fund tani.' Dhe ashtu ishte. Ai më vizitoi kur u ndava nga kampi për të shkuar në Ravalpindi të qëndroja me vëllanë dhe motrën Junis.

Motra Junis kishte qenë në Mubarik dhe ne formuam një lidhje të fortë bashkësie. 'Eja dhe qëndro me ne kur të shkosh që këtu' më kishte thënë. Dhe kështu edhe bëra.

Që nga këto kampe shërbesa ime filloi me të vërtetë, dhe fillova për të predikuar në konferenca lidhur me atë se si Perëndia kishte vepruar me mua. Qesh e ftuar sërish në Mubarik, në atë vit, herët në korrik, ku dhe kisha mundësinë të ndaja në programin e kuvendit lokal me njerëz të mirënjohur në komunitetin e krishterë. Ata më praninin si një që Perëndia i ka ofruar shërbesë. Çdo herë që flisja ftesat vërshonin nga vende të largëta dhe të afërta. Njerëzit donin të dëgjonin ç'kisha për të thënë – më thoshnin që ishin të inkurajuar dhe që ishte një mesazh i nevojshëm për momentin.

Mundësitë për një shërbesë më të madhe tani sa do t'hapeshin, porse unë mbaja një lidhje të ngushtë me Jezusin në të njëjtën kohë. Dija nga përvoja që atëherë kur kishte bekime, sulmi do të vinte menjëherë po ashtu. Megjithatë, nuk isha e përgatitur për drejtimin nga do të vinte.

## 15. Përfundimi

Që nga Ravalpindi unë udhëtoja anembanë Pakistanit, duke folur në kisha dhe konferenca dhe duke u marrë po ashtu me ata në nevojë, fizike dhe shpirtërore.

Në tetor të 1977 shkova në Lahore në përgjigje të kërkesës së një vëllai dhe motre në kishën metodiste në Kanal Park, i cili më shkruajti që biri i tyre ishte i sëmurë. ‘Të lutem eja dhe lutu për të,’ shkruante vëlla Xhejmsi. Shkova duke u lutur dhe përgjatë udhëtimit.

Kur mbërrita atje djali që sjellur nga spitali i përbashkët i krishterë, i përmirësuar por ende i dobët. Më pas vëllai dhe motra Xhejms më kërkuan të rrija me ta. Ata kishin pesë vajza dhe pesë djem dhe kërkonin ndihmën time rreth edukimit të tyre në gjërat e Zotit. Në fund u morëm vesh që do të rrija me ta dhe do të isha e lirë për të shkuar në takime në Pakistan kur të ishte nevoja.

Gjatë tërë këtyre viteve jetoja me besim, Zoti plotësonte nevojat e mia aq shumë sa të tjerët dyshonin nëse ndonjë mision i huaj që prapa meje. Unë përpiqesha t’u sqaroja që pasuritë e qiellit janë në dispozicionin tonë kur ne jemi të gatshëm për t’i besuar Perëndisë me tërë qenien tonë. Unë i kisha dhënë Perëndisë të gjitha – familjen, shtëpinë, tokën, paratë, famën – dhe tani po i besoja për nevojat e mia.

Ndërsa isha ende në Ravalpindi, roli përfundimtar i jetës së Anis Bibit që lozur. Motra ime, e detyruar nga kundërshtimet familjare të ngelte një besimtare e fshehtë, vdiç me 14 mars 1977. Unë isha pranë saj për ta ngushëlluar kur ajo vdiç. Dhe e di që ajo i dha dorën njeriut me kurorë, në maje të shkallëve dhe i lejoi atij ta çonte në prezencën e Perëndisë.

Dy vajzat e Anis Bibit, njëra pesëmbëdhjetë dhe tjetra gjashtëmbëdhjetë vjeç shkuan për të jetuar me një xhaxha më pas, meqë babai i tyre u zbulua që nuk donte t’i mbante. Disa muaj më vonë mora në mesazh nga vajzat, të cilat më kërkonin nëse do të ishte e mundur të vinin tek unë për të jetuar, ngaqë nuk ishin të lumtura. Dhe ndodhi, në tetor, mora kujdestarinë mbi dy mbesat e mia, dhe ato u shpërngulën me mua në shtëpinë e vëlla Xhejmsit. Tani ishin mjaft vajza brenda një çatie, dhe mu atëherë fillova të

lutesha për një shtëpi ku do të mund të jetoja jetën time dhe të mos isha e varur nga askush, përveç Perëndisë.

I vendosa dy mbesat në një shkollë të kishës, pasi kishte vështirësi për t'i lënë dy mbesat e mia në shtëpinë e dikujt tjetër deri sa unë udhëtoja. Shkolla drejtohej nga disa motra të këndshme dhe atmosfera brenda qe shumë e mirë për vajzat.

Perëndia vendosi në zemrat e miqve në Karaqi për të bërë diçka lidhur me gjendjen time pa kulm. Ata ndienin që qe koha të kisha shtëpinë time për të mos jetuar tërë kohën me njerëz të tjerë, ashtu që ngritën ca para të cilave edhe unë u shtova nga ato që kisha ruajtur, dhe këto qenë të mjaftueshme për një shtëpi të vogël. Ç'ngushëllim që ishte të ktheheshe në vendin tënd pas një serie të lodhshme të takimeve ungjillzuese diku larg!

Në verën e 1978-ës hyra në shtëpinë time së bashku me dy mbesat e mia. Ndonëse jo çdo gjë shkonte mirë. Isha paditur në gjyq për disa akuza të rrejshme. I thashë gjyqtarit që kisha qenë e gjymtë por e shëruar nga Jezusi. Ai më kërkoi nëse dikush nga familja ime mund të dëshmonte lidhur me këtë. Për hir të drejtësisë, një anëtar i familjes sime kishte shkuar në gjyq për të konfirmuar ngjarjen e shërimit tim dhe të fliste për karakterin tim të mirë. Çështja kundër meje qe shkarkuar.

Mbesat më lanë porse Perëndia qe i mirë ndaj meje për të më dhënë dy vajza të dashura të adoptuara, një djalë dhe gjithashtu gjyshin e tyre, që të mos isha e vetmuar në këtë botë.

Frika e madhe në mendjen e tezës sime, kur për herë të parë dëshmovava për shërimin tim nga Jezusi, ishte se do të shkoja në Angli. Dhe ja ku jam, duke shikuar prapa në të gjithë udhën që Ati im qiellor më kishte drejtuar, që kur i besova në fillim.

Tani mund të shoh që pelegrinimi të cilën babai im e kishte filluar me mua qe fillimi i kërkimit të shpirtit tim për të njohur Perëndinë. Kishte ngritur shpresa, ndonëse e zhgënjyer në Mekë, më kishte drejtuar, në veçanti pas vdekjes së babait tim, për të kërkuar Perëndinë në mënyrë urgjente dhe me dëshpërim. I zgjata duart e mia ndaj Jezusit që ishte shëruesi – pa ditur gjë për të veç asaj që kisha lexuar pak në Kuran – dhe qesh shëruar.

Sot unë jam një dëshmitare e fuqisë së Perëndisë për të arritur njerëzit që gjenden prapa velit të islamit. Veli mund të griset që ato të mund të shohin Jezusin, ta dëgjojnë atë dhe ta duan atë.

Sot më nuk kam nevojë për pesë shtyllat e islamit për të forcuar besimin tim. 'Dëshmia' ime është Jezusi, i kryqëzuar, i vdekur dhe i varrosur, më pas i ngritur në jetën e ringjallur, dhe që tani jeton në mes të popullit të tij. Namazi im nuk është ndaj një Perëndie të panjohur porse ndaj atij jeta e të cilit gjendet në Fjalën e tij, Biblën e Shenjtë, thesarin tim më të çmuar, e shkruar në pllakat e zemrës dhe mendjes sime. Zeqati im nuk është më një pjesë, por e tërë pasuria ime, sepse çdo gjë që kam i takon Perëndisë. Pasuritë e mia janë të depozituara në qiell. Agjërimi im nuk bëhet në Ramazan për t'u paqtuar me Perëndinë, në mënyrë që të jem e sigurt për parajsën, por bëhet me kënaqësi që ta njoh atë më mirë. Haxhillëku im është udhëtimi nëpër jetë. Dhe çdo ditë më sjell drejt cakut – për të qenë me Jezusin, me Mbretin tim qiellor, përjetë.

Gjaku i demave, deleve apo dhive nuk mund asnjëherë ta eliminojë mëkatin, porse ne mund të hyjmë në vendet më të shenjta duke qenë të pranuar plotësisht, nëpërmjet një mënyre të re dhe të gjallë, 'nëpërmjet velit', kjo do të thotë, mishit të tij. Sepse kur ky njeri (Jezusi) kishte ofruar një fljirim për mëkatin përjetë, u ul në të djathtën e Perëndisë. (Hebrenjve 10:12)

I tillë është Jezusi, qengji i Perëndisë, profet dhe prift, mbret i mbretërve, Zoti dhe Perëndia im.

## Ftesë

Sot premtimi i Zotit mbetet i vlefshëm:

Unë do të derdh ujë mbi atë që ka etje dhe rrëke mbi tokën e thatë; do të derdh Frymën time mbi pasardhësit e tu dhe bekimin tim mbi trashëgimtarët e tu.

Jezus Krishti tha:

“Nëse dikush ka etje, le të vijë tek unë e të pijë. Ai që beson në mua, siç ka thënë Shkrimi, nga brendësia e tij do të burojnë lumenj uji të gjallë.”

Por këtë ai e tha për Frymën, që do të merrnin ata që do të besonin në të. Gjoni 7:37-39

Zoti fton shqiptarët kudo - në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi, dhe në mërgim - të vijnë tek Ai dhe të pinë:

“Ai që ka etje, le të vijë; dhe ai që do, le të marrë si dhuratë ujin e jetës.” Zbulesa 22:17

Lexues, a pive ti prej Atij?

## UNGGJILLI

JEZUS KRISHTI THA: Unë jam i Pari dhe i Fundit, i Gjalli! Isha i vdekur dhe, ja, jam i gjallë për shekuj të shekujve dhe unë i kam çelësat e Vdekjes dhe të Nëntokës.

Dhe: Unë jam Ringjallja dhe Jeta: kush beson në mua, edhe nëse vdes, do të jetojë. Edhe kush jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë.

A e beson ti këtë?

Jezusi është Biri i Perëndisë, Mesia. Shpëtimtari ynë duhet të jetë Biri i Perëndisë, jo vetëm njëfarë shpëtimtar njerëzor. Përse?

Në Bibël lexojmë: “Paga e mëkatit është vdekja.” Kur Perëndia flet për vdekjen, shpeshherë kuptohet vdekje e përjetshme, e përhershme, në të cilën njeriu është i ndarë prej Perëndisë në ferr; kjo vdekje është dënimi i mëkatit. Dhe të gjithë mëkatuan.

Por Perëndia aq fort e deshi botën sa që e dha një të vetmin Birin e vet kështu që, secili që beson në të, mos të humbet, por ta ketë jetën

e pasosur. E dërgoi Birin që bota të shpëtojë nëpër të. Kush beson në të, nuk dënohet, por ka jetën e pasosur.

Ne jemi njerëz; është njeriu që ka mëkatuar, pra duhet që një njeri të vdesë për mëkatin njerëzor. Jezusi, burrë i vërtetë dhe plotësisht njerëzor (por pa mëkat), e mori vendin e mëkatarëve kur vdiq mbi kryq, dhe e pranoi dënimin dhe gjykimin e Perëndisë kundër mëkateve të tyre. Ja përse i është e mundur Perëndisë, i cili është krejtësisht i drejtë, që të falë mëkate. Besimtarët pranojnë ndjesë, me anë të besimit në Jezusin, sepse të gjitha mëkatet e tyre u dënuan plotësisht kur vdiq Zoti Jezus mbi kryq. Ai është Zëvendësi i tyre.

Ndoshta në teori, do të kishte qenë e mundur që një burrë i përsosur, d.m.th. pa mëkat, të vdiste në vend të *një* mëkatarit të vetëm; nëse Jezusi kishte qenë *vetëm* njeri, vetëm *një* mëkatar do të kishte shpëtuar me anë të vdekjes së tij nën gjykimin e Perëndisë: një jetë për një jetë.

Por Perëndia donte të shpëtonte me miliona mëkatarë: kjo që e mundur, vetëm nëse vlefte e vdekjes së ofruar në vendin tonë që e pakufishme, e pasosur - d.m.th. aq e madhe sa Perëndia vetë. Për këtë arsye, ishte e nevojshme që Ai që vdiq në vend të mëkatarëve të ishte jo vetëm njeri por edhe Perëndi: Biri i Perëndisë.

Ja përse ish patjetër e nevojshme që Dikush të vdiste në vendin tonë i cili ishte edhe njeri edhe Perëndi: pa Birin e Perëndisë s'do të kishte qenë e mundur që me miliona mëkatarë të pranojnë ndjesën e mëkateve dhe jetën e pasosur afër Perëndisë. S'mund ta shpëtojmë veten prej dënimit të mëkateve: Ai mund të na shpëtojë falas, sepse Ai është Zot dhe Biri i Perëndisë, i cili vdiq dhe u ngjall prej së vdekurish, dhe jeton përgjithmonë.

Mund të vendosni kontakt me ne për libra të tjera krishtere që të japin më shumë njohuri për Perëndinë, për Biblën, për edukimin dhe rritjen e juaj shpirtërore dhe nëse Zoti ka prekur zemrën tënde, apo nëse shfaqni interesim për literaturë të ngjashme ju mund të paraqiteni në këtë adresë:





Kisha Protestante e Kosovës  
BASHKËSIA UNGJILLORE E MESISË  
MESSIAH EVANGELICAL CHURCH  
rr. Nazim Gafurri 66 (rruga për Gërmë)  
Prishtinë, Kosovë  
Tel. 044118088  
e-mail: messiahchurch1994@yahoo.com  
Shërbesë çdo të diele, ora 11.

Ose në këtë adresë: